



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 596 Akti**

**Nr. 685 Vendimi**

**Tiranë, më 14.7.2023**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	Kryesuese
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Etleda Çiftja</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 12.7.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati 0 (*underground*), salla B, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Alma Felaj**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, subjektin e rivlerësimit Alma Felaj, vëzhguesin ndërkombëtar Willem Brouwer, pasi shqyrtoi në seancën dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit të rivlerësimit, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Felaj, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, është subjekt rivlerësimi bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Felaj, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar me shortin e datës 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”. Nga ky short rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Suela Zhegu dhe Etleda Çiftja. Relatore u zgjodh komisionerja Suela Zhegu.

3. Trupi gjykues, me vendimin datë 21.6.2020, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Alma Faskaj. Me *email*-in datë 30.6.2020 subjektit të rivlerësimit i është njoftuar përbërja e trupit gjykues.

4. Komisioni, me vendimin datë 6.7.2020, pranoi kërkesën për dorëheqje të relatores Suela Zhegu, për shkak të konfliktit të interesit që ajo ka konstatuar me subjektin e rivlerësimit Alma Felaj.

5. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, anëtar zëvendësues në trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Suela Zhegu dhe Etleda Çiftja është caktuar komisioneri Olsi Komici. Pas dorëheqjes së relatores Suela Zhegu, në zbatim të këtij vendimi, relator është komisioner Olsi Komici.

6. Me *email*-in datë 10.7.2020 subjektit të rivlerësimit i është njoftuar përbërja e re e trupit gjykues.

7. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mungesa e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues dhe nga subjekti i rivlerësimit, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar është caktuar z. Willem Brouwer.

8. Bazuar në nenet 33, 36, 39, 42 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti

Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

**9.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit është zhvilluar mbi bazën e një hetimi administrativ të thelluar, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale).

**10.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, në datën 23.6.2023 vendosi: (i) përfundimin e hetimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Felaj, bazuar në tri kriteret e vlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht sipas ligjit nr. 84/2016 dhe mbi të drejtën për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni.

**11.** Trupi gjykues me anë të postës elektronike<sup>1</sup> njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) përbërjen e trupit gjykues; (ii) rezultatet e hetimit kryesisht; (iii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të sjellë prova për të provuar të kundërtën jo më vonë se data 6.7.2023.

**12.** Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka dërguar me anë të postës elektronike<sup>2</sup> prapësimet në lidhje me rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

**13.** Komisioni, bazuar në vendimin e datës 7.7.2023, nëpërmjet postës elektronike datë 7.7.2023, i njoftoi subjektit ftesën për seancën dëgjimore të datës 12.7.2023 (ora 10:00).

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**14.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.7.2023 (ora 10:00), në Sallën e Konferencave, Pallati i Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer.

**15.** Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrroi shpjegimet e saj lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

**16.** Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

**17.** Seanca dëgjimore u ndërpre, për të rifilluar në datën 14.7.2023 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**18.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Felaj, ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, duke

---

<sup>1</sup> Me *email*-in datë 27.6.2023 të Komisionit, dërguar subjektit të rivlerësimit.

<sup>2</sup> Me *email*-in datë 6.7.2023 të subjektit të rivlerësimit, drejtuar Komisionit.

respektuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**19.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, sipas të cilit anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

**20.** Për subjektin e rivlerësimit, znj. Alma Felaj, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin tri kritere: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; vlerësimin e aftësive profesionale.

**21.** Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI, AKSIK dhe KLP janë organet ndihmëse në proces, të cilat, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të hetimit të kryer prej tyre, kanë hartuar dhe depozituar në Komision raportet dhe dokumentacionin përkatës mbi vlerësimin e pasurisë, figurës dhe atë profesional.

**22.** Referuar vendimit nr. 2/20176 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**23.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Felaj, është subjekt deklarues në detyrën e prokurorit prej vitit 2006. ILDKPKI-ja ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm e të arsyetuar<sup>3</sup>. Në përfundim të veprimeve verifikuese, bazuar në pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje pasurie;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

---

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2018, dërgohet nga ILDKPKI-ja akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Felaj.

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**24.** Komisioni vëren se në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë, sipas nenit 31/1<sup>4</sup> të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 29.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e ligjit në fuqi<sup>5</sup>. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

**25.** Pas analizimit të kësaj deklarate, raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe të informacioneve që Komisioni ka marrë nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nga hetimi rezultoi se kanë deklaruar pasuritë si në vijim:

### **Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

#### **❖ Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit**

**1. Automjeti tip “Ford Fiesta”, me targë \*\*\* (më pas \*\*\*), blerë nga subjekti sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.5.2007, në vlerën 300,000 lekë.** Më pas, dhuruar shtetasit M. K. (djali i xhaxhait) sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2011. Pjesa takuese: 100% (vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2017, i DRSHTRR-së Fier, kontrata e shitblerjes, deklarata noteriale, deklarata doganore).

**Burimi i krijimit:** të ardhurat nga paga si prokurore.

**1.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 blerjen e këtij automjeti me specifikimet si më lart dhe në DIPP-në e vitit 2011 deklaroi kalimin e këtij automjeti në pronësinë e shtetasit M. K., sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2011, për heqjen dorë nga e drejta e pronësisë pa shpërblim.

**1.2** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2017, të DRSHTRR-së Fier, që provon se sipas kontratës së shitjes datë 24.5.2007 automjeti tip “Ford Fiesta” me targë \*\*\* ka qenë në pronësi të subjektit dhe më pas është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit dhe shtetasit M. K. (djali i xhaxhait të subjektit) sipas deklaratës noteriale datë 9.7.2010<sup>6</sup>. Në datën 29.2.2012<sup>7</sup>, me deklaratën noteriale datë 23.12.2011, automjeti ka kaluar në pronësi të shtetasit M.K.; (ii) deklaratë doganore dhe akti zhdoganimi datë 5.3.2006, në emër të shtetasit A. A., me vlerë totale 339,374 lekë (çmimi 1,600 euro ose 197,456

<sup>4</sup> Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

<sup>5</sup> Referuar parashikimit kushtetues të nenit 84/3, datës së miratimit të ligjit nga Parlamenti, datës të botimit të ligjit në Fletoren Zyrtare<sup>5</sup>, si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për pezullimin dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizim, ligji hyri në fuqi në datën 8.10.2016. Në datën 25.10.2016 ligji u pezullua nga Gjykata Kushtetuese. Për këtë arsye, afati i zbatimit të ligjit eci për 17 ditë, deri në 19 janar 2017. Në datën 18.1.2017 Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën për shfuqizimin e ligjit. Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare në datën 19.1.2017. Si rezultat, afati 30-ditor në dispozicion të subjekteve të rivlerësimit për dorëzimin ka përfunduar në datën 31.1.2017.

<sup>6</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.7.2010, notere S. X..

<sup>7</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2011, notere S. X.

lekë + taksë zhdoganimi 142,881 lekë); (iii) kontratë shitblerjeje automjeti<sup>8</sup> datë 24.5.2007, e lidhur midis subjektit dhe shitësit G. B. kundrejt çmimit 300,000 lekë, likuiduar menjëherë jashtë zyrës noteriale; (iv) deklaratë noteriale<sup>9</sup> datë 9.7.2010, ku subjekti deklaroi se meqë nuk ka kryer veprimet për regjistrimin e këtij automjeti në emrin e saj pranë DPSHTRR-së, është dakord që leja e qarkullimit të dalë në emrin e saj dhe të shtetasit M. K.; (v) deklaratë noteriale<sup>10</sup> datë 23.12.2011, ku subjekti dhe shtetasi M. K. deklarojnë se janë bashkëpronarë të automjetit, por subjekti heq dorë nga pronësia mbi pjesën e saj, duke ia kaluar pa kundërshtim bashkëpronarit M. K.; (vi) kontratë<sup>11</sup> datë 27.9.2016, me anë të së cilës shtetasi M. K. ia ka shitur automjetin shtetasit E. H.

## Hetimi i kryer nga Komisioni

**1.3** Komisioni ka administruar<sup>12</sup> nga DPSHTRR-ja dosjen e këtij automjeti, e cila përmban të njëjtin dokumentacion që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

**1.4** Nga hetimi i Komisionit në AMF rezultoi se për periudhën 4.4.2008 – 3.4.2009 shtetasi G. B. figuron pronar i automjetit, ndërsa subjekti i rivlerësimit figuron përdorues. Për periudhën 5.3.2011 – 4.3.2012 subjekti i rivlerësimit figuron përdorues, ndërsa shtetasi M. K. figuron pronar i automjetit. Këto rrethana janë për shkak të faktit që subjekti, edhe pse e kishte blerë automjetin në datën 24.5.2007, nuk e kishte regjistruar kontratën në DPSHTRR dhe më pas, me deklaratën noteriale datë 9.7.2010, automjeti është regjistruar në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit M. K.

## Analiza e burimit të krijimit të shumës 300,000 lekë, me të cilën është blerë automjeti

**1.5** Komisioni kreu analizën financiare të burimit të krijimit të kësaj pasurie për periudhën 1.1.2007 – 24.5.2007, nga ku rezultoi<sup>13</sup> se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e automjetit në datën 24.5.2007. Për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion 318,388 lekë të ardhura, me të cilat ka përballuar shpenzimet jetike në vlerën 98,320 lekë dhe krijimin e pasurisë në vlerën 212,626 lekë. Pasuria e krijuar në periudhën 1.1.2007 – 24.5.2007 përbëhet nga blerja e automjetit tip “Ford Fiesta” në shumën 300,000 lekë dhe pakësimi i likuiditetit në bankë prej 87,374 lekësh, i cili në analizën e mëposhtme financiare është pasqyruar në zërin “ndryshim likuiditeti”.

**1.6** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me deklarimin dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtij automjeti.

<sup>8</sup> Kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.5.2007, notere S. X.

<sup>9</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.7.2010.

<sup>10</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.12.2011.

<sup>11</sup> Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.9.2016.

<sup>12</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2023, e DPSHTRR-së.

<sup>13</sup> Periudha 1.1.2007 – 24.5.2007: të ardhura = 318,388 lekë (nga paga e subjektit); detyrime = 0 (zero); shpenzime = 98,320 lekë (shpenzime jetike); pasuri = 212,626 (automjet tip “Ford Fiesta”, blerë më 24.5.2007 = 300,000 lekë – ndryshim likuiditeti = 87,374 lekë); të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri = 7,442 lekë.

**2. Shuma 650,000 lekë, e transferuar nga llogaria bankare e nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. S. K., tek Raiffeisen Bank në llogarinë bankare rrjedhëse të subjektit. Pjesa takuese: 100%.**

**Burimi i krijimit:** dhuratë nga nëna S. K., e cila e ka pasur këtë shumë në depozitë bankare, krijuar fillimisht në Bankën e Kursimeve dhe më pas, rreth vitit 2004, ka kaluar në Raiffeisen Bank, me burim nga të ardhura të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar në tregun ditor të hapur industrial të qytetit të Fierit prej vitit 1992.

**2.1** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë transfertë si shtesë në llogarinë e saj bankare si më lart, në DIPP-në e vitit 2016. Gjithashtu ka deklaruar edhe pakësimin e saj në po të njëjtën shumë, në DIPP-në e vitit 2017.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**2.2** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) deklaratë noteriale<sup>14</sup> datë 15.1.2016, ku shtetasja S. K. (nëna e subjektit) ka deklaruar se ka pasur një depozitë bankare prej 650,000 lekësh, të krijuar ndër vite nga puna e saj dhe e bashkëshortit M. K. dhe këtë shumë parash ia dhuron vajzës nëpërmjet Raiffeisen Bank, sipas faturës bankare datë 13.1.2016; (ii) mandat datë 13.1.2016 i Raiffeisen Bank për kalimin e shumës 650,000 lekë nga llogaria e shtetasës S. K. në llogarinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) nxjerrje llogarie e klientes S. K. nga Raiffeisen Bank, datë 20.1.2017, ku pasqyrohen lëvizjet bankare për periudhën 27.2.2006 – 11.3.2015; (iv) nxjerrje llogarie datë 25.1.2017 për periudhën 17.6.2010 – 9.3.2015; (v) nxjerrje llogarie datë 25.1.2017, për periudhën 11.3.2009 – 31.3.2016; (vi) nxjerrje e llogarisë së subjektit nga Raiffeisen Bank, datë 26.1.2017, mbi lëvizjet bankare për periudhën 25.4.2005 – 30.12.2016.

**2.3** Siç rezulton, nëna i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit shumën 650,000 lekë në vitin 2016, kur kjo e fundit nuk ishte në trung familjar me të (rezulton se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë në datën 10.12.2010, sipas certifikatës së martesës datë 23.1.2017, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë), por ka qenë në detyrë dhe ky dhurim është një marrëdhënie interesi midis tyre, duke e vendosur nënën e subjektit të rivlerësimit në cilësinë e personit tjetër të lidhur, referuar nenit 3, pika 14 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, e cila ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 650,000 lekë.

**2.4** QKB-ja dhe DPT-ja konfirmojnë<sup>15</sup> se shtetasja S. F.<sup>16</sup> ka qenë e regjistruar si person fizik me NIPT \*\*\* dhe është çregjistruar në datën 29.4.2016.

**2.5** DRT Fier konfirmon<sup>17</sup> se shtetasja S. K. figuron e regjistruar nga data 4.4.2012 deri më 10.8.2017, me NIPT \*\*\* dhe është çregjistruar sipas kërkesës për çregjistrim prej datës 15.3.2016. Tatimpaguesi është me përgjegjësi tatimore tatim fitimi i thjeshtuar, kontribute të sigurimeve shoqërore; ka realizuar të ardhura 1,005.000 lekë në vitin 2014 dhe 145,520 lekë në vitin 2015.

<sup>14</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.1.2016.

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, e QKB-së dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, e DPT-së, drejtuar Komisionit (mbiemri është gabim dhe duhej Kola).

<sup>16</sup> Komisioni vëren se mbiemri Felaj është gabim dhe duhej Kola, pasi nga gjeneralitetet e tjera rezulton se është S. K., nëna e subjektit. Gjithashtu, nga kërkimi në Regjistrin e Gjendjes Civile nuk rezulton asnjë shtetase me emrin S. F..

<sup>17</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2017, e DRT-së Fier, dërguar në ILDKPKI.

**2.6** Në pyetësonin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i krijimit të shumës dhuratë prej 650,000 lekësh janë të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar nga nëna dhe babai i saj si tregtar ambulant në tregun ditor të hapur ambulator industrial të qytetit të Fierit, prej vitit 1992 deri në vitin 2009, duke i paguar Bashkisë Fier një pagesë ditore për zënien e hapësirës publike. Shumën e mësipërme nëna e ka pasur në depozitën bankare të krijuar fillimisht në Bankën e Kursimeve dhe më pas, rreth vitit 2005, e ka kaluar në Raiffeisen Bank.

**2.7** Bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit nr. 1 subjekti i rivlerësimit ka depozituar ndër të tjera: (i) transfertë bankare datë 13.1.2016, lëshuar nga Raiffeisen Bank dhe ekstraktet e llogarive bankare të përmendura më lart; (ii) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2020, i Bashkisë Fier, që konfirmon se në këtë Bashki ka funksionuar tregu ambulator industrial në vitet 1992 – 2009, ku tregtarët që ushtronin aktivitet kanë pasur statusin “ambulant” dhe paguanin taksë ditore për zënien e hapësirës publike për këtë periudhë, duke u pajisur me librezat përkatëse. Gjithashtu, në këtë shkresë konfirmohet se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave aktualisht nuk disponon dokumentacion ku të dokumentohen pagesat e taksave të zënies së hapësirës publike për periudhën 1992 – 2009, ndërsa librezat për pagesën e taksës së vendit është lëshuar nga kjo Bashki në emër të shtetasit M. K.; (iii) librezë lëshuar nga Bashkia Fier në emër të shtetasit M. K., për pagesën e taksës së vendit të tregtimit, ku pasqyrohen pagesat e kryera në muajt janar dhe shkurt 2007; (iv) shkresat nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020, të Raiffeisen Bank, dega Durrës, nga ku rezulton se subjekti që nga data 21.12.2009 ka qenë person i autorizuar me të drejta të plota në llogaritë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* të klientes S. K. dhe nga data 17.12.2008 në llogaritë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* të klientit M. K.. Rreth vitit 2005, në momentin e kalimit të të dhënave nga sistemi i Bankës së Kursimeve tek sistemi i Raiffeisen Bank, gjendja e llogarive të shtetasës S. K. ka qenë 1,169,431 lekë, ndërsa gjendja e llogarive të shtetasit M. K. ka qenë 1,546,310 lekë, 100,000 lekë dhe 200,000 lekë. Llogaritë rezultojnë të mbyllura në datën e lëshimit të shkresave, 15.9.2020.

**2.8** Në lidhje me provueshmërinë e ushtrimit të aktivitetit tregtar nga prindërit e saj në tregun e hapur ambulator industrial të Fierit prej vitit 1992 deri në vitin 2009, me statusin e ambulantis, si dhe ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet, subjekti është përgjigjur në pyetësorët në vijim:

**2.9** Në pyetësonin nr. 2 subjekti ka depozituar: (i) deklaratë noteriale<sup>18</sup> të disa shtetasve, të cilët deklarojnë se kanë ushtruar aktivitet tregtar në vitet 1992 – 2009, periudhë kohore kur kanë bërë tregti edhe prindërit e subjektit që njihen prej tyre, si dhe i paguanin Bashkisë Fier një pagesë ditore që mbledhej me mandatpagesë nga një inspektor i Bashkisë; (ii) deklaratë noteriale<sup>19</sup> e një inspektori të Bashkisë Fier, i cili deklaron se me detyrën e mbledhjes së pagesës ditore të tregtarëve ambulantë të tregut ambulator industrial i ka mbledhur pagesat ditore tregtarëve ambulantë në këtë treg, M. dhe S. K.

**2.10** Në pyetësonin nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

<sup>18</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.3.2023.

<sup>19</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.3.2023, e shtetasit Th. D., inspektor në ndërmarrjen e tregtisë së lirë pranë Bashkisë Fier.



- Prindërit e saj S. K. dhe M. K. kanë ushtruar aktivitetet si tregtarë ambulantë në tregun industrial të qytetit të Fierit, për periudhën 1992 – 2009.
- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Fier, e ngarkuar me ligj për mbledhjen e taksave vendore, nuk ka arkiv dhe as regjistër ku të jenë dokumentuar pagesat e taksave në vitet 1992 – 2009. Tregtarët ambulantë deri në vitin 2006 nuk kanë pasur detyrimin që të regjistrohen në Bashki, por kanë paguar tek inspektorët e bashkisë biletën ditore për zënien e vendit ku ushtrojnë aktivitetet, sipas ligjit nr. 9632, viti 2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në kohën kur ka filluar punën Drejtoria e Taksave Vendore. Ky fakt vjen në përputhje edhe me dokumentin “Librezë për pagesë taksë vendi” në emër të shtetasit M. K., ku figuron se ai ka qenë i regjistruar në vitin 2007 dhe ka paguar taksën vendore, në funksion të ushtrimit të këtij aktivitetit.
- Ambulantët janë bërë pjesë e veprimtarisë së drejtorive rajonale tatimore që nga viti 2003, ndërsa për periudhat 1992 – 2003 kjo kategori biznesi është administruar nga pushteti vendor.
- Të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar si ambulantë, prindërit i kanë depozituar në Bankën e Kursimeve dhe më pas në Raiffeisen Bank, duke qenë gjithë kohën brenda sistemit bankar dhe në shuma të konsiderueshme, shumë vite para se subjekti i rivlerësimit të fillonte punë si prokurore, ndërsa shuma e dhuruar nga nëna e saj përbën një pjesë të vogël të tyre.
- Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë të gjitha hapat e duhur ligjorë në mënyrë shteruese pranë institucioneve të ngarkuara me ligj (për evidentimin e subjekteve tregtare, mbledhjen e taksave dhe tatimeve, pasqyrimin në regjistra të posaçëm të këtyre subjekteve dhe pagesave të kryera prej tyre) për marrjen e informacionit në lidhje me ushtrimin e aktivitetit tregtar nga prindërit e saj dhe pagesën e tatimeve. Pasi ka marrë përgjigje të pamjaftueshme nga Bashkia Fier në lidhje me këto të dhëna, subjekti i është drejtuar sërish këtij institucioni<sup>20</sup>, i cili nuk ka kthyer përgjigje dhe më pas i është drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale (KDIMDHP)<sup>21</sup>. Ky i fundit ka detyruar<sup>22</sup> Bashkinë Fier që t’i kthejë përgjigje subjektit të rivlerësimit dhe në përgjigjen përkatëse citohet: *“Bashkia Fier nuk disponon në arkiv, regjistra apo formularë që të dokumentojnë pagesat e tatimit mbi biznesin e vogël apo ambulantëve të ish-tregut që funksiononte poshtë urës së lumit Gjanica në vitet 1992 – 2009 në qytetin e Fierit. Për rrjedhojë, në arkiv nuk ka të dhëna as për tatimet e biznesit të vogël apo ambulantët, shtetasit M. K. dhe S. K.”*.

**2.11** Bashkëlidhur pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion ligjor që provon shpjegimet e saj<sup>23</sup> si më lart.

<sup>20</sup> Sipas kërkesës për informacion datë 18.4.2023 të subjektit të rivlerësimit drejtuar Bashkisë Fier, bashkëlidhur përgjigjes së subjektit në pyetësorin nr. 4.

<sup>21</sup> Sipas formularit të ankesës datë 2.5.2023 drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

<sup>22</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2023, që KDIMDHP-ja i ka drejtuar Bashkisë Fier.

<sup>23</sup> 1) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2020, e Bashkisë Fier; 2) librezë pagese për taksë vendi e lëshuar nga Bashkia Fier në emër të shtetasit M. K.; 3) deklaratë noteriale datë 12.4.2023, e nënës së subjektit S. K.; 4) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2023, e Bashkisë Fier; 5) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2023, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; 6) deklaratë noteriale nr. \*\*\*

**2.12** Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, por edhe legjislacionit tatimor<sup>24</sup>, rezulton se deri në vitin 2003 detyrimet tatimore të tregtarëve ambulantë llogariteshin dhe mblihdeshin nga zyrat tatimore të pushtetit lokal në bashki e komuna. Pas vitit 2003 ambulantët janë në kompetencë të drejtorive rajonale tatimore, por prindërit e subjektit nuk rezultojnë të regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier në periudhën 2003 – 2009.

**2.13** Në pyetësin nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) deklaratë noteriale të shtetasit Sh. M.<sup>25</sup>, i cili deklaron se në periudhën janar 1994 – maj 1998 ka punuar si inspektor pranë Bashkisë Fier, i ngarkuar me detyrën e mbledhjes së pagesës ditore pranë tregut të hapur ambulator të Gj.. Për këtë periudhë ai deklaron se u ka mbledhur pagesat ditore shtetasve M. K. dhe S. K., të cilët punonin së bashku si tregtarë ambulantë në këtë treg; (ii) vërtetim datë 20.4.2023 “Mbi bazën e vlerësueshme” nga ISSH Fier, që vërteton se në periudhën janar 1994 – dhjetor 1997 shtetasi Sh. M. ka realizuar të ardhura nga paga pranë punëdhënësit Bashkia Fier.

**2.14** Subjekti i rivlerësimit shpjegon në këtë pyetësor se këto dy akte shkresore të analizuara në harmoni edhe me provat e tjetra të lartpërmendura përbëjnë një dëshmi/provë me vlerë të plotë dhe të pakontestueshme në lidhje me procesin e rivlerësimit.

**2.15** Komisioni vëren se referuar përshkrimit të lëvizjeve në llogarinë bankare nr. \*\*\* pranë Raiffeisen Bank në emër të shtetases S. K., rezulton që kjo shtetase ka paguar në llogari të Degës së Tatimeve Fier detyrimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore në datat 19.7.2012, 16.4.2013 dhe 17.7.2013, si dhe ka paguar në llogarinë e Degës së Thesarit Fier në favor të Bashkisë Fier taksat vendore (taksa mbi biznesin e vogël, taksë ndërtese, taksë table) në datat 8.4.2013 dhe 17.7.2013. Pra, provohet regjistrimi i aktivitetit të prindërve të subjektit të rivlerësimit në vitet 2012 – 2013.

**2.16** Gjithashtu, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të qenë ezauruese në paraqitjen e dokumentacionit të plotë ligjor që vërteton ushtrimin e aktivitetit tregtar ndër vite të prindërve të saj, por, sa më sipër, subjekti ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin konkret që justifikon ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës 650,000 lekë, të dhuruar nga nëna e saj. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit është në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, shuma 650,000

---

rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.1.2016, e shtetases S. K.; 7) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020, e Raiffeisen Bank, dega Durrës, që konfirmon se në momentin e kalimit të të dhënave nga sistemi i Bankës së Kursimeve tek sistemi i Raiffeisen Bank gjendja e llogarive ka qenë si vijon: S. K. 1,169,431 lekë, ndërsa M. K. 1,546,310 lekë; 100,000 lekë dhe 200,000 lekë; 8) ekstraktet e llogarive bankare pranë Raiffeisen Bank të shtetasve S. K. dhe M. K., bashkëlidhur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020, që vërtetojnë faktin se këta shtetas të ardhurat që kanë përfitur nga ushtrimi i aktivitetit tregtar prej vitit 1992 i kanë depozituar në mënyrë periodike në depozitë bankare të krijuar fillimisht në Bankën e Kursimeve, e blerë dhe përthithur në vitin 2003 nga Raiffiesen Bank; 9) kërkesë nr. \*\*\*, datë 11.4.2023, e subjektit drejtuar Bashkisë Fier për informacion në lidhje me ushtrimin e aktivitetit tregtar të prindërve të saj dhe pagimin e taksave e tatimeve prej tyre.

<sup>24</sup> Sipas neneve 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 7545, datë 6.1.1992 “Për tatimin mbi të ardhurat e personave fizikë në sektorët privatë të tregtisë, artizanatit e të shërbimeve të tjera”; neneve 1, 2, 12 dhe 13 të ligjit nr. 7546, datë 6.1.1992 “Për administrimin e tatimeve dhe të taksave në Republikën e Shqipërisë”; neneve 4 dhe 5 të ligjit nr. 7679, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”; neneve 1 dhe 30 të ligjit nr. 7681, datë 4.3.1993 “Për administrimin e tatimeve dhe të taksave në Republikën e Shqipërisë”; neneve 8 dhe 21 të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”; neneve 1, 2, 3, 4, 5, 10, të ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002 “Për taksën vendore për biznesin e vogël”.

<sup>25</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.4.2023.

lekë dhuruar nga nëna duhet të konsiderohet një burim i ligjshëm financiar. Në lidhje me këtë, subjekti i rivlerësimit i referohet edhe vendimit nr. \*\*\*, datë 28.2.2020, të Komisionit, që ka marrë formë të prerë<sup>26</sup> (subjekti i rivlerësimit A. V.) dhe duhet të trajtohet në analogji, pasi ndodhet në të njëjtat rrethana në lidhje me këtë burim krijimi pasurie.

**2.17** Nga informacioni që Komisioni ka administruar prej bankave të nivelit të dytë rezulton se nëna e subjektit ka disponuar në Raiffeisen Bank (ish-Banka e Kursimeve)<sup>27</sup> depozitë bankare nr. \*\*\*, që është çelur fillimisht në datën 2.2.1995 në shumën 42,000 lekë dhe është shtuar ndër vite me depozitime dhe interesa, duke arritur në vlerën 1,169,431 lekë në datën 30.9.2004. Në vitin 2008 nga kjo depozitë janë tërhequr 400,000 lekë, ndërsa diferenca prej 717,100 lekësh ka vazhduar të qëndrojë në depozitë dhe është shtuar në vitin 2009 me llogaritë e babait të subjektit në shumën 2,008,026 lekë. Me përgjigjen e Raiffeisen Bank<sup>28</sup>, të depozituar nga subjekti, provohet se shuma 2,008,026 lekë, që ka kaluar nga llogaria e babait M. K. tek llogaria e shtetasës S. K., ka ekzistuar përpara vitit 2004 dhe përbëhet nga shumat 1,546,310 lekë, 100,000 lekë dhe 200,000 lekë (përmendur më lart në pikën 2.7 dhe që në total bëjnë 1,846,310 lekë) dhe përfaqësojnë gjendjen e depozitave të babait në datën 30.9.2004 në ish-Bankën e Kursimeve. Shuma 2,008,026 lekë është gjendja e llogarisë së babait në datën 9.3.2015 në Raiffeisen Bank, konfirmuar nga veprimi bankar i transferimit të kësaj shume në llogarinë e nënës së subjektit. Diferenca prej 161,716 lekësh (2,008,026 - 1,846,310) duket se është shtesë e krijuar nga viti 2004 deri në vitin 2009.

**2.18** Në vijim, në datën 9.3.2015, shtetasja S. K. kalon në llogarinë bankare të djalit të saj A. K. shumën 1,500,000 lekë dhe në datën 13.1.2016 kalon në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit shumën 650,000 lekë. Në këtë llogari bankare të nënës së subjektit të rivlerësimit nuk rezultojnë të jenë kryer pagesa *cash* nga subjekti, si dhe as transferata nga llogaritë e subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga kjo llogari shumat 70,000 lekë dhe 327,000 lekë në datën 15.6.2012, si dhe 88,000 lekë në datën 12.7.2013, pra për 1 vit ka tërhequr në total 485,000 lekë.

---

<sup>26</sup> “1.112. Gjithsesi, në lidhje me faktet dhe provat rrethanore, të administruara gjatë hetimit për këto dy të ardhura, Komisioni çmon se ato gjithashtu duhet t'i nënshtrohet vlerësimit, duke pasur parasysh: (i) periudhën e gjatë dhe të largët të burimit të përfitimit të këtyre të ardhurave nga personat e tjerë të lidhur; (ii) faktin që subjekti i rivlerësimit ka qenë minoren dhe më tej student gjatë kohës së fitimit të pjesës më të madhe të këtyre të ardhurave nga personat e tjerë të lidhur; (iii) faktin që subjekti ka depozituar disa prova rrethanore, të cilat provojnë fluksin e parasë në familjen e tij para se të ishte subjekt rivlerësimi. 1.115. Në analizë të këtyre provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, mbi mënyrën e fitimit të të ardhurave nga trashëgimia dhe aktiviteti privat, trupi gjyqës çmon se niveli i provueshmërisë për burimin e krijimit të këtyre të ardhurave, si dhe të ardhurat nga trashëgimia dhe aktivitetet private, janë të tilla që krijojnë bindjen për krijimin e tyre nga personat e lidhur, duke pasur parasysh faktin që personat e tjerë të lidhur, ...nuk kanë qenë subjekte të deklarimit të pasurive, por edhe faktin se subjekti gjatë kësaj kohe ka qenë nxënës apo student. 1.117. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se personat e tjerë të lidhur gjenden për arsye të ekzistencës së disa rrethanave që e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 (cituar përmbajtja e ligjit) ...për shkak se: (i) faktin që në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave, personat e tjerë të lidhur, prindërit e subjektit nuk e gëzonin statusin e personave të tjerë të lidhur të subjektit të rivlerësimit në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk kishin ndonjë detyrim ligjor të tregoheshin të kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tyre në atë kohë, përveçse për atë që ata e kanë çmuar të nevojshme sipas kujdesit të çdo qytetari normal; (ii) koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit, që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo të arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohë, madje as nga vetë institucionet shtetërore”.

<sup>27</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2023, e Raiffeisen Bank.

<sup>28</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020, e Raiffeisen Bank, depozituar nga subjekti i rivlerësimit në pyetësin nr. 3.

**2.19** Në lidhje me administrimin me autorizim të llogarisë tjetër bankare nr. \*\*\* të nënës së saj nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se nga analiza e dokumenteve të bankave të nivelit të dytë rezulton që në këtë llogari të krijuar në datën 17.6.2012 me shumën 569,948 lekë, që vjen si depozitë e maturuar nga llogaria tjetër nr. \*\*\* në emër të shtetasës S. K., e cila kryen edhe vetë veprime në këtë llogari (analizuar më lart në pikat 2.16 - 2.17), nuk rezultojnë të jenë kryer pagesa *cash* nga subjekti i rivlerësimit dhe nga prindërit e saj, si dhe as transferta nga llogaritë e subjektit të rivlerësimit apo personave të tretë. Subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga kjo llogari shumat 45,100 lekë në datën 22.12.2011; 11,000 lekë në datën 13.1.2012; 87,700 lekë në datën 24.9.2012; 87,700 lekë në datën 15.2.2013. Pra, në periudhën 22.12.2011 – 15.2.2013 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr në total 231,500 lekë.

**2.20** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar në mbështetje të shpjegimeve, si dhe vlerësoi në tërësi provat, duke mbajtur në konsideratë: (i) periudhën e gjatë dhe të largët të burimit të krijimit të të ardhurave nga biznesi i prindërve të subjektit të rivlerësimit në vitet 1992 – 2009; (ii) mungesën e një arkivi/regjistri ku të jenë dokumentuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Fier pagesat e taksave në vitet 1992 – 2009; (iii) faktin që personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, prindërit e saj, nuk kanë pasur detyrim dhe nuk kanë qenë subjekte deklarimi për pasurinë; (iv) depozitimin e librezës për pagesën e taksës së vendit për vitin 2007, si dhe dokumenteve që provojnë ushtrimin e aktivitetit dhe pagesën e detyrimeve ligjore në vitet 2012 – 2013; (v) disponimin e depozitave bankare nga prindërit e subjektit të rivlerësimit (përfshirë edhe depozitat nga buron shuma 650,000 lekë) në vlera të konsiderueshme shumë kohë më parë se subjekti i rivlerësimit të fillonte detyrën si prokurore, që në vitin 1995, ekzistencën e tyre ndër vite deri në momentin e dhurimit, si dhe furnizimin e tyre me mjete monetare në vazhdimësi, çka të bën të besosh se ato vijnë nga ushtrimi i aktivitetit tregtar (deri në vitin 2004, shumë kohë përpara fillimit të detyrës nga ana e subjektit, nëna ë subjektit ka pasur në llogari 1,169,431 lekë, ndërsa babai i saj 2,008,026 lekë, shuma këto më se të mjaftueshme për të justifikuar dhurimin e shumës prej 650,000 lekësh, duke zëruar çdo hipotezë të mundshme se këto të ardhura janë mjete monetare të fshehura dhe të krijuara me të ardhura të paligjshme nga subjekti i rivlerësimit); (vi) faktin që në llogaritë e nënës së subjektit të rivlerësimit (përfshirë edhe llogarinë nga vjen shuma dhuratë prej 650,000 lekësh) nuk rezultojnë të jenë kryer pagesa *cash* nga subjekti i rivlerësimit apo nga prindërit e saj, si dhe as transferta nga llogaritë e subjektit të rivlerësimit apo të personave të tretë; (vii) konfirmimet e ushtrimit të aktivitetit tregtar të prindërve të subjektit për periudhën 1992 – 2009, nga tregtarë që kanë ushtruar të njëjtën veprimtari në po këtë periudhë dhe nga ish-inspektorët e Bashkisë Fier dhe vetë bashkia – vlerëson se këto të dhëna provojnë në mënyrë të tërthortë, të mjaftueshme, ushtrimin e aktivitetit tregtar ambulant nga prindërit e subjektit të rivlerësimit në mënyrë të ligjshme, si dhe mundësinë financiare të nënës së subjektit që me të ardhura të ligjshme të krijonte shumën 650,000 lekë, që i ka dhuruar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet kalimit të kësaj shume në llogarinë bankare të saj në datën 13.1.2016.

**2.21** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni, si dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarimin dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

**2.22** Edhe në rast se Komisioni do të vlerësonte se shuma e dhuruar nga nëna e subjektit të rivlerësimit, prej 650,000 lekësh, është krijuar me burime jo të ligjshme, Komisioni do të arrinte në përfundimin se, duke marrë për bazë dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe atë të siguruar nga institucionet e treta dhe në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, një balancë negative prej 650,00 lekësh, marrë në konsideratë edhe rezultatin përfundimtar të analizës financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të (pika 15 e vendimit), si dhe bazuar në një vlerësim tërësor mbi kriterin e pasurisë, vlerësohet me një peshë jo aq vendimtare saqë ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**3. Tokë arë me sip. 13,035 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë \*\*\*, Fier, regjistruar në ZVRPP-në Fier, në bashkëpronësi me shtetasit S. K., A. K., D. K., V. K. dhe A. K.**

**Burimi i krijimit:** ligji nr. 7501/1991, si anëtare e familjes bujqësore (pjesa 1/7F) dhe pjesa e fituar me trashëgimi ligjore nga babai i subjektit, z. M. K. (pjesa 1/28B).

**3.1** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozituar: (i) certifikatë e gjendjes familjare në datën 1.8.1991, me anëtarë M., S., D., A. dhe A. K. dhe certifikatë datë 10.10.1992, ku shtohet anëtar edhe V. K. (bashkëshortja e A.); (ii) akti i marrjes në pronësi të tokës arë me sip. 13,773 m<sup>2</sup>, lëshuar në emër të shtetasit M. K. në datën 27.2.1996; (iii) vendim nr. \*\*\*, datë 19.7.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerit M. K. (që ka ndërruar jetë në datën 24.5.2009), ku përcaktohen trashëgimtarët e tij ligjorë S. K., A. K., D. K. dhe Alma Felaj me nga 1/4 pjesë të pasurisë trashëgimore; (iv) certifikatë pronësie datë 8.8.2014 nga ZVRPP Fier, ku toka arë me sip. 13,035 m<sup>2</sup> është në pronësi të bashkëpronarëve V., S., A., D. dhe A. K., si dhe të subjektit të rivlerësimit, e cila ka 1/28 pjesë.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**3.2** ASHK Fier konfirmon<sup>29</sup> se toka arë me sip. 13,035 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e ndodhur në z. k. \*\*\*, \*\*\*, Fier, figuron e regjistruar në emër të shtetasve V., S., A., D. dhe A. K., duke bashkëlidhur të njëjtat dokumente që ka depozituar subjekti në deklaratën *Vetting*.

**3.3** Komisioni, referuar dokumentacionit të administruar, vëren se kjo pasuri është fituar nga familja bujqësore e kryefamiljarit M. K. që në vitin 1996, kur subjekti i rivlerësimit kishte pjesën e saj takuese si anëtare e familjes bujqësore. Gjithashtu, në datën 8.8.2014 është shtuar pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit në bashkëpronësi, si rrjedhojë e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë në emër të babait të saj, gjendje kjo e pasqyruar që në vitin 2014, kur familja bujqësore është pajisur me certifikatë për vërtetim pronësie nga ZVRPP Fier.

**3.4** Pavarësisht nga këto fakte, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pronësinë mbi pjesën e saj takuese të tokës bujqësore as në DIPP-në e vitit 2006 para fillimit të detyrës dhe as në DIPP-në e vitit 2014, kur toka është regjistruar në ZRPP.

---

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2023 dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2023, e ASHK-së Fier, drejtuar Komisionit.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**3.5** Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se është dakord me konstatimin e Komisionit, por mosdeklarimi i kësaj pasurie nga ana e saj në DIPP-në e vitit 2006 para fillimit të detyrës ka ndodhur për shkak se në fillimet e procesit të deklarimit të pasurive gabimisht ka vlerësuar se detyrimi për deklarim ishte për pasuritë që duhet të ishin të regjistruara në regjistrat publikë, ndërsa familja e saj në këtë moment dispononte vetëm aktin e marrjes në pronësi të tokës bujqësore. Gjithashtu, kjo pasuri ka qenë jashtë vëmendjes së subjektit të rivlerësimit për t'u deklaruar, edhe për faktin se kjo tokë arë ka qenë djerrë dhe nuk është shfrytëzuar nga familja e saj, e cila nuk ka marrë fryte prej saj, për shkak se toka ndodhet buzë lumit Seman dhe çdo vit është përmbytur nga daljet e lumit prej shtratit të tij. Në vitin 2010 subjekti i rivlerësimit është martuar, duke u shkëputur nga trangu familjar dhe me procedurën e regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRPP-në Fier janë marrë familjarët e saj, të cilët nuk e kanë njoftuar në kohë për përfundimin e kësaj procedure dhe marrjen me certifikatë pronësie. Për këtë arsye, nuk e ka deklaruar këtë pasuri as në DIPP-në e vitit 2014.

## **Vlerësimi i Komisionit**

**3.6** Në lidhje me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se të gjitha rrethanat e përmendura prej saj si shkaqe të mosdeklarimit të pasurisë tokë arë me sip. 13,035 m<sup>2</sup> janë bindëse në tërësinë e tyre për Komisionin, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se familjarët e subjektit të rivlerësimit nuk kanë pasur detyrimin për deklarim në kohën kur kanë kryer procedurën e regjistrimit të kësaj pasurie në ZRPP, si dhe faktin që kjo pasuri është fituar nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e saj përpara emërimit në detyrë dhe në mënyrë të ligjshme.

**3.7** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar, si dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me pasurinë tokë arë me sip. 13,035 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë \*\*\*, Fier.

## **4. Gjendje cash e ndodhur në shtëpi, në shumën 650,000 lekë. Pjesa takuese: 50%.**

**Burimi i krijimit:** kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit për vitin 2016.

**4.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

### ***Subjekti ka deklaruar ndër vite:***

**4.2** Në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2006: “*Gjendje cash 100,000 lekë*”.

**4.3** Në DIPP-në e viteve 2011 – 2014: “*Kursime gjendje cash në shtëpi nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit, pjesa 50%, përkatësisht: (a) DIPP e vitit 2011 – 600,000 lekë; (b) DIPP e vitit 2012 – 550,000 lekë; (c) DIPP e vitit 2013 – 1,000,000 lekë; (ç) DIPP e vitit 2014 – 900,000 lekë*”.

**4.4** Në DIPP-në e vitit 2015: “*Kursime në gjendje cash në shtëpi deri në datën 31.12.2015. Vlera: 1,900,000 lekë. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: një pjesë nga kursimet e mbetura cash të vitit 2014*”.

dhe një pjesë nga kursimet nga të ardhurat e siguruar nga paga ime dhe e bashkëshortit në vitin 2015”.

**4.5** Në DIPP-në e vitit 2016: “Gjendje cash në shtëpi. Vlera: 650,000 lekë. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortit në vitin 2016”.

**4.6** Në DIPP-në e vitit 2017: “Gjendje cash në shtëpi. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortit për vitin 2017. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa: 50%”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**4.7** Komisioni vëren se në DIPP-të periodike për likuiditetet cash subjekti i rivlerësimit ka përdorur togfjalëshin “Kursime në gjendje cash të ndodhura në shtëpi, nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit”, duke iu referuar gjithmonë gjendjes cash në datën 31 dhjetor dhe nuk ka deklaruar shtesa/pakësime, me përjashtim të vitit 2014, kur ka deklaruar “Kursime gjendje cash nga të ardhurat për këtë vit 900,000 lekë”, duke nënkuptuar shtesë në shumën 900,000 lekë për vitin 2014.

**4.8** Komisioni vëren se subjekti ka deklaruar për herë të parë kursime cash në vitin 2006, në shumën 100,000 lekë. Për vitet 2007 – 2010 subjekti nuk ka deklaruar gjendje cash. Në vitet 2011 – 2013 subjekti ka deklaruar gjendje cash në shtëpi, përkatësisht vlerat 600,000 lekë, 550,000 lekë dhe 1,000,000 lekë. Në vitin 2014 subjekti ka deklaruar shtesë të gjendjes cash në shumën 900,000 lekë dhe, për këtë arsye, gjendja cash e pasqyruar në analizë më 31.12.2014 është 1,900,000 lekë (1,000,000 lekë gjendja cash më 31.12.2013 + 900,000 lekë, shtuar cash në vitin 2014). Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar gjendje cash e ndodhur në shtëpi deri në datën 31.12.2015, 1,900,000 lekë, ndërsa gjendja cash deri më 31.12.2016 është 650,000 lekë. Gjendja cash është analizuar për çdo vit dhe rezultati është pasqyruar në analizën financiare.

**4.9** Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, datë 25.2.2016, subjekti ka shpjeguar ndër të tjera se kursimet e deklaruara prej 600,000 lekësh në vitin 2011 i ka depozituar në Raiffeisen Bank në formën e obligacioneve në vitin 2012. Kursimet në vitin 2012 kanë qenë 550,000 lekë, ndërsa në vitin 2013 kanë qenë +450,000 lekë ose gjendje e akumuluar 1,000,000 lekë, të cilën e ka deklaruar. Në vitin 2014 kursimet familjare kanë qenë +900,000 lekë dhe gjithsej në banesë janë disponuar rreth 1,800,000 lekë. Një pjesë e tyre janë përdorur në fillim të vitit 2015 për blerje automjeti nga bashkëshorti. Arsyeja e mbajtjes së këtyre likuiditeteve është blerja e një apartamenti me sipërfaqe më të madhe.

**4.10** Në pyetësin nr. 3 Komisioni i kërkoi subjektit që të saktësojë deklarin e saj dhe të përcaktojë nëse gjendja cash prej 650,000 lekësh në vitin 2016 është shtesë (ndryshim) apo gjendje totale cash. Subjekti ka shpjeguar se shuma prej 650,000 lekësh është “shtesë” dhe njëkohësisht “gjendja totale cash që ndodhej në shtëpi në datën 31.12.2016”. Shuma prej 650.000 lekësh është shtesë për vitin 2016, pasi është realizuar nga kursimet e këtij viti, por është njëkohësisht edhe gjendja totale cash në datën 31.12.2016, pasi gjendja cash në vlerën 2,100,000 lekë (e përbërë nga 1,900,000 lekë kursime të vitit 2015 dhe 200,000 lekë kursime të pagës së bashkëshortit për 4-mujorin e parë të vitit 2016) u depozitua në bankë në datën 19.5.2016.

**4.11** Pra, referuar DIPP-ve periodike dhe shpjegimeve të subjektit në ILDKPKI dhe në pyetësin nr. 3, duket se gjendja *cash* prej 600,000 lekësh e vitit 2011 është pakësuar në vitin 2012 kur është shtuar gjendja *cash* prej 550,000 lekësh me kursimet nga pagat e vitit 2012; është shtuar në vitin 2013 shuma 450,000 lekë, për t'u realizuar në fund të këtij viti gjendja *cash* prej 1,000,000 lekësh, së cilës në vitin 2014 i shtohen edhe 900,000 lekë të ardhura nga pagat e vitit 2014 dhe gjendja *cash* në datë 31.12.2014 ka qenë 1,900,000 lekë. Në vitin 2015 gjendja *cash* prej 1,900,000 lekësh, që ka ardhur nga viti 2014, duket të jetë pakësuar gjatë vitit (pasi subjekti ka deklaruar si burim të gjendjes *cash* të vitit 2015 një pjesë nga kursimet e mbetura *cash* në vitin 2014) dhe më pas është shtuar po gjatë vitit për të arritur sërish në vlerën 1,900,000 lekë *cash* në datën 31.12.2015. Në datën 19.5.2016 gjendja *cash* ka qenë 1,900,000 lekë, si gjendje *cash* e trashëguar nga viti 2015, plus 200,000 lekë kurime të pagës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për 4-mujorin e parë të vitit 2016 dhe, në total, gjendja *cash* prej 2,100,000 lekësh që u krijua është pakësuar në datën 19.5.2016, kur kjo shumë është depozituar në bankë. Më pas, deri në datën 31.12.2016 janë shtuar *cash* 650,000 lekë nga kursimet e vitit 2016.

**4.12** Komisioni kreu analizë për verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur që të krijonin me të ardhura të ligjshme shumën 650,000 lekë për periudhën 1.5.2016 – 31.12.2016. Nga analiza e mëposhtme subjekti rezultoi me pamundësi financiare në shumën 32,737 lekë, pasi për këtë periudhë subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion 1,143,803 lekë të ardhura, me të cilat ka përballuar shpenzimet jetike në vlerën 470,184 lekë dhe ndryshimin e likuiditeteve prej 706,356 lekësh. Ndryshimi i likuiditeteve në shumën 706,356 lekë përfaqëson shtesën e gjendjes *cash* dhe të llogarive bankare për 8 muajt e mbetur të vitit 2016, nga ku 650,000 lekë është shtesa e gjendjes *cash*<sup>30</sup>.

**4.13** Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash* ndër vite, me qëllim verifikimin e gjendjes së mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016 në raport me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklaratimit të bërë në deklaratën *Vetting*, si dhe shpjegimeve të saj në ILDKPKI dhe në pyetësin nr. 3.

**4.14** Nga deklaratimet periodike rezulton se gjendja *cash* në datën 31.12.2016 përputhet me gjendjen e deklaruar në deklaratën *Vetting* (datë 29.1.2017), në shumën 650,000 lekë.

**Tabela e gjendjeve *cash* sipas deklaratimit periodik të subjektit**

<b>Deklaratë periodike</b>	<b>Deklarimi i gjendjes <i>cash</i> në deklaratat periodike</b>	<b>Gjendja <i>cash</i> në datën 31 dhjetor të çdo viti, në lekë</b>
2006	<i>Gjendje lekë cash 100,000</i>	100,000
2007	***	0
2008	***	0
2009	***	0
2010	***	0
2011	<i>Kurime në gjendje cash të ndodhura në shtëpi nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit 600,000</i>	600,000

<sup>30</sup> Për periudhën 1.5.2016 – 31.12.2016 kanë rezultuar: të ardhura = 1,143,803 lekë (të ardhura nga paga e subjektit 779,083 lekë + të ardhura nga paga e bashkëshortit 364,720); detyrime = 0 (zero); shpenzime = 470,184 lekë (shpenzime jetike = 470,184 + shpenzime udhëtimi 195,871 lekë); pasuri = 706,356 lekë; ndryshim likuiditeti (*cash* + bankë) = 706,356 lekë; të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri = -32,737 lekë.



2012	<i>Kursime në gjendje cash të ndodhura në shtëpi nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit 550,000</i>	550,000
2013	<i>Kursime në gjendje cash të ndodhura në shtëpi nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit 1,000,000</i>	1,000,000
2014	<i>Kursime në gjendje cash të ndodhura në shtëpi nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit për këtë vit 900,000</i>	1,900,000
2015	<i>Kursime në gjendje cash të ndodhura në shtëpi deri në datën 31.12.2015. Burimi i krijimit: një pjesë nga kursimet e mbetura cash të vitit 2014 dhe një pjesë nga kursimet nga të ardhurat e siguruar nga paga ime dhe e bashkëshortit në vitin 2015. Vlera: 1,900,000 lekë</i>	1,900,000
2016	<i>Gjendje cash e ndodhur në shtëpi. Burimi i krijimit: kursime nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortit për vitin 2016. Vlera: 650,000 lekë</i>	650,000
Vetting	<i>Gjendje cash e ndodhur në shtëpi. Shuma: 650,000 lekë. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortit për vitin 2016</i>	650,000

**4.15** Në lidhje me ligjshmërinë e kursimeve *cash* në shumën 650,000 lekë, me burim krijimi “të ardhurat nga pagat e vitit 2016”, Komisioni vëren se pavarësisht që subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për vitin 2016 në shumën 32,737 lekë, kjo balancë konsiderohet në një vlerë të papërfillshme, që nuk mund të cenojë ligjshmërinë e kursimeve *cash* në vitin 2016.

**4.16** Në këto kushte, për sa më sipër, rezulton se të ardhurat e deklaruara si gjendje *cash* për vitin 2016, në shumën 650,000 lekë, janë me burime të ligjshme financiare.

**4.17** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përpunet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar. Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarin dhe burimin e krijimit të shumës 650,000 lekë, gjendje *cash* e deklaruar në deklaratën *Vetting*.

**5. Blerje obligacionesh të thesarit pranë Raiffeisen Bank, me vlerë 600,000 lekë dhe periudhë maturimi 3 vjet, nga data 12.1.2012 deri më 12.1.2015. Pjesa takuese: 50%.**

**Burimi i krijimit:** kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit.

**5.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshorti i subjektit.

**5.2** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka depozituar: (i) vërtetim lëshuar nga Raiffeisen Bank, që konfirmon blerjen e obligacioneve të thesarit të emtuara në datën 12.1.2012, me afat 3-vjeçar, në emër të shtetasit A. F.; (ii) nxjerrje llogarie rrjedhëse nr. \*\*\* nga Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit A. F., për periudhën 12.1.2012 – 30.12.2016.

**Subjekti ka deklaruar ndër vite:**

**5.3** Në DIPP-në e vitit 2012: “*Blerje obligacioni me periudhë maturimi 3-vjeçare, pranë Raiffeisen Bank, dega Tiranë, në datën 12.1.2012, nga bashkëshorti A. F.. Vlera: 600,000 lekë. Pjesa: 50%*”, si dhe “*Të ardhurat nga interesat për shkak të obligacioneve të thesarit në datën 12.1.2012, në emër të bashkëshortit. Vlera: 49,924 lekë*”.

**5.4** Në DIPP-të e viteve 2013, 2014 dhe 2015 subjekti ka deklaruar të ardhurat nga interesat, përkatësisht: në vitin 2013 (shuma 48,924 lekë); në vitin 2014 (shuma 48,924 lekë); në vitin 2015 (shuma 27,180 lekë). Pjesa takuese: 50%.

#### **Analiza e burimit të krijimit të shumës 600,000 lekë për blerjen e obligacioneve, datë 12.1.2012**

**5.5** Komisioni vëren se në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e obligacioneve “kursimet nga pagat e saj dhe të bashkëshortit”, por në DIPP-në e vitit 2012, kur i ka blerë obligacionet dhe i ka deklaruar ato, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të tyre.

**5.6** Në procesverbalin e datës 25.2.2016 të ILDKPKI-së, subjekti deklaron: “...kursimet e deklaruara prej 600,000 lekësh në vitin 2011 i kemi depozituar në RBAL në formën e obligacioneve në vitin 2012. Kursimet në vitin 2012 kanë qenë 550,000 lekë, ndërsa në vitin 2013 kanë qenë +450,000 lekë ose gjendja e akumuluar ka qenë 1,000,000 lekë, të cilën e kam deklaruar...”.

**5.7** Në lidhje me ligjshmërinë e shumës 600,000 lekë, e cila ka si burim kursimet *cash* të subjektit dhe bashkëshortit të saj, Komisioni iu referua deklarimeve të gjendjes *cash* në DIPP, si dhe analizës financiare për mundësinë e krijimit të tij në vitin 2011.

**5.8** Analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për vitin 2011<sup>31</sup> ka rezultuar me balancë pozitive, pra subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasuritë, ndër të cilat edhe likuiditete të disponuara qoftë si gjendje *cash* në banesë, ashtu edhe në llogari bankare. Për këtë arsye, gjendja *cash* prej 600,000 lekësh deri në datën 31.12.2011 rezulton të jetë krijuar me burime të ligjshme financiare. Këto kursime subjekti i ka depozituar në bankë në datën 12.1.2012, ku më pas i ka investuar në obligacione.

**5.9** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që në prapësimet e saj të shpjegojë përse nuk ka deklaruar burimin e krijimit të obligacioneve në DIPP-në e vitit 2012.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**5.10** Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ky mosdeklarim ka ardhur për shkak të harresës, por mendon se kjo harresë nuk sjell ndikim në procesin e rivlerësimit ndaj saj, nisur nga faktet që ajo e ka deklaruar burimin e krijimit të obligacioneve në deklaratën *Vetting* dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 25.2.2016, si dhe në faktin që Komisioni nuk ka gjetur asnjë problematikë për ligjshmërinë e burimit dhe mundësinë financiare të krijimit të tij.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**5.11** Komisioni i vlerëson të mjaftueshme shpjegimet e subjektit në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të obligacioneve në DIPP-në e vitit 2012, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që nuk janë konstatuar probleme për burimin e ligjshëm të krijimit të shumës që ka investuar në obligacione dhe që prioritet ka deklarimi *Vetting*, i deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>31</sup> Shihni analizën financiare të vitit 2011.

**5.12** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se nuk konstatohen problematika në lidhje me pasurinë obligacione me vlerë nominale 600,000 lekë, të investuara pranë Raiffeisen Bank.

**6. Shuma 2,500,019.87 lekë në llogarinë bankare rrjedhëse në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A. F., në Raiffeisen Bank. Pjesa takuese: 50%.**

**Burimi i krijimit:** kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit, si dhe nga interesat për shkak të blerjes së obligacioneve të thesarit. Nga kjo llogari fillimisht është bërë blerja e obligacioneve të thesarit pranë Raiffeisen Bank, datë 12.1.2012, me periudhë maturimi 3 vjet dhe vlerë nominale 600,000 lekë. Më pas, në datën 19.5.2016 janë derdhur kursimet që kanë qenë në gjendje *cash* në shtëpi.

**Subjekti ka deklaruar ndër vite:**

**6.1** Në DIPP-në e vitit 2015: *“Pakësim i llogarisë në Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortit. Vlera: 192,700 lekë. Pjesa: 50%”.*

**6.2** Në DIPP-në e vitit 2016: *“Shtim në lekë në llogarinë bankare rrjedhëse në emër të bashkëshortit A. F. në Raiffeisen Bank. Vlera: 2,100,000 lekë. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortit ndër vite. Në datën 19.5.2016 janë derdhur kursimet që kanë qenë në gjendje *cash* në shtëpi. Vërtetuar me këto dokumente: nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, lëshuar në datën 23.3.2017”.*

**6.3** Në DIPP-në e vitit 2017: *“Shtim e pakësim në llogarinë personale rrjedhëse në Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortit A. F., të shumës 28,505 euro. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortit ndër vite (konkretisht shuma prej 2,499,000 lekësh e tërhequr nga llogaria rrjedhëse në emër të bashkëshortit, e përshkruar më sipër dhe shuma prej 650,000 lekësh, e cila gjendej *cash* në shtëpi), si dhe shuma prej 650,000 lekësh dhuratë nga mamaja ime. E gjitha kjo shumë ka shërbyer për prenotimin e apartamentit sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.8.2017...”.*

**6.4** Në DIPP-në e vitit 2017, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Pakësim në shumën 2,499,000 lekë në llogarinë bankare rrjedhëse në emrin tim A. F., në Raiffeisen Bank. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortes ndër vite. Në datën 4.8.2017 është bërë tërheqja e tyre”.*

**Hetimi i kryer nga Komisioni**

**6.5** Referuar nxjerrjes së llogarisë në emër të shtetasit A. F. nga Raiffeisen Bank, në datën 23.1.2017<sup>32</sup>, rezulton se kjo llogari është kredituar prej tij në datën 19.5.2016, me shumën 2,100,000 lekë, me emërtimin “Derdh kursime familjare”, ndërsa gjendja e kësaj llogarie në datën 30.12.2016 është 2,500,019 lekë.

**6.6** Raiffeisen Bank<sup>33</sup> konfirmon se llogaria bankare në emër të bashkëshortit të subjektit është çelur në datën 1.2.2011 si llogari page dhe ka funksionuar si e tillë deri më 2.4.2012, kur ka kaluar paga e fundit. Nga veprimet bankare rezulton se pagat janë tërhequr periodikisht, duke mos krijuar

<sup>32</sup> Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

<sup>33</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021.

gjendje të akumuluar. Në këtë llogari është depozituar në datën 6.1.2012 shuma 612,800 lekë, që është investuar në obligacione 3-vjeçare, të cilat janë maturuar në datën 6.1.2015. Gjatë kësaj periudhe janë kredituar në llogari interesat e obligacioneve që janë tërhequr nga mbajtësi i këtyre titujve të investimit. Me maturimin e investimit dhe kreditimin e shumës 600,000 lekë në llogarinë rrjedhëse më 6.1.2015, bashkëshorti i subjektit ka tërhequr në datën 14.1.2015 shumën 122,700 lekë dhe në datën 29.10.2015 shumën 70,000 lekë. Këto tërheqje, në total 192,700 lekë, janë deklaruar prej tij edhe në DIPP-në e vitit 2015 si “pakësim i llogarisë bankare në shumën 192,700 lekë”. Në datën 27.1.2016 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr *cash* në këtë llogari edhe 29,000 lekë nga kthimi i shumës së investuar, duke e lënë llogarinë bankare me një gjendje prej 400,775 lekësh deri më 19.5.2016, kur ka depozituar *cash* shumën 2,100,000 lekë, me përshkrimin “Derdh kursime familjare”. Në datën 4.8.2017 ka tërhequr shumën e akumuluar prej 2,499.000 lekësh, duke e mbyllur përfundimisht këtë llogari.

### **Analiza e burimit të krijimit të shumës 2,500,019 lekë, gjendje në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit në datën 31.12.2016**

**6.7** Gjatë analizës Komisioni ka vërejtur se shuma 2,500,019 lekë është krijuar nga shuma 2,100,000 lekë plus shuma 400,000 lekë.

**6.8** Në lidhje me shumën 2,100,000 lekë, në pyetësin nr. 3 subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ashtu si ka deklaruar edhe në DIPP-në e vitit 2016, në datën 19.5.2016, në llogarinë bankare rrjedhëse të bashkëshortit në Raiffeisen Bank janë derdhur kursimet që kanë qenë gjendje *cash* në banesë në atë datë në vlerën 2,100,000 lekë, krijuar nga vlera 1.900.000 lekë “kursime si gjendje totale *cash* të vitit 2015” plus 200,000 lekë “kursimet nga paga e saj dhe e bashkëshortit për 4 muajt e parë të vitit 2016”.

**6.9** Për sa u konstatua më lart, në datën 19.5.2016 bashkëshorti i subjektit ka depozituar në Raiffeisen Bank shumën 2,100,000 lekë, me burim “kursimet që kanë qenë gjendje *cash* në shtëpi”. Sipas DIPP-së së vitit 2015, gjendja *cash* në datën 31.12.2015 ka qenë 1,900,000 lekë. Kjo shumë së bashku me tërheqjet nga bankat deri në datën 19.5.2016, prej 478,500 lekësh (që vijnë nga pagat e derdhura në bankë gjatë 4 muajve të parë të vitit 2016), është e mjaftueshme për të justifikuar depozitimin e shumës 2,100,000 lekë.

**6.10** Në lidhje me ligjshmërinë e shumës 2,100,000 lekë, e cila ka si burim kursimet *cash* të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, Komisioni iu referua deklarimeve të gjendjes *cash* në DIPP, si dhe analizës financiare për mundësinë e krijimit të tyre në vitet përkatëse. Duke marrë në konsideratë deklarin e subjektit të rivlerësimit se shuma 2,100,000 lekë ka si burim gjendjen *cash* prej 1,900,000 lekësh në datën 31.12.2015, si dhe deklarin e tij në DIPP-në e vitit 2015 se kjo shumë ka si burim një pjesë të gjendjes *cash* në datën 31.12.2014 dhe një pjesë të kursimeve *cash* të vitit 2015, Komisioni ndaloi në analizimin e ligjshmërisë së gjendjes *cash* ndër vite.

**6.11** Analiza financiare për periudhën 2004 – 2013 ka rezultuar me balanca pozitive, pra subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë, ndër të cilat edhe likuiditete të disponuara qoftë si gjendje *cash* në banesë, ashtu

edhe në llogari bankare. Për këtë arsye, gjendja *cash* prej 1,000,000 lekësh deri në datën 31.12.2013 rezulton të jetë krijuar me burime të ligjshme financiare.

**6.12** Analiza financiare e subjektit për vitet 2014 – 2015 rezulton me balancë negative në shumën 159,627 lekë për vitin 2014 dhe në shumën 16,236 lekë për vitin 2015.

**6.13** Gjatë vitit 2014 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë shtuar gjendjen *cash* me 900,000 lekë, duke krijuar në datën 31.12.2014 gjendjen *cash* 1,900,000 lekë. Kjo gjendje *cash* është mbajtur edhe për vitin 2015, pavarësisht se gjatë këtij viti ata kanë përdorur një pjesë të gjendjes *cash* të mbartur nga viti 2014, të cilin më pas e kanë zëvendësuar për të ruajtur të pandryshuar gjendjen prej 1,900,000 lekësh. Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime të mjaftueshme në vitet 2014 – 2015 për të paguar shpenzimet, për të krijuar pasurinë dhe disponuar gjendje *cash*, por mungesa e tyre është në një masë të tillë sa nuk e cenon ligjshmërinë e kursimeve *cash* prej 1,900,000 lekësh, të përdorur për depozitimin e shumës 2,100,000 lekë në datën 19.5.2016.

**6.14** Në lidhje me shumën 400,000 lekë, e mbartur në llogarinë bankare përpara depozitimit të shumës 2,100,000 lekë, Komisioni vëren se ajo ka si burim krijimi “kthimin e investimit në obligacione thesari”, për të cilin u vërtetua ligjshmëria e krijimit.

**6.15** Në datën 4.8.2017, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr nga kjo llogari bankare në Raiffeisen Bank shumën 2,499,000 lekë, që është përdorur për blerjen e një apartamenti me sip. 116.34 m<sup>2</sup> në vlerën takuese 28,500 euro, si bashkëpronar në Rrugën e \*\*\*, në datën 8.8.2017.

**6.16** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarin dhe burimin e krijimit të shumës 2,500,019 lekë, gjendje në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit pranë Raiffeisen Bank.

**7. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\* (aktualisht \*\*\*), blerë sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.5.2015, nga ana e bashkëshortit shtetasit E. B.. Vlera: 7,500 euro. Pjesa takuese: 50%.**

**Burimi i krijimit:** kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit.

**7.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

**7.2** Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar: “*Blerje e automjetit të markës “Mercedes-Benz”, me nr. shasie \*\*\*, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.5.2015, të lidhur pranë noteres E. M. (G.) nga ana e bashkëshortit dhe shtetasit E. B. (bashkëlidhur deklaratës kontrata noteriale dhe certifikata e pronësisë së automjetit). Vlera: 7,500 euro. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: një pjesë nga kursimet cash të vitit 2014 dhe një pjesë nga kursimet nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit të vitit 2015”.*

**7.3** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka depozituar: (i) kontratë shitblerjeje automjeti<sup>34</sup> datë 22.5.2015, sipas së cilës bashkëshorti i subjektit ka blerë nga shitësi E. B. (i përfaqësuar me

<sup>34</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.5.2015, e noteres E. M. (G.).

prokurë<sup>35</sup> nga E. L. – bashkëshorti i motrës së A. F.) automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2008, kundrejt çmimit 7,500 euro, që është likuiduar: kësti i parë prej 2,755 euro në datën 30.4.2015 në llogarinë e shitësit në Raiffeisen Bank për mbylljen e detyrimit ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., Tiranë; pjesa e mbetur prej 4,745 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në këtë kontratë citohet se shitësi është pronar i këtij automjeti me kontratë shitjeje datë 19.5.2015 dhe e ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., Tiranë; (ii) certifikatë pronësie e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\* dhe leja e qarkullimit nr. \*\*\*, të lëshuara në datën 29.5.2015 në emër të shtetasit A. F.; (iii) deklaratë doganore datë 22.12.2008, me të cilën shoqëria “\*\*\*\*” e ka zhdoganuar këtë automjet me vlerë totale 3,495,656 lekë (çmimi 2,823,570 lekë + taksë zhdoganimi 672,086 lekë).

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**7.4** Nga shqyrtimi i dosjes së automjetit<sup>36</sup> nga Komisioni rezultoi se blerësi “\*\*\*\*” sh.p.k. e ka blerë këtë automjet në vlerën totale 3,495,656 lekë<sup>37</sup>, ndërsa me faturë tatimore datë 26.8.2009 ia ka shitur shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. kundrejt çmimit 32,000 euro (4,160,000 lekë). Me kontratë shitjeje<sup>38</sup> datë 19.5.2015, shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. ia ka shitur automjetin blerësit E. B. kundrejt vlerës 1 euro, pasi kishin lidhur më parë midis tyre kontratë qiraje financiare datë 8.9.2009. Me kontratë shitblerjeje datë 22.5.2015, shtetasi E. B. ia ka shitur automjetin blerësit A. F., kundrejt çmimit 7,500 euro (1,056,750 lekë).

**7.5** Komisioni ka administruar kontratën e qirasë financiare<sup>39</sup> nr. \*\*\*, datë 8.9.2009, të lidhur midis qiradhënësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., qiramarrësit E. B. dhe dorëzanësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ku është përcaktuar çmimi final i blerjes 32,000 euro për automjetin tip “Mercedes-Benz E220 CDI”, me targë \*\*\*, vit prodhimi 2008, që do të shlyhet me qira mujore prej 549 euro.

**7.6** Nga hetimi në AMF rezulton se nga data 4.11.2015 deri më 22.7.2022 bashkëshorti i subjektit ka qenë pronar dhe përdorues i vetëm i automjetit me targë \*\*\*.

**7.7** Në lidhje me këtë fakt, nga shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit standard ka rezultuar se nga nëntori i vitit 2014 deri në datën 22.5.2015 ajo dhe bashkëshorti i saj kanë përdorur automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, që ka qenë në pronësi të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. dhe në përdorim të shtetasit E. B., midis të cilëve ishte lidhur kontratë qiraje *leasing*. Gjatë kësaj periudhe, bashkëshorti i saj ka qenë në negociatë me shtetasin E. B. për kalimin e pronësisë së automjetit, por duke qenë se ky i fundit nuk kishte bërë pagesat e kësteve me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. sepse kishte vështirësi financiare, nuk mund të bëhej kalimi i pronësisë së automjetit. Në përfundim të negociatave u dakordësua që pagesat e kësteve të mbetura ndaj

<sup>35</sup> Prokurë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.11.2014, me të cilën shtetasi E. L. ka marrë tagrin të mbyllë kredinë e automjetit, duke bërë pagesën e kështit dhe të shesë automjetin tek blerësi, të cilën do ta gjejë ai vetë dhe të firmosë kontratën e shitjes me blerësin.

<sup>36</sup> Dosje e dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, të DPSHTRR-së dërguar Komisionit.

<sup>37</sup> Automjetin e blen nga shoqëria “\*\*\*\*” me faturë shitjeje datë 27.11.2008, kundrejt çmimit 22,900 euro (2,823,570 lekë) dhe më pas e zhdoganon sipas aktit të zhdoganimit datë 22.12.2008 për vlerën 672,086 lekë, duke bërë kështu që vlera totale e automjetit të shkojë 3,495,656 lekë.

<sup>38</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.5.2015.

<sup>39</sup> Kontratë qiraje financiare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.9.2009, noter J. Zh..

shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. të bëheshin nga shtetasi A. F. dhe pasi u bënë u realizua kontrata<sup>40</sup> e shitjes datë 22.5.2015 midis shtetasve A. F. dhe E. B..

**7.8** Referuar shkresave<sup>41</sup> të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioni nuk konstatoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit dhe shitësve E. B., shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. dhe organeve drejtuese të saj.

**7.9** Në pyetësin nr. 3 Komisioni i kërkoi subjektit që: (i) të japë shpjegime në lidhje me blerjen e automjetit nga bashkëshorti i saj me një çmim më të ulët sesa çmimi që e kishte blerë shtetasi E. B. para 6 vjetësh; (ii) të shpjegojë nëse ka njohje me këtë shtetas; (iii) të përcaktojë sa nga kursimet *cash* të deklaruara në vitin 2014 janë përdorur për blerjen e automjetit, si dhe të depozitojë dokumentacionin ligjor që vërteton pagesat e kryera nga shtetasi E. B. në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.

**7.10** Në përgjigje të saj subjekti ka shpjeguar se shtetasin E. B. e kanë njohur nëpërmjet shtetasit E. L. (kunati i bashkëshortit të saj), me të cilin në nëntor të vitit 2014 shtetasi E. B. është konsultuar në lidhje me disa çështje ligjore civile dhe për një kontratë qiraje *leasing* që ky i fundit kishte lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. Meqenëse shtetasi E. B. nuk kishte mundur t’i paguante të gjitha këstet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. deri në vitin 2012, për shkak të paaftësisë së tij paguese, atëherë në datën 15.11.2014 nëpërmjet një prokure të posaçme ka autorizuar shtetasin E. L. që të mbyllë problemin e kredisë së automjetit, kalimin e pronësisë së tij nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. në emër të tij, gjetjen e një blerësi për automjetin, përcaktimin e çmimit të shitjes dhe lidhjen e kontratës së shitjes me të. Në nëntor të vitit 2014, shtetasi E. L. i ka propozuar bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit të blejë automjetin që shtetasi E. B. kishte marrë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. dhe kanë rënë dakord për çmimin 7,500 euro, pasi automjeti kishte disa defekte dhe ishte amortizuar ndër vite. Nga çmimi 7,500 euro do të zbritej vlera e detyrimit të prapambetur që shtetasi E. B. kishte ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. dhe kjo vlerë do të paguhej nga bashkëshorti i subjektit meqenëse llogaritë bankare të shtetasit E. B. ishin të bllokuara. Çmimi përfundimtar i shitjes në kontratë është 7,500 euro (kësti i parë prej 2,755 euro është paguar nga shtetasi A. F., sipas mandatpagesës datë 30.4.2015 pranë Raiffeisen Bank, për llogari të shtetasit E. B. për mbylljen e detyrimit ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.; kësti i dytë prej 4,745 euro është likuiduar jashtë kësaj zyre noteriale). Në vijim, subjekti shpjegon se nuk ka qenë asnjëherë në konflikt interesi me shtetasin E. B., prandaj nuk ka pasur trajtim preferencial për çmimin e automjetit.

**7.11** Për të provuar shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) dokumentin “Depozitim për të tretë”, datë 30.4.2015, lëshuar nga Raiffeisen Bank, që provon pagesën e detyrimit në shumën 2,755 euro, e kryer nga shtetasi A. F. në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. dhe për llogari të debitorit E. B., me përsëkrimin “Pagesë detyrimi për llogari të debitorit E. B.”; (ii) ekstraktin e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me administrator E. B., ku janë pasqyruar urdhrat e sekuestros së Zyrës Përmbarimore nr. \*\*\* regj., datë 23.10.2012, nr. \*\*\*, datë 26.3.2014, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2015, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë për vendosje të sekuestrove

<sup>40</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.5.2015, notere E. M. (G.).

<sup>41</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

konservative ndaj titujve të pronësisë dhe aktiveve të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe ndaj aksioneve të shtetasit E. B. në këtë shoqëri, me qëllim për të provuar pamundësinë financiare të këtij shtetasi për pagimin e vlerës së automjetit që kishte blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a.; (iii) urdhrat e sekuestros së Zyrës Përmbartimore nr. \*\*\* regj., datë 23.10.2012 dhe nr. \*\*\*, datë 26.3.2014.

**7.12** Në lidhje me kërkesën e Komisionit drejtuar subjektit të rivlerësimit, që të përcaktojë sa nga kursimet *cash* të deklaruar në vitin 2014 janë përdorur për blerjen e mjetit dhe të depozitohet dokumentacionin ligjor që vërteton pagesat e kryera nga shtetasi E. B. në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., subjekti ka shpjeguar se nga kursimet *cash* të deklaruar në vitin 2014 shuma prej 800,000 lekësh është përdorur për blerjen e automjetit. Ndërsa, në lidhje me pagesat e kryera nga shtetasi E. B. në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., subjekti ka depozituar: (i) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2023, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës; (ii) pasqyrën e pagesave të kryera nga shtetasi E. B. pranë bankave të nivelit të dytë për kontratën e qirasë financiare nr. \*\*\*, datë 8.9.2009 dhe për llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.<sup>42</sup>

**7.13** Nga këto dy shkresa rezulton se shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. nuk disponon kopje të pagesave, pasi marrëdhënia e saj me shtetasin E. B. është mbyllur që në vitin 2015 dhe kjo shoqëri ka vënë në dispozicion një përshkrim bankar të disa pagesave të kryera nga shtetasi E. B. nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ku ai është ortak i vetëm dhe administrator, si dhe nga bashkëshortja e tij (administratore e shoqërisë “\*\*\*\*” që nga data 18.2.2010 deri në datën 25.2.2011). Sipas këtij përshkrimi bankar rezulton se shtetasi E. B., bashkëshortja e tij dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. kanë paguar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. rreth 25,000 euro deri në datën 2.7.2012, por shuma e saktë nuk është e mundur të evidentohet, pasi jo të gjitha pagesat e kryera e kanë të cilësuar qëllimin “këst mujor i qirasë *leasing* për automjet”. Për rreth 3 vjet nuk janë kryer më pagesa për shlyerjen e kësteve të automjetit, deri kur në datën 30.4.2015 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer pagesën prej 2,754 euro në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., me përshkrimin “Pagesë detyrimi për llogari të debitorit E. B.”.

### **Analiza e burimit të krijimit të shumës 7,500 euro për blerjen e automjetit në datën 22.5.2015**

**7.14** Referuar: (i) deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* se si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet nga paga e saj dhe e bashkëshortit; (ii) deklarimit në DIPP-në e vitit 2015, ku specifikon me detaje këtë burim, duke deklaruar “Një pjesë nga kursimet në *cash* të vitit 2014 dhe një pjesë nga kursimet me të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit të vitit 2015”; (iii) deklarimit në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 25.2.2016<sup>43</sup>; (iv) përgjigjes në pyetësin nr. 3, ku subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga gjendja *cash* e vitit 2014 ka përdorur shumën 800,000 lekë – Komisioni verifikoi deklarimin e kursimeve *cash* ndër vite, nga ku rezultoi se gjendja *cash* në datën 31.12.2014 është në shumën 1,900,000 lekë. Balanca negative që ka rezultuar për vitin 2014 në shumën 159,627 lekë nuk e cenon

<sup>42</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2023, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.

<sup>43</sup> “...Në vitin 2014 kursimet familjare kanë qenë +900,000 lekë dhe gjithsej në banesë kanë disponuar shumën rreth 1,800,000 lekë. Një pjesë e tyre janë përdorur në fillim të vitit 2015 për blerje automjeti nga bashkëshorti”.



ligjshmërinë e kursimeve *cash* prej 800,000 lekësh të përdorura për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në shumën 7,500 euro ose 1,032,375 lekë.

**7.15** Komisioni, për sa ka konstatuar më sipër, vëren se në datën 30.4.2015, kur bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka likuiduar në bankë për llogari të shtetasit E. B. shumën 2,755 euro (ose 379,226 lekë), ka pasur në dispozicion kursimet *cash* prej 800,000 lekësh.

**7.16** Gjithashtu, deri në datën 22.5.2015, kur ka finalizuar blerjen e automjetit nëpërmjet kontratës së shitblerjes, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur në dispozicion burime të ligjshme financiare për pagesën e shpenzimeve dhe blerjen e automjetit<sup>44</sup>.

**7.17** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit më dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarin dhe burimin e krijimit automjetit tip “Mercedes-Benz” në datën 22.5.2015, me çmimin 7,500 euro.

**8. Apartament me sip. 77.60 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*”, hyrja \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në pronësi të babait të bashkëshortit, z. K. F..** Ky apartament përdoret aktualisht në mënyrë të përbashkët nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti, djali dhe babai i bashkëshortit.

**Burimi i krijimit:** \_\_\_\_\_

**8.1** Kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *Vetting* edhe nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

**8.2** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka depozituar certifikatën për vërtetim pronësie, datë 25.11.2016, ku apartamenti me sip. 77.6 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Tiranë, figuron në emër të pronarit K. F., vjehri i subjektit të rivlerësimit.

**Hetimi i kryer nga Komisioni**

**8.3** Komisioni ka administruar dokumentet<sup>45</sup>: (i) kontratë sipërmarrjeje datë 14.10.2004, e lidhur midis sipërmarrësit K. M. dhe porositësit K. F., për ndërtimin e apartamentit me sip. 85.2 m<sup>2</sup>, kati 3, kundrejt çmimit 34,640 euro, për të cilin palët janë dakordësuar të paguhet me 4 këste; (ii) librezë energjisë elektrike në emër të shtetasit K. F. për këtë apartament, ku figurojnë pagesa për periudhën janar 2015 – janar 2016; (iii) procesverbal i ILDKPKI-së datë 25.2.2016, ku subjekti ka deklaruar se pas vitit 2010 jeton në këtë apartament së bashku me bashkëshortin dhe vjehrin. Ky apartament është blerë nga familja e bashkëshortit me kursimet e tyre ndër vite. Apartamenti nuk është i regjistruar në ZRPP, por kontrata e blerjes dhe librezat e dritave, ujit etj., janë në emrin e vjehrit K. F.; (iv) deklaratë noteriale<sup>46</sup>, ku shtetasi K. F. deklaroi se në zbatim të kontratës së shitjes, me kusht kreditimi datë 17.1.2017, që ka lidhur me blerësit S. e E. B. (bashkëlidhur kësaj

<sup>44</sup> Analiza për periudhën 1.1.2015 – 22.5.2015: të ardhurat = 509,661 lekë (të ardhura nga paga e subjektit 475,461 lekë + të ardhura nga paga e bashkëshortit 34,200 lekë); detyrime = 0 (zero); shpenzime = 224,276 lekë (shpenzime jetike 224,276 lekë + shpenzime udhëtimi 0); pasuri = 163,946 (automjet tip “Mercedes-Benz” me çmimin 7,500 euro ose 1,032,375 lekë – ndryshim likuiditeti (*cash* + bankë) 868,429 lekë); të ardhura + detyrime – shpenzime – pasuri = 121,439 lekë.

<sup>45</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2021, të ILDKPKI-së.

<sup>46</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.2.2017, sipas shkresës datë 13.3.2023, të noteres M. S..

deklarate) për shitjen e apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerësit kanë depozituar në numrin e llogarisë së noteres M. S. çmimin e shitjes 55,000 euro, prandaj deklaruesi kërkon që të hiqet bllokimi i apartamentit dhe të regjistrohet i lirë në emër të palës blerëse; (v) deklaratë noteriale<sup>47</sup>, ku E. V., E. L. dhe A. F. (fëmijët e K. F.) deklarojnë se nuk kanë pretendime pasurore as në rast tjetërsimi të këtij apartamenti në favor të të tretëve, i cili është në pronësi të babait të tyre dhe që e ka përfituar me të ardhurat dhe kontributin e tij financiar, etj.

**8.4** Në pyetësonin nr. 1 subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga korriku i vitit 2009 deri në datën 4.3.2017 ka përdorur pa kundërshtim, së bashku me bashkëshortin, apartamentin në pronësi të vjehrrit në adresën: Njësia Administrative Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, shkalla \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Tiranë.

**8.5** Bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) kontratë shitjeje<sup>48</sup> datë 22.11.2016, e lidhur midis shitësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shoqëria “K. M.” sh.p.k.<sup>49</sup> dhe blerësit K. F., për shitjen e këtij apartamenti, kundrejt çmimit 34,640 euro, që është likuiduar me këste totalisht deri në datën 16.10.2006; (ii) mandatpagesa të kësteve për likuidimin total të çmimit të këtij apartamenti<sup>50</sup> që nga data 14.10.2004 deri në datën 16.10.2006; (iii) certifikatë pronësie të apartamentit, datë 25.11.2016, në emër të shtetasit K. F.; (iv) kontratë shitjeje apartamenti, me kusht kreditimi datë 17.1.2017<sup>51</sup>, e lidhur midis shitësit K. F. dhe blerësve S. e E. B., për shitjen e këtij apartamenti, kundrejt çmimit 55,000 euro, që palët kanë përcaktuar se do të likuidohej në momentin kur blerësi të lëvrojë kredinë brenda 2 muajsh nga nënshkrimi i kontratës së shitjes.

**8.6** Referuar çmimit të shitjes sipas EKB-së për vitin 2004<sup>52</sup>, rezulton se ky çmim është 68,571 lekë/m<sup>2</sup> dhe duke u bazuar në këtë çmim vlera e apartamentit do të ishte 5,321,109 lekë ose 42,517 euro. Ndërkohë, vlera e kontraktuar e apartamentit është 34,640 euro, pra 7,877 euro më lirë.

**8.7** Referuar shkresave<sup>53</sup> të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioni nuk konstatoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k. e “K. M.” sh.p.k. dhe as organeve drejtuese të tyre.

**8.8** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri në deklaratën *Vetting*. I pyetur për këtë nga Komisioni në pyetësonin nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: (i) burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat e ligjshme të krijuara nga puna dhe kursimet ndër vite të prindërve të bashkëshortit, K. F. dhe E. F., si dhe të ardhurat e përftuara nga pensioni i pleqërisë së tyre; të ardhurat nga bursa e Shkollës së Magjistraturës e dy

<sup>47</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.1.2017, sipas shkresës datë 13.3.2023, e noteres M. S.

<sup>48</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.11.2016.

<sup>49</sup> Shitësi deri në datën 16.7.2007 quhej shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe më pas është emërtuar shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 16.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>50</sup> Mandatarkëtime të paguara nga shtetasi K. F.: nr. \*\*\*, datë 23.5.2005 (5,000 euro); nr. \*\*\*, datë 14.10.2004 (12,124 euro); nr. \*\*\*, datë 6.7.2005 (1,930 euro); nr. \*\*\*, datë 13.1.2006 (3,995 euro); nr. \*\*\*, datë 16.10.2006 (2,500 euro); nr. \*\*\*, datë 22.6.2006 (1,125 euro); mandati i BKT-së datë 22.11.2004, ku shtetasi B. V. (bashkëshorti i E. F., vajza e K. F.) ka paguar këstin e dytë prej 7,965 euro në llogari të shoqërisë “K. M.” sh.p.k.

<sup>51</sup> Kontratë shitjeje apartamenti me kusht kreditimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.1.2017.

<sup>52</sup> Udhëzimi nr. 1, datë 4.3.2004 “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K”.

<sup>53</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier dhe shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2023, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

motrave të bashkëshortit, E. F. dhe E. F., dhe më pas të ardhurat nga puna e tyre si prokurore; të ardhurat nga puna e bashkëshortit të saj. Subjekti nuk ka asnjë kontribut financiar në krijimin e kësaj pasurie; (ii) ky apartament është krijuar në vitet 2004 – 2006, përpara se subjekti të fillonte detyrën si prokurore në datën 6.10.2006; (iii) ky apartament, sipas kontratës së sipërmarrjes datë 14.10.2004 dhe kontratës së shitjes datë 22.11.2016, ka qenë në pronësi të vjehrrit K. F. dhe është krijuar si pasuri përpara se subjekti të krijonte lidhje bashkëjetese (korrik 2009) dhe më pas martesë (në datën 10.12.2010) me bashkëshortin A. F.; (iv) ky apartament është deklaruar si adresë banimi që nga DIPP-ja e vitit 2010 dhe deri në deklaratën *Vetting*, si dhe pasuri në përdorim nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

**8.9** Në vijim të kësaj përgjigjeje, subjekti ka shpjeguar gjithashtu se ka filluar të jetojë në këtë apartament në korrik të vitit 2009, kur herë ka banuar aty dhe herë në banesën e prindërve të saj në Fier, për shkak të punës si prokurore në Fier. Së bashku me bashkëshortin dhe djalin e saj kanë jetuar në këtë apartament deri në datën 4.3.2017, kur kanë shkuar të banojnë në Durrës në një apartament me qira. Për apartamentin në rrugën “\*\*\*”, vjehri i saj ka lidhur fillimisht kontratë sipërmarrjeje e më pas kontratë shitjeje, në të cilat është caktuar vlera e apartamentit 34,640 euro, që është paguar me këste deri në tetor të vitit 2006, sipas 7 mandatarkëtimeve. Edhe sipas vërtetimit datë 22.6.2007, të lëshuar nga shoqëria “K. M.” sh.p.k., vërtetohet se shtetasi K. F. e ka likuiduar të gjithë shumën prej 34,640 euro.

**8.10** Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 subjekti ka dërguar dokumentacionin provues<sup>54</sup>.

**8.11** Referuar faktit që apartamenti është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting*, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1994 – 16.10.2006, për të verifikuar nëse familja e bashkëshortit kishte mundësi financiare për të kryer pagesat për blerjen e këtij apartamenti, sipas dokumentacionit të pagesave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorë, shpenzimet jetike dhe pagesat e kryera për blerjen e apartamentit.

**8.12** Sipas analizës së mëposhtme duket se familjarët e bashkëshortit kanë rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 585,714 lekë, për pagesën e kësteve në datat 22.11.2004, 23.5.2005 dhe 6.7.2005.

---

<sup>54</sup> (i) Kontratë sipërmarrjeje datë 14.10.2004, për ndërtimin e apartamentit, e lidhur midis porositësit K. F. dhe sipërmarrësit, shoqëria “K. M.” sh.p.k., e vërtetuar me vërtetimin noterial nr. \*\*\* rep., datë 14.10.2004, nga notere I. Ç.; (ii) vërtetim datë 22.6.2007, lëshuar nga shoqëria “K. M.” sh.p.k., që konfirmon se shtetasi K. F. ka blerë pranë saj apartamentin me vlerë 34,640 euro, të cilin e ka likuiduar; (iii) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2023, i Shkollës së Magjistraturës, që vërteton pagesën e bursës nga kjo shkollë për vitet 1999 – 2001, për studenten E. F.; (iv) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2023, i Shkollës së Magjistraturës, që vërteton pagesën e bursës nga kjo shkollë për vitet 2002 – 2004, për studenten E. F.; (v) vërtetim datë 16.10.2002, i Shkollës së Magjistraturës, që konfirmon se E. F. është në vitin e parë të studimeve pranë kësaj shkolle; (vi) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2023, e DRSSH-së Berat, mbi të ardhurat nga puna si prokurore të E. F. për vitet 2000 – 2011; (vii) vërtetim nr. \*\*\*, datë 8.3.2023, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, për të ardhurat nga paga të prokurores E. F. për vitet 2001 – 2002; (viii) shkresë e DRSSH-së Vlorë, lidhur me të ardhurat nga puna si prokurore e E. F. për vitet 2004 – 2006; (ix) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2023, e ISSH-së, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, për të ardhurat nga puna të z. A. F. për periudhën 2005 – 2006; (x) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2023, e DRSSH-së Tiranë, për të ardhurat nga pensioni i pleqërisë dhe të ardhurat nga puna për periudhën 1994 – 2003, të shtetasit K. F., si dhe librezë e punës së tij; (xi) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2023, e DRSSH-së Tiranë, për të ardhurat nga pensioni i pleqërisë dhe të ardhurat nga puna për periudhën 1994 – 2002, të vjehrrës E. F., si dhe librezë e punës së saj.

Viti	1994-1999	2000-2003	14.10.2004	22.11.2004	23.5.2005	6.7.2005	13.1.2006	22.6.2006	16.10.2006	Total
Të ardhura K	383,391	426,600	82,925	21,078	52,695	11,354	79,480	56,771	47,627	1,161,922
Të ardhura E	640,130	737,892	144,709	30,158	75,394	16,262	113,835	81,311	68,258	1,907,949
Të ardhura E	56,910	1,412,017	445,794	94,543	237,607	47,521	307,407	207,461	217,326	3,026,588
Të ardhura E		427,640	401,750	113,762	284,405	62,570	437,990	312,850	262,800	2,303,767
Të ardhura A							24,584	61,460	56,000	142,044
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,080,431</b>	<b>3,004,150</b>	<b>1,075,179</b>	<b>259,540</b>	<b>650,101</b>	<b>137,708</b>	<b>963,296</b>	<b>719,853</b>	<b>652,012</b>	<b>8,542,270</b>
Shpenzime jetike	713,084	1,947,960	391,100	78,220	228,244	45,649	319,541	228,244	182,595	4,134,637
Pagesë kësti			1,517,319	1,012,352	621,950	236,946	493,862	138,239	308,150	4,328,817
Mundësia për kursim	367,347	1,056,190	-833,240	-831,031	-200,093	144,887	149,893	353,370	161,267	
Mundësia kumulative	367,347	1,423,536	590,296	-240,735	-440,827	585,714	149,893	503,263	664,530	

**8.13** Për sa më lart, pavarësisht se familjarët e bashkëshortit kanë rezultuar me balancë financiare negative në shumën 585,714 lekë për pagesën e kësteve në datat 22.11.2004, 23.5.2005 dhe 6.7.2005, por që rezultojnë me burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme në kuadër të një analize kumulative deri në datën 16.10.2006, duke qenë se kjo pasuri është krijuar përpara se subjekti i rivlerësimit të fillonte detyrën e prokurorit dhe përpara se të krijonte lidhje bashkëjetese (korrik 2009) e më pas martesë (datë 10.12.2010) me bashkëshortin A. F., Komisioni arriti në përfundimin që kjo pasuri, pavarësisht rezultatit të saj financiar, nuk ndikon në procesin e rivlerësimit dhe në vendimmarrjen për subjektin e rivlerësimit.

❖ **Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit**

**9. Apartament banimi me sip. 50 m<sup>2</sup>, me adresë Skrapar, \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati \*\*\*, nr. \*\*\*, i regjistruar në ZVRPP-në Skrapar me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, në bashkëpronësi të shtetasve A. F., K. F., E. V. (F.) dhe E. L. (F.). Vlera: 1,100,000 lekë. Pjesa takuese: 1/8.**

**Burimi i krijimit:** pjesa takuese (1/4) nga trashëgimia ligjore e nënës E. F.. Apartamenti është shitur me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.2016. Shuma e përfituar nga shitja është depozituar në Raiffeisen Bank në llogarinë rrjedhëse në emër të babait të tij K. F..

***Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar ndër vite:***

**9.1** Në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar pjesën takuese që ai zotëron në këtë apartament pas çeljes së trashëgimisë ligjore të nënës së tij E. F., sipas certifikatës së pronësisë datë 10.4.2012, të ZVRPP-së Skrapar.

**9.2** Në DIPP-në e vitit 2017 ka deklaruar shitjen e këtij apartamenti sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.2016 dhe depozitim të pjesës së tij takuese prej 137,500 lekësh në Raiffeisen Bank, në emër të babait K. F..

## Hetimi i kryer nga Komisioni

**9.3** Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti ka depozituar: (i) certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 10.4.2012, nga ZVRPP Skrapar, ku apartamenti me sip. 50 m<sup>2</sup> është në bashkëpronësi të shtetasve K., A., E. dhe E. F., me nga 1/4 pjesë (trashëgimtarë të trashëgimlënësës E. F., vjehrra e subjektit, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 6.3.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, bashkëlidhur); (ii) kontratë shitblerjeje apartamenti<sup>55</sup> datë 4.2.2016, ku bashkëpronarët Felaj ia shesin këtë apartament blerësit S. R., kundrejt çmimit 1,100,000; (iii) ekstrakt i nxjerrjes së llogarisë bankare rrjedhëse të shtetasit K. F. nga Raiffeisen Bank, në datën 20.1.2017, ku është kredituar shuma 1,100,000 lekë e shitjes së apartamentit; (iv) mandat datë 5.2.2016 nga Raiffeisen Bank, që provon pagesën e tatimit prej 28,275 lekësh mbi të ardhurat nga shitja e apartamentit, të kryer nga shtetasi K. F..

**9.4** Sipas hetimit të kryer nga Komisioni ka rezultuar se fillimisht ky apartament është privatizuar me kontratë shitblerjeje<sup>56</sup> datë 6.9.1994, e lidhur midis shitësit Ndërmarrja Komunale Banesa P. dhe blerësit K. F., kundrejt çmimit 4,310 lekë, i cili është regjistruar me certifikatë pronësie datë 23.3.2010 pranë ZVRPP-së Skrapar, në bashkëpronësi të shtetasve E. dhe K. F.<sup>57</sup>.

**9.5** Pra, rezulton se kjo është një pasuri e krijuar në vitin 1994 nga familja e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit përpara fillimit të detyrës dhe përpara martesës së saj me shtetasin A. F., si dhe është shitur në datën 4.2.2016, duke paguar detyrimet tatimore mbi të ardhurat nga shitja.

**9.6** Nisur nga fakti se këto të ardhura janë përdorur nga vjehri i subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit në bashkëpronësi me djalin e tij (bashkëshortin e subjektit), si dhe fakti se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* pjesën e tij takuese në këtë pasuri, Komisioni, me pyetësorin nr. 3, i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime dhe dokumentacion ligjor për të provuar që bashkëpronarët e tjerë të apartamentit me sip. 50 m<sup>2</sup> në Skrapar nuk kanë përfituar të ardhura nga shitja e këtij apartamenti dhe e gjithë shuma është përfituar nga vjehri i subjektit.

**9.7** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të saj, ka deklaruar njësoj si në pyetësorin nr. 1, se vjehri ka qenë bashkëpronar së bashku me fëmijët e tij E., E. dhe A., të cilët janë bërë bashkëpronarë në këtë pasuri për shkak të çeljes së trashëgimisë ligjore të nënës së tyre E. F.. Shtetasja E. F. (V.), vajza e vjehrit, ka lëshuar deklaratë noteriale datë 31.8.2011, ku deklaron heqjen dorë nga pjesa e pasurisë trashëgimore, por nuk e depozitoi në kohë këtë deklaratë pranë ZRPP-së. Dy fëmijët e tjerë A. dhe E., për shkak të harresës, nuk e shprehën këtë vullnet me akt noterial, brenda afatit ligjor 3-mujor nga dita e çeljes së trashëgimisë. Pavarësisht këtij fakti, të tre fëmijët nuk e ndryshuan asnjëherë qëndrimin dhe vullnetin e tyre të lirë, por të ardhurat nga shitja e apartamentit ia dhuruan verbalisht babait të tyre K. F., duke lejuar kalimin e saj në llogarinë bankare të tij, disponimin dhe përdorimin vetëm nga ai. Të tre fëmijët ia kanë dhuruar verbalisht pjesën e tyre takuese në këtë pasuri babait të tyre K. F., duke lejuar kalimin e të ardhurave nga shitja e apartamentit në llogarinë e tij bankare personale. Këto të ardhura janë disponuar dhe përdorur

<sup>55</sup> Kontratë shitblerjeje apartamenti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.2016, noter E. L..

<sup>56</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.9.1994, noter E. L..

<sup>57</sup> Sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2021, nga ASHK Skrapar.

vetëm nga ai. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar deklarinimin e tij, ka depozituar ndër të tjera disa dokumente<sup>58</sup>.

**9.8** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i bashkëshortit të subjektit me dokumentacionin e administruar nga Komisioni dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

### **Konstatime të tjera**

**10. Në DIPP-në e vitit 2017**, subjekti ka deklaruar: *“Tokë arë me sip. 1,000 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me adresë \*\*\*, Fier, e regjistruar në ZVRPP-në Fier në emrin tim dhe 12 bashkëpronarë të tjerë: S. K., S. K., A. K., D. K., A. K., V. K., Gj. M., M. V., N. K., Th. P. dhe L. M.. Vlera: 83,755 lekë”*.

**Burimi i krijimit:** *“Trashëgimia ligjore e babait tim M. K. dhe gjyshes N. K., e cila e ka përfituar sipas ligjit nr. 7501, viti 1991, si anëtare e familjes bujqësore. Pjesa ime takuese prej 1/196B dhe e bashkëpronarëve të tjerë në këtë pasuri i është shitur bashkëpronarit S. K. (xhaxhai im) me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2012.*

*Vërtetuar me këto dokumente: certifikatë pronësie datë 4.10.2012...; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. \*\*\*, datë 19.7.2012, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së babait tim M. K.; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr.\*\*\*, datë 27.6.2012, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së gjyshes sime N. K.; kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2012”*.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**10.1** ZVRPP Fier<sup>59</sup> ka depozituar dokumentet: (i) certifikatë pronësie datë 7.3.2012, ku shtetasja N. K. ka qenë pronare e tokës arë me sip. 1,000 m<sup>2</sup>, të ndodhur në \*\*\*, Fier; (ii) certifikatë familjare, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr. \*\*\* Fier, që pasqyron gjendjen e familjes së shtetasës N. K. në datën 1.10.1992; (iii) kontratë shitblerjeje<sup>60</sup> datë 8.10.2012, ku subjekti me 12 bashkëpronarë të tjerë i shesin këtë pasuri blerësit S. K., kundrejt çmimit 83,755 lekë.

**10.2** Bashkëlidhur pyetësorit nr. 1 subjekti ka depozituar, përveç dokumenteve më lart, edhe: (i) aktin datë 24.6.1997, të marrjes në pronësi të tokës arë me sip. 1,000 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasës N. Ll. K.; (ii) certifikatën e pronësisë datë 4.10.2012, ku toka arë me sip. 1,000 m<sup>2</sup> është regjistruar në emër të 13 bashkëpronarëve.

---

<sup>58</sup> (i) Ekstrakt historik i llogarisë bankare në lekë, datë 20.1.2017, nga Raiffeisen Bank, në emër të shtetasit K. F., nga ku rezulton se shuma prej 1,100,000 lekësh, e përfituar nga shitja e apartamentit në P., është kaluar në llogarinë e këtij shtetasi në datën 10.2.2016; (ii) mandati i tërheqjes së shumës 1,100,000 lekë prej shtetasit K. F. nga llogaria bankare e mësipërme, me datë 3.8.2017; (iii) ekstrakt i llogarisë bankare në euro të shtetasit K. F. pranë Raiffeisen Bank, ku pasqyrohet se në datën 8.8.2017 ky shtetas ka depozituar në këtë llogari shumën 16,515 euro, e cila është shumatorë e shumës 1,100,000 lekë, e përfituar nga shitja e apartamentit në P. dhe e shumës 1,112,900 lekë, e tërhequr nga depozita bankare në ABI Bank, të cilat janë konvertuar më pas në euro; (iv) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.8.2011, e shtetasës E. F., e cila deklaron se si trashëgimtare e nënës së saj heq dorë nga kjo trashëgimi, pa asnjë kusht apo kundërshpërblim.

<sup>59</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2017, që ZRPP-ja ka depozituar pranë ILDKPKI-së.

<sup>60</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2012, notere F. Z..

**10.3** ASHK Fier konfirmon<sup>61</sup> se subjekti, bashkëshorti, djali, nëna dhe vjehri i saj nuk kanë të regjistruar pasuri të paluajtshme në Fier.

**10.4** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

**11. Në DIPP-në e vitit 2017**, subjekti ka deklaruar: *“Tokë arë me sip. 13,320 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me adresë Fier, \*\*\*, e regjistruar në ZVRPP-në Fier në emrin tim dhe 12 bashkëpronarë të tjerë: S. K., S. K., A. K., D. K., A. K., V. K., Gj. M., M. V., N. K., Th. P. dhe L. M.. Vlera: 1,133,206 lekë. Pjesa: 50%”*.

**Burimi i krijimit:** *“Trashëgimia ligjore e babait tim M. K. dhe gjyshes N. K., e cila e ka përfutur sipas ligjit nr. 7501, viti 1991, si anëtare e familjes bujqësore. Pjesa ime takuese prej 1/196B dhe e bashkëpronarëve të tjerë në këtë pasuri i është shitur si e pandarë bashkëpronarit S. K. (xhaxhai im) me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2012, lidhur në Fier pranë noteres F. Z.*

*Vërtetuar me këto dokumente: certifikatë pronësie datë 4.10.2012; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. \*\*\*, datë 19.7.2012, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së babait tim M. K.; vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr.\*\*\*, datë 27.6.2012, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së gjyshes sime N. K.; kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2012”*.

**11.1** ZVRPP Fier konfirmon<sup>62</sup> se shtetasja Alma Felaj dhe 12 bashkëpronarë të tjerë kanë pasur në pronësi pasurinë arë me sip. 13,530 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* dhe ua kanë shitur shtetasve S. L. K. dhe L. V. K. në datën 11.12.2012. Bashkëlidhur ZRPP-ja ka depozituar<sup>63</sup>: (i) certifikatë pronësie datë 7.3.2012, ku toka arë me sip. 13,530 m<sup>2</sup> ka qenë regjistruar në emër të shtetasës N. K. (gjyshja e subjektit të rivlerësimit); (ii) kartelë pasurie datë 29.8.2012, ku toka arë me sip. 13,530 m<sup>2</sup> është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe 12 bashkëpronarëve të tjerë; (iii) vendim nr. \*\*\*, datë 27.6.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së të ndjerës N. K.<sup>64</sup>; (iv) kartelë pasurie nr. \*\*\*, tokë arë me sip. 13,530 m<sup>2</sup>, që ka kaluar në pronësi të shtetasve S. dhe L. K..

**11.2** Në pyetësorin standard subjekti ka bashkëlidhur kontratë shitjeje<sup>65</sup> datë 8.10.2012, e lidhur midis 12 bashkëpronarëve K. me cilësinë e shitësit dhe S. K. me cilësinë e blerësit, për shitjen e tokës arë me sip. 13,530 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 1,133,206 lekë, etj.

**11.3** Komisioni vëren se sipërfaqja e tokës arë prej 13,320 m<sup>2</sup>, që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit, nuk përputhet e sipërfaqen e tokës arë prej 13,530 m<sup>2</sup>, që rezulton nga dokumentacioni i administruar.

<sup>61</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021, e ASHK-së Fier, drejtuar Komisionit.

<sup>62</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

<sup>63</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2017, depozituar pranë ILDKPKI-së.

<sup>64</sup> N. K. ka ndërruar jetë në datën 13.3.1996.

<sup>65</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.10.2012.

**11.4** Për sa më lart, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit që të shpjegojë për sa duket se në lidhje me sipërfaqen e pasurisë ka pasaktësi në deklarin e subjektit të rivlerësimit kur citon 13,320 m<sup>2</sup> krahasuar me dokumentacionin ligjor ku citohet 13,530 m<sup>2</sup>.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**11.5** Në prapësime, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo pasaktësi është vetëm një “gabim material” dhe për këtë sjell në vëmendje se në pyetësin standard e ka deklaruar sipërfaqen pasurisë në mënyrë të saktë dhe në përputhje me dokumentacionin ligjor, duke cituar: “*Kam pasur në emrin tim edhe 12 bashkëpronarëve të tjerë, S. K., S. K., A. K., D. K., A. K., V. K., Gj. M., M. V., N. K., Th. P., L. M., pasurinë: tokë arë me sip. 13,530 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me adresë Fier, \*\*\*, e regjistruar në ZVRPP-në Fier*”.

#### **Vlerësimi i Komisionit**

**11.6** Në lidhje me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se mospërputhja e sipërfaqes së tokës prej 13,320 m<sup>2</sup>, që ka deklaruar me sipërfaqen e pasqyruar në dokumentacion, është gabim material, Komisioni, referuar edhe deklarin në *Vetting*, deklarin në pyetësin standard, si dhe dokumentacionit të administruar e atij të depozituar nga vetë subjekti, vlerëson se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit është bindës.

**11.7** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se nuk konstatohen problematika në lidhje me pasurinë tokë arë me sip. 13,530 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me adresë \*\*\*, Fier.

**11.8** Për të dyja pasuritë e pasqyruara në pikat 10 dhe 11, Komisioni arrin në përfundimin se ato janë përfituar në mënyrë të ligjshme nga ana e trashëgimlënësve të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet ligjit nr. 7501/1991 “Për Tokën” dhe subjekti e ka përfituar pjesën e saj takuese nëpërmjet çeljes së trashëgimisë ligjore në vitin 2012, vit në të cilin edhe janë shitur. Pavarësisht mosdeklarimit të pjesës së saj takuese dhe pjesës së saj tek të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre në DIPP-në e vitit 2012, Komisioni e konsideron këtë element si një pasaktësi me një peshë minimale në kuadër të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit në tërësi, si dhe me një impakt të papërfillshëm në analizën financiare të subjektit për vitin 2012, e cila gjithsesi rezulton me balancë financiare pozitive.

**12.** Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “*Pjesa takuese në apartamentin nr. \*\*\*, me sipërfaqe totale ndërtimi 116.34 m<sup>2</sup> (16.64 m<sup>2</sup> sipërfaqe e përbashkët), i ndodhur në katin e dytë të banimit në Rrugën e \*\*\*, Tiranë. Ky apartament është prenotuar sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.8.2017, të lidhur në Tiranë, midis palës sipërmarrëse, shoqëria “\*\*\*\*” dhe palës porositëse K. F. dhe A. F.. Pjesa: 28.5%*”.

**Burimi i krijimit:** “*Pjesa takuese e bashkëshortëve A. F. dhe A. F., në masën 28.5% ose 28,500 euro, është krijuar nga kursimet e përfituara nga paga ndër vite (konkretisht shuma prej 2,499,000 lekësh e tërhequr nga llogaria rrjedhëse në emër të bashkëshortit, shuma prej 650,000 lekësh cash në shtëpi), si dhe shuma prej 650,000 lekësh dhuratë nga mamaja S. K. Kjo shumë është likuiduar tërësisht në datën 8.8.2017*”.



**12.1** Referuar deklaramit të subjektit, nga ku duket se kjo pasuri është krijuar me të ardhura të realizuara gjatë periudhës *Vetting* dhe gjatë periudhës kur subjekti kishte lidhur martesë me bashkëshortin A. F., Komisioni vlerësoi që të hetojë për burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

**12.2** Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Shtim e pakësim në llogarinë personale rrjedhëse në Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortit A. F., të shumës 28,505 euro. Pjesa: 50%. Burimi i krijimit: kursimet nga të ardhurat e përfituara nga paga ime dhe e bashkëshortit ndër vite (konkretisht shuma prej 2,499,000 lekësh e tërhequr nga llogaria rrjedhëse në emrin e bashkëshortit, e përshkruar më sipër dhe shuma prej 650,000 lekësh, e cila gjendej cash në shtëpi), si dhe shuma prej 650,000 lekësh dhuratë nga mamaja e ime S. K.. E gjithë kjo shumë ka shërbyer për prenotimin e apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.8.2017”.*

**12.3** Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar bashkëpronësinë në këtë apartament dhe bashkëlidhur ka depozituar dokumentet si vijojnë:

- kontratë sipërmarrjeje<sup>66</sup> datë 8.8.2017, e lidhur midis sipërmarrësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësve K. e A. F., për porositjen e ndërtimit të apartamentit kundrejt çmimit 100,000 euro, ku shtetasi K. F. merr përsipër të paguajë 71.5% të çmimit dhe A. F. 28.5%;
- mandatpagesat datë 8.8.2017 nga Raiffeisen Bank, për pagesën totale të çmimit me dy këste: 71,500 euro nga shtetasi K. F. dhe 28,500 euro nga shtetasi A. F., në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- certifikatë për vërtetim pronësie datë 14.10.2019, nga ZVRPP Drejtoria Tirana Jug, për apartamentin me sip. 99.70 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në adresën Rruga e \*\*\*, Tiranë, në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.;
- kontratë shitjeje<sup>67</sup> datë 29.12.2020, e lidhur midis shitësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe blerësve K. F. dhe A. F., për apartamentin me sipërfaqe neto 99.70 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 100,000 euro, i likuiduar;
- certifikatë për vërtetim pronësie për apartamentin e mësipërm, datë 12.1.2021, nga ZVRPP Drejtoria Tirana Jug, në emër të bashkëpronarëve A. F. (1/4 pjesë) dhe K. F. (3/4 pjesë);
- librezë e UKT-së në emër të shtetasve K. e A. F. dhe librezë e OSHEE-së në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. për këtë apartament, ku rezulton se pagesat kanë filluar që nga muaji tetor 2018 deri në prill 2021.

**12.4** Komisioni ka administruar<sup>68</sup> edhe nga ASHK Drejtoria Tirana Jug dokumentacionin përkatës të pronësisë për këtë apartament, që vërteton origjinën e apartamentit dhe kalimin e pronësisë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. tek bashkëpronarët K. e A. F..

**12.5** Komisioni ka administruar nga noterja E. F.<sup>69</sup> kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.8.2017, e lidhur midis sipërmarrësit, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësve K. e A. F.,

<sup>66</sup> Kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.8.2017.

<sup>67</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.12.2020.

<sup>68</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2021, të ASHK Tirana Jug.

<sup>69</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2013.

për ndërtimin e apartamentit nr. \*\*\*, me sipërfaqe totale 116.34 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 100,000 euro, në godinën e banimit 6 kat në Rrugën e \*\*\*. Në kontratë palët janë dakordësuar që për likuidimin e çmimit shtetasi K. F. do të paguajë 71,500 euro dhe shtetasi A. F. 28,500 euro. Çmimi do të paguhet me një këst të vetëm në datën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

### **Analiza e burimit të krijimit të këtij apartamenti, me çmimin 100,000 euro**

**12.6** Sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit provues rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë paguar 28.5% të çmimit ose 28,500 euro, ndërsa vjehri ka paguar 71.5% të çmimit ose 71,500 euro.

*Në lidhje me pagesën e shumës 28,500 euro, të kryer nga subjekti dhe bashkëshorti i saj*

**12.7** Raiffeisen Bank<sup>70</sup> konfirmon pagesën e datës 8.8.2017, në shumën 28,500 euro, të kryer nga llogaria rrjedhëse e shtetasit A. F. në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 8.8.2017. Gjithashtu, kjo bankë konfirmon se shtetasi A. F. ka tërhequr nga llogaria e tij shumën 2,499,000 lekë në datën 4.8.2017, ndërsa subjekti ka tërhequr nga llogaria e saj e pagës shumat 500,000 dhe 190,000 lekë në datën 4.8.2017. Shumat e tërhequra nga llogaria e subjektit kanë si burim pagat e saj dhe shumën e dhuruar nga nëna e saj.

**12.8** Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: *“Pakësim në llogarinë time bankare rrjedhëse në Raiffeisen Bank të shumës 650,000 lekë. Pjesa: 100%. Burimi i krijimit: dhuratë nga mamaja ime S. K., e përshkruar hollësisht në deklaramin e një viti më parë. Vërtetuar me përshkrim të llogarisë sime rrjedhëse në Raiffeisen Bank, datë 23.3.2018”*.

**12.9** Komisioni ka hetuar në lidhje me burimin e krijimit të tri shumave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si burim i pagesës për apartamentin: (i) shuma 2,499,000 lekë, e tërhequr nga llogaria e bashkëshortit; (ii) shuma 650,000 lekë, e dhuruar nga nëna; (iii) shuma 650,000 lekë, gjendje në banesë. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka provuar burimin e ligjshëm këtyre të shumave të përdorura për pagesën e apartamentit (trajtuar respektivisht në pikat 6, 2 dhe 4 të rezultateve të hetimit më lart).

*Në lidhje me pagesën e shumës 71,500 euro nga vjehri i subjektit të rivlerësimit*

**12.10** Raiffeisen Bank<sup>71</sup> konfirmon pagesën e datës 8.8.2017, në shumën 71,500 euro, që shtetasi K. F. ka kryer nga llogaria rrjedhëse e tij në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 8.8.2017.

**12.11** Nga veprimet bankare rezulton se shuma 71,500 euro, e ndodhur në llogari bankare në datën 8.8.2017, është e përbërë nga: (i) çmimi i shitjes së apartamentit prej 55,000 euro në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, që ka kaluar nga blerësit në llogarinë bankare të shtetasit K. F., në datën 1.3.2017; (ii) depozitimi *cash* i shumës 16,515 euro nga vjehri i subjektit, në datën 8.8.2017, me përshkrimin “Kursimet nga puna”.

<sup>70</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021.

<sup>71</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021.

**12.12** Në lidhje me shumën 55,000 euro, si burimi i krijimit të shumës 71,500 euro, ASHK Tirana Veri ka konfirmuar<sup>72</sup> kontratën e shitjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, me çmimin 55,000 euro dhe kalimin e pronësisë nga shtetasi K. F. tek blerësit S. dhe E. B.. Në analizë të këtyre rrethanave, të ardhurat prej 55,000 euro, të përfituara nga shitja e këtij apartamenti, janë të ardhura të ligjshme, pasi me regjistrimin e kësaj kontrate në ASHK është paguar edhe tatimi për të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë.

**12.13** Në pyetësin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektin që të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion ligjor: nëse familjarët e tjerë që kanë kontribuar në krijimin e apartamentit në rrugën “\*\*\*”; nëse kanë përfituar të ardhura nga shitja e këtij apartamenti; nëse e gjithë shuma është përfituar nga vjehri i subjektit të rivlerësimit të rivlerësimit, z. K. F.

**12.14** Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në zbatim të një marrëveshjeje verbale midis tyre dhe në shenjë mirënjohjeje për sakrificën që prindërit kishin bërë për arsimimin e tyre, të tre fëmijët i jepnin çdo muaj babait të tyre K. F. të ardhurat që përfitonin nga paga dhe ai, pasi mbulonte shpenzimet e jetesës së familjes, pjesën e të ardhurave që mbetej e mblidhte në formën e kursimeve me qëllim për të blerë një apartament në të ardhmen në Tiranë. Më pas, edhe kontrata e sipërmarrjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*”, në datën 14.10.2004, është nënshkruar vetëm nga shtetasi K. F. sepse fëmijët asnjëherë nuk kanë pasur pretendim për të qenë bashkëpronarë në këtë kontratë. Gjithashtu, edhe në rastin e shitjes së këtij apartamenti në janar të vitit 2017 nga shtetasi K. F., të tre fëmijët nënshkruan deklaratën noteriale<sup>73</sup> datë 24.1.2017, ku deklaruan sërish koherencën e vullnetit të tyre, të shprehur fillimisht verbalisht, që ky apartament të jetë vetëm në pronësi të babait K. F. dhe që nuk do të kishin asnjë pretendim pasuror mbi të. Në këtë kontekst, e gjithë shuma 55,000 euro e përfituar nga shitja e apartamentit në rrugën “\*\*\*” ka kaluar në llogarinë bankare të shtetasit K. F. dhe ka qëndruar në këtë gjendje deri kur është përdorur për blerjen e apartamentit në Rrugën e \*\*\*.

**12.15** Për të provuar këto shpjegime, bashkëlidhur subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) ekstraktin e nxjerrjes së llogarisë bankare pranë Raiffeisen Bank, me datë fillimi 27.2.2017 dhe datë mbarimi 30.8.2017, që konfirmon derdhjen e shumës 55,000 euro në llogarinë e shtetasit K. F. nga llogaria e noterit M. S., në zbatim të kontratës së shitjes së apartamentit, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.1.2017 dhe qëndrimin e kësaj shume në llogarinë e shtetasit K. F. deri në datën 8.8.2017; (ii) vërtetimin nr. \*\*\*, datë 6.4.2023, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për pagën e shtetasës E. F. (L.) për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2008.

**12.16** Për sa më lart, rezultojnë e provuar qartësisht se shuma 55,000 euro, e përfituar nga shitja e apartamentit në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, është e ligjshme, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 19 të ligjit nr. 84/2016, si dhe është disponuar vetëm nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, ndërsa fëmijët e tij (E., E., A.) nuk kanë përfituar ndonjë të ardhur nga shitja e këtij apartamenti.

<sup>72</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021, të ASHK-së Veri, drejtuar Komisionit.

<sup>73</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.1.2017.

**12.17** Në lidhje me shumën 16,515 euro, si burimi i krijimit të shumës 71,500 euro, referuar analizës së të dhënave bankare duket se kjo shumë është krijuar nga shumatorja e vlerave 1,100,000 lekë, e përfituar nga shitja e apartamentit në P., Skrapar plus shumën 1,112,900 lekë që shtetasi K. F. ka tërhequr nga depozita bankare në ABI Bank.

**12.18** Raiffeisen Bank konfirmon se në datën 3.8.2017 shtetasi K. F. ka tërhequr nga llogaria e tij shumën 1,098,000 lekë. Kjo shumë ka si burim të ardhurat në vlerën 1,100,000 lekë nga shitja e apartamentit me sip. 50 m<sup>2</sup> në P., Skrapar, shumë e cila është kaluar nga llogaria bankare e noterit në llogarinë bankare të shtetasit K. F. në datën 10.2.2016 dhe është tërhequr prej tij në datën 3.8.2017.

**12.19** Në lidhje me shumën 1,100,000 lekë, që është krijuar nga shitja e apartamentit me sip. 50 m<sup>2</sup> në P., Skrapar, ka rezultuar se kjo shumë është përfituar dhe disponuar vetëm nga shtetasi K. F. dhe jo nga bashkëpronarët e tjerë (trajtuar në pikën 9.7 më lart),

**12.20** Për sa më lart, rezulton e provuar qartësisht se tre fëmijët e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, z. K. F., kanë hequr dorë nga çdo pretendim pasuror si bashkëpronarë mbi apartamentin në P., Skrapar dhe mbi apartamentin në rrugën “\*\*\*”, me qëllimin e vetëm që këto pasuri të mbeteshin në pronësi individuale të babait të tyre.

**12.21** ABI Bank konfirmon se në datën 3.8.2017 vjehrrit i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij shumën 1,100,000 lekë, që ka si burim depozitën bankare të çelur në datën 6.6.2013 nëpërmjet depozitimit *cash* të shumës 1,000,000 lekë “kursime familjare”. Nga historiku i veprimeve në llogarinë e vjehrrit pranë Raiffeisen Bank, Komisioni vëren se në datën 14.1.2011 vjehrrit ka depozituar shumën 1,000,000 lekë, duke e investuar në bono thesari 6-mujore, deri në datën 30.5.2013 e më pas shumën 1,000,000 lekë e ka tërhequr në datën 6.6.2013 dhe e ka depozituar në ABI Bank, ku ka qëndruar deri në datën 3.8.2017, kur është tërhequr nga shtetasi K. F..

**12.22** Në lidhje me shumën 1,100,000 lekë, që ka si burim depozitën bankare prej 1,000,000 lekësh, në pyetësin nr. 3 Komisioni i ka kërkuar gjithashtu subjektit të rivlerësimit: (i) të provojë me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1,000,000 lekë; (ii) të shpjegojë nëse ajo ose bashkëshorti i saj kanë kontribuar në krijimin e shumës 1,000,000 lekë që vjehrrit ka depozituar në Raiffeisen Bank në datën 14.1.2011 dhe, nëse po, sa është vlera e kontributit. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar se:

i) Shuma 1,000,000 lekë ka si burim krijimi “kursimet familjare të vjehrrit, të krijuara në vitet 2007 – 2010”. Këto kursime janë realizuar nga: (a) të ardhurat nga paga si prokurore e kumatës së saj E. (F.) V. nga viti 2007 deri në datën 21.4.2008, kur ajo është martuar; (b) të ardhurat nga paga si prokurore e kumatës E. L. (F.) nga viti 2007 deri në datën 26.9.2008, kur ajo është martuar; (c) të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit si prokurore në vitet 2009 – 2010 (periudhë gjatë së cilës subjekti banonte herë në banesën e bashkëshortit e herë në banesën e prindërve të saj dhe një pjesë të të ardhurave të saj i ka dorëzuar në familjen e bashkëshortit si kontribut).

ii) Subjekti i rivlerësimit nuk mund të përcaktojë sa është vlera e kontributit të saj në krijimin e shumës 1,000,000 lekë, pasi nuk është në dijeni për shumën konkrete që vjehrrit ka kursyer nga të ardhurat që ajo ka derdhur si kontribut familjar, por shpjegon se shuma që ajo i ka lënë çdo muaj

vjehrrit ishte 60,000 lekë. Bashkëshorti A. F. nuk ka kontribuar në krijimin e kësaj shume sepse në pjesën më të madhe të kohës gjatë këtyre viteve ka qenë i papunë.

**12.23** Bashkëlidhur pyetësorit nr. 3 subjekti ka depozituar dokumentet që provojnë shpjegimet e saj<sup>74</sup>.

**12.24** Komisioni, referuar deklaramit të subjektit në lidhje me burimin e krijimit, kreu analizën për të verifikuar mundësinë financiare për krijimin e depozitës 1,000,000 lekë në datën 14.1.2011, si më poshtë:

Viti	2007	2008	2009	2010
Të ardhura K. F.	146,509	157,024	172,552	180,213
Të ardhura E. F.				
Të ardhura E. F.	943,268	322,395		
Të ardhura E. F.	962,583	301,410		
Të ardhura A. F.	0	0	0	0
Kontribut Alma Felaj			360,000	720,000
<b>Total të ardhura</b>	<b>2,052,360</b>	<b>780,829</b>	<b>532,552</b>	<b>900,213</b>
<b>Shpenzime jetike</b>	943,872	546,480	341,550	409,860
<b>Mundësia për kursim</b>	1,108,488	234,349	191,002	490,353
<b>Mundësia kumulative</b>	<b>1,108,488</b>	<b>1,342,837</b>	<b>1,533,839</b>	<b>2,024,192</b>

**12.25** Në analizën e mësipërme nuk janë përfshirë të ardhurat nga pensioni i vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, znj. E. F., për aq kohë sa këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim krijimi për depozitën 1,000,000 lekë. Për këtë arsye, në mundësinë për kursim nuk janë përllogaritur as shpenzimet jetike për këtë person. Në lidhje me periudhën 2009 – 2010, kur subjekti ka kontribuar në familjen e bashkëshortit, Komisioni ka përllogaritur shpenzimet jetike edhe për subjektin e rivlerësimit.

**12.26** Për sa më lart, në lidhje me depozitën bankare prej 1,000,000 lekësh, subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume, por nuk provoi pjesën e kontributit të saj dhe të bashkëshortit në krijimin e kësaj shume.

**12.27** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri dhe ligjshmërinë e burimit financiar të krijimit të saj.

**13. Në pyetësorin standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga korriku i vitit 2009 deri në nëntor të vitit 2014 ka përdorur së bashku me bashkëshortin A. F. automjetin tip “Volkswagen Jetta”, vit prodhimi 1991, me targë \*\*\*, në pronësi të vjehrrit të saj K. F.**

**13.1** Bashkëlidhur pyetësorit standard subjekti i rivlerësimit ka depozituar certifikatën e pronësisë së automjetit datë 14.12.2009, i regjistruar në emër të vjehrrit K. F..

<sup>74</sup> (1) Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2023, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për pagën e znj. E. F. (L.) për periudhën 1.1.2007 – 31.12.2008; (2) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, për pagat e znj. Alma Felaj për periudhën 2006 – 2012; (3) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2023, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, për pagat e znj. E. F.; (4) certifikatë martesë e znj. E. F. (V.); (5) certifikatë martesë e znj. E. L..

**13.2** Referuar datës së certifikatës së pronësisë së automjetit, 14.12.2009, kur subjekti i rivlerësimit ka qenë në detyrë dhe kur ka qenë në bashkëjetesë me bashkëshortin e saj, Komisioni kreu hetime mbi këtë pasuri, me qëllim verifikimin e faktit nëse ky automjet mund të jetë një pasuri e fshehur e subjektit apo nëse ajo ka dhënë kontribut financiar për krijimin e kësaj pasurie.

**13.3** Për qëllim të hetimit, Komisioni administroi dhe shqyrtoi dosjen e këtij automjeti<sup>75</sup>, nga ku rezulton se me kontratën e datës 6.7.2004 shtetasi K. F. ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., Austri, këtë automjet me çmimin 1,600 euro (1,600 euro x 125.30 euro/lekë = 200,480 lekë). Me vërtetimin zhdoganimi datë 9.8.2004, shtetasi K. F. e ka zhdoganuar këtë automjet me vlerë 149,556 lekë.

**13.4** Nga hetimi në AMF rezulton se për periudhën 21.2.2008 – 27.7.2013 shtetasi K. F. figuron pronar i këtij automjeti dhe shtetasi A. F. figuron përdorues i tij.

**13.5** Nga hetimi rezulton se automjeti është blerë nga shtetasi K. F. në datën 6.7.2004, shumë kohë para se subjekti të emërohej në detyrë (datë 6.10.2006) dhe para se të fejohej me djalin e tij (korrik 2009).

**13.6** Nisur nga të dhënat e mësipërme, Komisioni nuk ngre dyshime në lidhje me vërtetësinë e deklaramit të subjektit të rivlerësimit, si dhe me faktin se kjo mund të jetë pasuri e fshehur e tij.

**13.7** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë deklaram.

**14. Në lidhje me adresën e banimit**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësin nr. 1 se nga momenti që ka marrë detyrën si prokurore në datën 6.10.2006, deri në korrik të vitit 2009, ka banuar vetëm në banesën ku jetonin prindërit e saj, në lagjen “\*\*\*\*”, Fier.

**14.1** Me qëllim verifikimin e faktit nëse kjo është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit apo për të cilën ajo ka kontribuar, Komisioni kreu një hetim mbi këtë pasuri (pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truall me sip. 347 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 130 m<sup>2</sup>).

**14.2** Në pyetësin nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se trualli ku është ndërtuar kjo banesë i është dhënë babait të saj rreth viteve '60 nga shteti dhe ka qenë i regjistruar në emrin e tij, por i papajisur me certifikatë pronësie. Fillimisht familja ka jetuar në një banesë të vjetër, e cila është prishur dhe pas viteve '95 ka filluar të ndërtohet banesa aktuale. Për këtë banesë ka aplikuar për legalizim në datën 10.8.2006 vëllai i subjektit, z. A. K.. Aktualisht kjo banesë është regjistruar në ASHK Fier, sipas certifikatës për vërtetim pronësie në emër të shtetasit A. K.. Gjatë qëndrimit në banesën e familjes, subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar qira.

**14.3** Për të provuar këtë deklaram të saj, subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit standard dokumentet: (i) certifikatë pronësie, datë 29.5.2015, e pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truall me sip. 347 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 130 m<sup>2</sup>, e regjistruar në emër të shtetasit A. K., si dhe hartën treguese dhe kartelën e pasurisë; (ii) formular vetëdeklarami nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2006, i deklaruesit A. M. K., që ka deklaruar se objekti është ndërtuar në datën 7.9.2000; (iii) leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 16.4.2015, nga ALUIZNI Fier, për legalizimin e godinës 3-katëshe, me sipërfaqe totale 391.5

---

<sup>75</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2023, e DPSHTRR-së, drejtuar Komisionit.

m<sup>2</sup> në emër të shtetasit A. K.; (iv) deklaratë noteriale<sup>76</sup>, datë 16.5.2015, ku trashëgimtarët e trashëgimlënësit M. K. (babai i subjektit të rivlerësimit) deklarojnë se janë dakord që procedurat e regjistrimit të pasurisë të kryhen në emër të shtetasit A. K. dhe se heqin dorë nga çdo pretendim pronësie mbi godinën 3-katëshe me nr. pasurie \*\*\*; (v) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2021, e ASHK-së Fier, sipas së cilës pasuria nr. \*\*\*, e llojit truall me sip. 347 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 130.03 m<sup>2</sup> (godinë banimi trekatëshe) është regjistruar me leje legalizimi në emër të shtetasit A. M. K., i cili ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit nr. \*\*\*, datë 10.8.2006.

**14.4** Në pyetësonin nr. 2, i pyetur nga Komisioni në lidhje me kohën e ndërtimit, vlerën e investimit të kryer për ndërtimin e kësaj prone dhe dokumentacionin ligjor të investimit (situacione, fatura tatimore etj.), subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se sipas projektit të regjistrimit fillestar të pasurive, truall mbi të cilin ka qenë ndërtuar banesa e vjetër, figuron i regjistruar në emër të babait M. K., i cili nuk ka mundur të pajiset me certifikatë pronësie për shkak të djegies së arkivit të hipotekës në vitin 1997. Si rrjedhojë, ky truall është blerë nga familja e saj si truall shtet në përfundim të procesit të legalizimit (vërtetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2021, të ASHK-së Fier, bashkëlidhur). Në vitin 1995, prindërit dhe vëllai vendosën të ndërtonin një shtëpi të re, e cila është ndërtuar pjesë-pjesë, në varësi të të ardhurave që familja siguronte dhe ka përfunduar si ndërtesë 3-katëshe me çati me tjegulla në shtator të vitit 2000. Gjatë viteve 2000 – 2006 janë përfunduar punimet e brendshme vetëm për katin e parë dhe katin e dytë (shtrim dysHEMEJE, vendosje e dritareve) e për këtë fakt disponon një fletëdalje malli nr. \*\*\*, datë 17.11.2003, të punimeve duralumini që janë bërë. Në katin e tretë nuk është bërë asnjë punim i brendshëm dhe aktualisht nuk është i banueshëm, fakt që vërtetohet me disa foto të bëra në datën 10.3.2023. Që nga viti 2000, kur ka përfunduar ndërtimi e deri momentalisht, nuk është bërë asnjë shtesë objekti. Mobilimi i shtëpisë është bërë ndër vite me mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake që vëllait ia dhuronin punëdhënësit grekë për shkak të marrëdhënieve korrekte të punës që kishin. Pasi u ndërtua shtëpia, në katin e parë të saj ka banuar subjekti me prindërit dhe motrën D., ndërsa në katin e dytë ka banuar vëllai me bashkëshorten dhe dy djemtë e tyre.

**14.5** Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shtëpia nuk është ndërtuar nga një firmë ndërtimi, por nga ustallarë. Blerja e mallrave dhe materialeve të ndërtimit është bërë me para në dorë, pasi në atë kohë nuk lëshoheshin as fatura tatimore, as kuponë tatimorë. Për këto arsye, familjarët e subjektit nuk disponojnë dokumentacion (situacione apo fatura të materialeve të ndërtimit). Nisur nga faktet që ndërtimi i shtëpisë është informal, ai është shtrirë në një periudhë të gjatë kohe, mungon dokumentacioni, ka kaluar kohë e gjatë që nga përfundimi i ndërtimit, për rrjedhojë familjarët e subjektit nuk mund të përcaktojnë se sa ka qenë vlera totale e ndërtimit.

**14.6** Për të provuar shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dokumentet: (i) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.3.2023, nënshkruar nga shtetasit S. K. (nëna), A. K. (vëllai) dhe V. K. (kunata); (ii) vetëdeklarim për legalizim nr. \*\*\*, datë 10.8.2006, i shtetasit A. K., shoqëruar me 4 foto të banesës dhe ortofoto të viteve 1994, 2001, 2007, 2015 e 2019, si dhe

---

<sup>76</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.5.2015.

7 foto format A4 me ngjyra të banesës në pronësi të shtetasit A. K., \*\*\*, të datës 10.3.2023; (iii) fletëdalje nr. \*\*\*, datë 17.11.2003, për punimet duralumini, në vlerën 2,532,000 lekë.

**14.7** Komisioni ka administruar: (i) kontratën<sup>77</sup> familjare të furnizimit me energji elektrike nr. \*\*\* në instancën Fier, \*\*\*, e lidhur në datën 20.4.1998 në emër të shtetasve S. K. e M. K.; (ii) kontratën<sup>78</sup> datë 15.4.2015, ku shtetasi A. K. ka blerë nga ALUIZNI parcelën ndërtimore me sip. 347 m<sup>2</sup>, me çmimin 694,000 lekë, për efekt të legalizimit; (iii) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2023, nga ASHK-ja, që konfirmon se shtetasi A. M. K. ka aplikuar për legalizim të ndërtimit pa leje, sipas formularit nr. \*\*\*, datë 10.8.2006 dhe është pajisur me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 16.4.2015, për godinë banimi 3-katëshe në lagjen “\*\*\*\*”, Fier; (iv) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2023, të ASHK-së Fier, që konfirmon se shtetasi A. M. K. ka në pronësi pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truallin me sip. 347 m<sup>2</sup>, ku përfshihet edhe ndërtesa me sip. 130.3 m<sup>2</sup>, të regjistruar me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 16.4.2015, godinë banimi 3-katëshe.

**14.8** Në pyetësin nr. 2, i pyetur nga Komisioni në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shtëpia është ndërtuar me të ardhura të ligjshme të vëllait A. K. dhe bashkëshortes së tij V. K., si dhe të prindërve M. e S. K.. Kontributin kryesor e ka pasur vëllai dhe bashkëshortja e tij me të ardhurat e siguruara nga puna në emigracion në Greqi dhe me të ardhurat nga aktiviteti tregtar në Shqipëri.

**14.9** Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vëllai A. K. dhe bashkëshortja e tij V. K. në mars të vitit 1991 kanë emigruar së bashku në Greqi, ku kanë punuar punë të ndryshme, fillimisht në të zezë, si të gjithë emigrantët shqiptarë, ndërsa më pas janë pajisur me numër pune, por nuk disponojnë dokumentacion të plotë për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar. Në vitin 1995, në pamundësi për të ardhur vetë në Shqipëri, vëllai iu ka dërguar prindërve nëpërmjet të njohurve një shumë parash, kursime nga puna e tyre, me qëllim fillimin e ndërtimit të shtëpisë në këtë vit. Në vitin 1998, vëllai i subjektit dhe bashkëshortja, pasi u kthyen nga emigracioni, kanë hapur një aktivitet tregtar të ligjshëm, fillimisht minimarket, pastaj bar-kafe, ku janë punësuar të dy, të regjistruar në emrin e vëllait A. K. dhe kanë paguar rregullisht tatimet dhe sigurimet shoqërore. Rreth vitit 1999, vëllai ka shkuar përsëri emigrant në Greqi dhe ka punuar me ndërprerje deri në vitin 2011. Nga viti 2001 e në vazhdim, vëllai ka marrë disa kredi në banka të ndryshme, një pjesë e të cilave kanë shërbyer edhe për punimet përfundimtare të shtëpisë.

**14.10** Për të provuar shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur pyetësin nr. 2 dokumentet: (i) shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, ku rezulton se shtetasi A. K., në bazë të vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 19.8.1998, është regjistruar në organin tatimor, datë 28.6.1999, me kod fiskal \*\*\* si shitës mallrash të ndryshëm, më pas nga viti 2003 me aktivitet bar-bufe, ka realizuar të ardhura nga aktiviteti tregtar për vitet 2003, 2005 dhe 2006, ndërkohë që nuk janë gjendur të dhëna për vitet 1998, 2000 – 2002 dhe 2004.

**14.11** Për vitet 1998, 2000 – 2002 dhe 2004 aktiviteti tregtar që ka kryer vërtetohet me dokumente origjinale që i ka disponuar vëllai i subjektit, si: (i) leje higjieno-sanitare nr. \*\*\*, datë 24.1.2001,

<sup>77</sup> Me shkresën nr. \*\*\*, datë 12.2.2023, të FSHU-së.

<sup>78</sup> Me shkresën datë 3.4.2023 të noteres E. S., drejtuar Komisionit.



në emër të shtetasit A. K., lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror Fier; (ii) faturë tatimore të Ujësjellës-Kanalizime në emër të shtetasit A. K., për subjektin “kafene” për periudhën 2001 – 2005; (iii) formularë deklarimi për regjistrimin e detyrueshëm në sigurimet shoqërore të viteve 2001 – 2002, 2004 në emër të shtetasit A. K., lëshuar nga ISSH Fier; (iv) mandate bankare të Bankës së Kursimeve, lidhur me pagesat e tatimit në emër të shtetasit A. K. për vitin 2004; (v) kërkesë për regjistrim i personit fizik “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, për pagimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe taksave vendore mbi biznesin e vogël; (vi) vërtetim mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe dy mandatarkëtime të vitit 2002; (vii) certifikatë regjistrimi tatimor datë 28.6.1999, në emër të A. K. si biznes i vogël; (viii) vërtetim nga DRT Fier, Zyra e Tatim-Taksave, mbi shlyerjen e detyrimeve për vitet 2002 dhe 2003 nga subjekti tregtar A. K. për aktivitetin bar-bufe; (ix) 4 dokumente origjinale: leja e qëndrimit, leja e punës dhe disa nga pagesat e sigurimeve shoqërore të atyre viteve, IKA; (x) kontratë kredie datë 29.7.2002, e lidhur midis FEFAD Bank dhe shtetasit A. K., për marrjen e kredisë me vlerë 500,000 lekë; (xi) kontratë kredie datë 28.7.2004, e lidhur midis ProCredit Bank dhe shtetasit A. K., për marrjen e kredisë me vlerë 300,000 lekë; (xii) kontratë kredie datë 17.5.2005, e lidhur midis ProCredit Bank dhe shtetasit A. K., për marrjen e kredisë me vlerë 70,000 lekë.

**14.12** ProCredit Bank<sup>79</sup> konfirmon se shtetasi A. K. për periudhën 2001 – 2006 ka marrë nga banka 6 kredi me vlerë totale 2,770,000 lekë, nga të cilat 1,200,000 lekë janë përdorur për banesën.

**14.13** Nga ana tjetër, prindërit e subjektit të rivlerësimit kanë kontribuar me kursimet e tyre ndër vite dhe me të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar që ushtronin në tregun e hapur ambulator, industrial të Fierit prej vitit 1992 deri në vitin 2009, me statusin e ambulancës (trajtuar në pikën 2 të vendimit).

**14.14** Meqenëse vëllai i subjektit ka dhënë kontributin më të madh për ndërtimin e shtëpisë dhe është kujdesur gjithmonë për nënën dhe motrën D. K., atëherë subjekti, nëna dhe motra janë dakordësuar që banesa të regjistrohet në emër të vëllait dhe nuk kanë asnjë pretendim pronësie lidhur me këtë shtëpi. Bashkëlidhur pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar edhe deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.3.2023, të lëshuar nga nëna e saj, vëllai dhe bashkëshortja e tij, që konfirmojnë shpjegimet e dhëna nga subjekti.

**14.15** Për sa më lart, nga hetimi rezulton se: (i) sipas formularit të vetëdeklarimit, dorëzuar në datën 10.8.2006, shtëpia është ndërtuar në vitin 2000; (ii) formulari është firmosur vetëm nga

---

<sup>79</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2023, drejtuar Komisionit; kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.3.2001, lidhur midis Fefad Bank (sot ProCredit Bank) dhe A. K. si kredimarrës dhe V. K. bashkëkredimarrës, për shumën 500,000 lekë, me afat 16-mujor, me qëllim përdorimi për aktivitetin. Kredia është likuiduar në afat, pasi rezulton që të jetë mbyllur në datën 23.7.2002; kontratë kredie, datë 29.7.2002, lidhur midis Fefad Bank (sot ProCredit Bank) dhe A. e V. K. si kredimarrës për shumën 500,000 lekë, me afat 16-mujor, me qëllim përdorimi për aktivitetin. Kredia është likuiduar në afat, pasi rezulton që të jetë mbyllur në datën 4.11.2003; kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.11.2003, lidhur midis ProCredit Bank dhe A. e V. K. si kredimarrës, për shumën 700,000 lekë me afat 18-mujor, me qëllim përdorimi për rinovimin e shtëpisë. Kredia është likuiduar në afat, pasi rezulton që të jetë mbyllur në datën 4.5.2005; kontratë kredie, datë 28.7.2004, lidhur midis ProCredit Bank dhe A. e V. K. si kredimarrës, për shumën 300,000 lekë, me afat 18-mujor, me qëllim përdorimi për aktivitetin. Kredia është likuiduar në afat, pasi rezulton që të jetë mbyllur në datën 4.2.2006; kontratë kredie, datë 17.5.2005, lidhur midis ProCredit Bank dhe A. e V. K. si kredimarrës, për shumën 70,000 lekë, me afat 9-mujor, me qëllim përdorimi për aktivitetin. Kredia është likuiduar në afat, pasi rezulton që të jetë mbyllur në datën 4.2.2006; kontratë kredie, datë 14.10.2006, lidhur midis ProCredit Bank dhe A. e V. K. si kredimarrës, për shumën 700,000 lekë, me afat 36-mujor, me qëllim përdorimi për banim. Kredia është likuiduar në afat, pasi rezulton të jetë mbyllur në datën 30.12.2009.

shtetasi A. K.; (iii) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar dhe provuar se shtëpia është ndërtuar me kontributin e vëllait e bashkëshortes së tij dhe prindërve të subjektit të rivlerësimit, ndërsa subjekti nuk ka kontribuar; (iv) punimet e brendshme janë kryer në periudhën 2000 – 2006 (si provë është paraqitur një fletëdalje malli e vitit 2003); (v) sipas dokumentacionit bankar, vëllai i subjektit ka marrë kredi në vlera të konsiderueshme në periudhën 2001 – 2006, një pjesë e së cilës është përdorur për banesën; (vi) provohet nga dokumentacioni i administruar se vëllai A. K. dhe bashkëshortja e tij V. kanë ushtruar aktivitet privat që nga viti 1999; (vii) me deklaratën noteriale<sup>80</sup>, datë 1.5.2015, të dorëzuar në ZVRPP, subjekti i rivlerësimit, nëna dhe motra e saj kanë shprehur dakordësinë që banesa të regjistrohet në emër të shtetasit A. K. dhe nuk kanë asnjë pretendim pronësie lidhur me këtë shtëpi; (viii) pronësia e kësaj pasurie, bazuar në lejen e legalizimit të vitit 2015, është regjistruar në emër të shtetasit A. K.; (ix) subjekti është emëruar në detyrë (prokurore në stazh) në datën 6.10.2006, periudhë kjo që përkon me përfundimin e punimeve të brendshme të ndërtesës.

**14.16** Nisur nga të dhënat e mësipërme, Komisioni nuk arriti të provojë ndonjë kontribut të dhënë nga ana e subjektit të rivlerësimit për ndërtimin e kësaj ndërtese e, për rrjedhojë, nuk mund të ngrejë dyshime që kjo të jetë një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht faktit se subjekti ka banuar disa vite në këtë shtëpi, pa kontribuar në krijimin e saj dhe pa paguar qira.

**14.17** Gjithashtu, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka një marrëdhënie interesi me prindërit dhe vëllain e saj, ata nuk mund të konsiderohen “persona të tjerë të lidhur”, në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**14.18** Sipas jurisprudencës së Kolegjit<sup>81</sup>, ligji nr. 84/2016, në nenin 3, pika 9 e tij, ka parashikuar se çfarë konsideron “marrëdhënie biznesi” në kuadër të këtij procesi, duke e përkufizuar si: “[...] çdo marrëdhënie profesionale ose tregtare, e cila lidhet me veprimtaritë e ushtruara nga subjektet e këtij ligji dhe klientët e tyre, që në çastin e vendosjes së saj, vlerësohet të jetë një marrëdhënie e vazhdueshme ose jo sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, gjë që nuk gjen zbatim në rastin konkret. Ndërsa lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është përcaktuar në nenin 32, pika 4 e këtij ligji, i cili parashikon se: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”, për të cilën Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar tashmë në jurisprudencën<sup>82</sup> e tij, i sjellë si argument në mbështetje të pretendimeve të tij edhe nga subjekti i rivlerësimit gjatë parashtrimeve në Kolegji.

**14.19** Konkretisht, edhe në vendimin 7, datë 24.6.2020, Kolegji argumenton: “Në analizë të fakteve dhe rrethanave lidhur me përdorimin prej subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të apartamentit të babait të tij, z. M. K., pa pagesë qiraje, trupi gjykues, edhe pse mban në konsideratë faktin që mbështetja që i është dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, z. M.K., si më sipër, mund të trajtohej teorikisht si një përfitim monetar (shumë e pashpenzuar për qëllime

<sup>80</sup> Deklaratë e dorëzuar bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit standard.

<sup>81</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 14.4.2022, i Kolegjit, për subjektin e rivlerësimit F. I..

<sup>82</sup> Shihni vendimin nr. 7, datë 24.6.2020 (subjekti i rivlerësimit S. Ç.), paragrafët 93 e 94; vendimin nr. 20, datë 8.9.2020, paragrafët 21 - 21.4; vendimin nr. 21, datë 10.9.2020, paragrafët 72 - 75 e 77; vendimin nr. 4, datë 9.2.2021, paragrafët 143 - 146.

*qiraje banimi) dhe, si rrjedhojë, do të mund të vendoste palët në një marrëdhënie interesi pasuror sipas parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se nëse gjatë kontrollit të kësaj pasurie nuk arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës për të fshehur pasurinë (duke qenë se për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi nuk ekziston), atribuimi i mungesës së burimeve të ligjshme të babait të subjektit, për të justifikuar krijimin e pasurisë së paluajshme apartament me sip. 135 m<sup>2</sup> dhe dy garazhe me sip. 18 m<sup>2</sup>, subjektit të rivlerësimit, në kuadër të lidhjes që ekziston mes tyre për përdorim të përbashkët të banesës, pa qira, do të tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit”.*

**14.20** Referuar kësaj jurisprudence, subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, prandaj Komisioni nuk kreu një analizë të detajuar financiare për këtë pasuri.

**14.21** Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e depozituar prej saj dhe atë të administruar nga Komisioni, si dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri.

## **15. Analiza financiare**

**15.1** Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj *Vetting* për periudhën e hetimit 2006 – 2016 të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën -201,313 lekë për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë.

**15.2** Për sa më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**15.3** Në prapësimet e saj, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *“Pasi u njoha me analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën e hetimit 2006 – 2016 dhe konkretisht balancat negative respektive të shpërndara në vitet: viti 2014 = -159,627 lekë; viti 2015 = -16,236 lekë; viti 2016 = -25,450 lekë, vlerësoj se ato janë vlera të vogla të tilla që mund të kenë ardhur si rezultat i faktit që shpenzimet jetike për djalin, për shkak të moshës së tij të vogël, kanë qenë realisht më të vogla se ato të përcaktuara për një person të rritur nga INSTAT. Për këtë arsye, mundësia për kursime ka qenë më e madhe, prandaj kërkoj që ky fakt të merret në konsideratë nga ana e Komisionit. Megjithatë, edhe nëse ky fakt nuk merret në konsideratë nga ana e Komisionit, kërkoj që të zbatohet parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, pasi vlera e bilancit negativ zë një peshë krahasimisht të vogël në raport me blerjen e pasurive apo shpenzimet e kryera prej meje në këto vite. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe fakti që nga analiza financiare e kryer për vitet e mëparshme rezultojnë vetëm balanca pozitive të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe në shuma të konsiderueshme më të larta, në raport me këtë balancë negative dhe, për rrjedhojë, kjo vlerë negative nuk duhet të ndikojë në vlerësimin tërësor të pasurive të mia”.*

## **Vlerësimi i Komisionit**

**15.4** Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në prapësimet e saj, faktin që subjekti ka bërë deklaratime të sakta për pasuritë e saj dhe personave të lidhur me të, si dhe duke u bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, vlerëson se balanca financiare negative e të ardhurave prej -201,313 lekësh për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, është në një vlerë dhe me një peshë aq të vogël, saqë nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk cenon figurën e magjistratit dhe as perceptimin e besimit të publikut tek drejtësia. I njëjti konkluzion i Komisionit vlen edhe në rast se nuk do të konsiderojmë si të ardhur të ligjshme shumën prej 650,000 lekësh, dhuruar subjektit të rivlerësimit nga nëna e saj.

Perioda	2004- 6.10.2006	6.10.2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>-51,798</b>	<b>166,083</b>	<b>185,434</b>	<b>570</b>	<b>112</b>	<b>50,885</b>	<b>1,740,719</b>	<b>387,217</b>	<b>417,805</b>	<b>946,711</b>	<b>891,551</b>	<b>1,472,442</b>
Automjet Ford Fiesta, me tarrë *** (më pas ***)			300,000									
Automjeti Mercedes Benz, me tarrë *** (aktualisht ***)											1,032,375	
Tokë arë me sip.13035 m2, rr.pasurie ***, ZK, rr.***, Fier												
Apartament me sip.77.60 m2. Rr:***** Juxia *. Ap.*												
Apartament barimi me sip.50 m2 me adresë Skrapar, Polican, lagje *. P.*, Stk.*												
Ndërrymt Lika dretë (L&k në fund-L&k në fillim)	-51,798	166,083	-114,566	570	112	50,885	1,740,719	387,217	417,805	946,711	-140,824	1,472,442
L&k udhëse në fillim të vitit	0	-51,798	114,283	-281	289	401	31,286	1,792,005	2,179,222	2,597,027	3,543,738	3,402,914
L&k udhëse në fund të vitit	-51,798	114,283	-281	289	401	31,286	1,792,005	2,179,222	2,597,027	3,543,738	3,402,914	4,875,356
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>PASURINETO (PASURI - DETYRIME)</b>	<b>-51,798</b>	<b>166,083</b>	<b>185,434</b>	<b>570</b>	<b>112</b>	<b>50,885</b>	<b>1,740,719</b>	<b>387,217</b>	<b>417,805</b>	<b>946,711</b>	<b>891,551</b>	<b>1,472,442</b>
<b>TE ARDHURA dolumentuar</b>	<b>936,090</b>	<b>219,048</b>	<b>886,244</b>	<b>872,191</b>	<b>1,223,146</b>	<b>1,230,841</b>	<b>3,227,609</b>	<b>1,556,795</b>	<b>1,519,420</b>	<b>1,996,335</b>	<b>1,603,203</b>	<b>2,348,139</b>
Të ardhura nga paga Prokuroria Fier		219,048	886,244	872,191	1,223,146	1,010,502	806,031	461,269				
Të ardhura nga paga Prokuroria Durrës								626,709	924,766	1,309,631	1,112,610	1,151,059
Të ardhura nga pasfhtësia dhe leja e lindjes						54,916	381,770					
Të ardhura nga paga e b'sh'Parku i transportit urban te udh. Bashkia Tirane"						165,423	661,920	154,972				
Të ardhura nga paga e b'sh'nga shoqëria ****								31,263	295,422	413,672	467,490	547,080
Të ardhura nga interesat e obligacioneve								24,462	48,924	48,924	23,103	
Të ardhura nga Magjistatura	936,090								10,800	10,800		
Të ardhura nga shpërbim bebe							5,000					
Të ardhura nga durrimi S.K												650,000
Të ardhura nga shëtitje 1000 m2 dt.8.10.2012								6,990				
Të ardhura nga pensioni KF							187,364	194,524	200,907	213,308		
Të ardhura nga pensioni EF							162,264					
Të ardhura nga interesat bankare BTH							23,260	56,616	38,600			
Të ardhura nga kursimet e vjehtërit ndër vite							1,000,000					
Të ardhura nga shëtitje e ap.50 m2 në Skrapar												0
<b>SHPENZIIME</b>	<b>358,238</b>	<b>25,813</b>	<b>235,968</b>	<b>296,754</b>	<b>702,375</b>	<b>870,500</b>	<b>626,175</b>	<b>564,096</b>	<b>821,381</b>	<b>1,209,251</b>	<b>727,888</b>	<b>901,147</b>
Shpenzime jetike	287,165	25,813	235,968	136,620	136,620	136,620	626,175	564,096	564,096	879,992	672,828	705,276
Shpenzime e udhëtimi	71,073	0	0	160,134	205,755	13,880	0	0	257,285	329,259	55,060	195,871
Kontribut i subjektit në familjen e b'sh para martesë					360,000	720,000						
Shpenzime tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë												0
Shpenzime rrvlerësimi												0
<b>LIKUIDITETE NË FUND TË VIIIIT</b>	<b>-51,798</b>	<b>114,285</b>	<b>-281</b>	<b>289</b>	<b>401</b>	<b>51,286</b>	<b>1,792,005</b>	<b>2,179,222</b>	<b>2,597,027</b>	<b>3,543,738</b>	<b>3,402,914</b>	<b>4,875,356</b>
Cash		100,000		0	0	0	600,000	550,000	1,000,000	1,900,000	1,900,000	650,000
Llogari pages Credns												
Llogari kursimi *bank (ish ***)_EUR_bashkëmbajtëse me TL 6.3.2009-17.9.2010												
Llogari shpërbim për bebe ***bank_E_*****							5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	
Llogari page BKT_A_*****CLIDCLALLY								24,800	707	34,326	1	0
Llogari rrjedhëse BKT_A_*****CLIDCLALLY SK												
Llogari page R.BankAL_A_*****	-51,798	14,285	-281	289	401	32,228	45,693	-939	336	873	117	648,326
Llogari tërheqje MC RBAL_A_*****								-5,023	50	-14,741	-47,622	-22,714
Llogari rrjedhëse RBAL_A_F_*****								15,090	15,090	15,090	15,090	0
Llogari page RBAL_A_F_*****							55,141	-153	-375	-390	429,775	2,500,020
Obligacione 3Y, RBAL 12.1.2012-6.1.2015								600,000	600,000	600,000	0	
Llogari tërheqje MC RBAL_A_F_*****								-13,859	-50,874	-50,638	0	
Llogari page OTP_A_F_*****											46,334	45,505
Llogari rrjedhëse ISPB_A_K_*****						19,058	0					
Llogari kursimi ABI_K_F_***** 6.6.2013-3.8.2017									27,075	175	175	175
Depozitë me afat ABI_K_F_***** 6.6.2013-6.6.2014									1,000,000	0		
Depozitë me afat ABI_K_F_***** 6.6.2014-6.6.2016										1,054,026	1,054,026	1,054,026
Llogari rrjedhëse ABI_K_F_***** 24.3.2009-29.1.2013												
Llogari rrjedhëse RBAL_K_F_*****							86,172	4,305	18	18	18	18
Investimi në bono thesan RBAL_K_F_*****							1,000,000	1,000,000	0			
Llogari rrjedhëse RBAL_K_F_***** EUR												
Deklarim në DIPP												
Analiza dolumentuar	629,651	27,151	464,842	574,867	520,659	309,456	860,715	605,482	280,233	-159,627	-16,236	-25,450
												-201,313

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka dërguar<sup>83</sup> pranë Komisionit raportin nr. \*\*\*, datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Alma Felaj, raport që është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.4.2023, të KDZH-së (Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar Sekret). Sipas këtij raporti, Grupi i Punës së AKSIK-së në përfundim të verifikimit ka konkluduar se:

*“a) Subjekti i rivlerësimit ka pasur të njëjtat gjeneralitete si ato që ka deklaruar vetë në deklaratën për kontrollin e figurës.*

*b) Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”.*

2. Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

3. Nga hetimi i kryer, Komisioni nuk ngriti dyshime që kanë të bëjnë me figurën e subjektit të rivlerësimit, duke konfirmuar përshtatshmërinë e subjektit për vazhdimin e detyrës në lidhje me këtë kriter.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

4. Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin<sup>84</sup> mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Felaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.4.2023, të KLP-së.

5. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit, me Dekretin nr. \*\*\*, datë 4.10.2006, të Presidentit të Republikës, është emëruar prokurore në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe me Dekretin nr. \*\*\*, datë 11.2.2007, të Presidentit të Republikës, është emëruar prokurore.

6. Ky raport për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 është hartuar duke u bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri grupeve të burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short; (iii) të dhënat nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme. Në raport janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe

<sup>83</sup> Me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2023 dhe nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, të DSIK-së.

<sup>84</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2023, i KLP-së, dërguar pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2023, të KLP-së.

angazhimi ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional, për të cilat Grupi i Punës ka konkluduar me një vlerësim pozitiv për subjektin e rivlerësimit<sup>85</sup>.

7. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin edhe të informacioneve më poshtë:

### **C/1. Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

8. Formulari i vetëdeklarimit, datë 26.1.2017, paraqitet i nënshkruar pa mangësi nga subjekti i rivlerësimit, i plotë, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe me dokumentacionin e nevojshëm bashkëlidhur<sup>86</sup>. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe vendimet për vlerësimin e punës së prokurorit “shumë mirë” për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2016.

9. Subjekti i rivlerësimit në periudhën tetor 2006 – prill 2012 ka qenë me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Gjatë kësaj periudhe është emëruar<sup>87</sup> në detyrën e zëvendësdrejtueses së kësaj Prokurorie, shkurt 2009 – maj 2009. Më pas e deri aktualisht është me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ku edhe është caktuar në detyrën e zëvendësdrejtueses së kësaj Prokurorie në periudhën tetor 2014 – janar 2015.

---

<sup>85</sup> **Aftësitë profesionale**, ku përfshihen: a) *njohuritë ligjore* dhe b) *arsyetimi ligjor*. Në lidhje me *njohuritë ligjore*, subjekti shfaq aftësi në drejtim të kuptimit, interpretimit dhe zbatimit të ligjit; ka njohuri të plota rreth instituteve të së drejtës penale; ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë, duke përcaktuar detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre; identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme, bën interpretim sistematik dhe logjik të normës ligjore në raport me faktin e referuar dhe konkludon në një zgjidhje ligjore të rastit. Në lidhje me *arsyetimin ligjor*, ka aftësi të mira; vendimet dhe aktet e subjektit kanë shtjellim të kuptueshëm, organizohen në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse dhe tregojnë kujdes që konkluzionet të përfaqësojnë lidhje koherente mes fakteve të parashtruara dhe bazës ligjore të përdorur; në akte respekton rregullat drejtshkrimore dhe etike.

**Aftësitë organizative**, ku përfshihen a) *aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*, b) *aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*, dhe c) *aftësia për të administruar dosjet*. Në lidhje me *aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë* – referuar numrit të çështjeve dhe materialeve të kallëzuar për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 dhe 5 dosjeve të përzgjedhura, rezultojnë se subjekti i rivlerësimit kryen veprimet hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke u dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Në lidhje me *aftësinë për të kryer procedurat gjyqësore*, veprimet procedurale hetimore rezultojnë të jenë produktive; vihet re se qëndrimi në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e saj ligjor të arsyetuar lidhur me çështjet objekt gjykimi. Në lidhje me *aftësinë për të administruar dosjet*, dosjet janë të rregullta, të plota, aktet procedurale janë të përpiluara e të strukturuar dhe respektohen normat e drejtshkrimit.

**Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**, që përfshin: a) *etikën në punë*, b) *integritetin* dhe c) *paanësinë*. Në lidhje me *etikën në punë*, gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit; nuk rezultojnë të ketë pasur ankesa për veprime apo qëndrime të subjektit në kundërshtim me etikën profesionale të prokurorit. Në lidhje me *integritetin*, nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka të dhëna për ndikim apo presion të jashtëm mbi imunitetin e tij. Në lidhje me *paanësinë*, nga 3 dokumentet ligjore të subjektit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, si dhe asnjë kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi; asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave; nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

**Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**, ku përfshihen: a) *aftësitë e komunikimit*, b) *aftësia për të bashkëpunuar* dhe c) *gatishmëria për t'u angazhuar*. Në lidhje me *aftësinë e komunikimit*, komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Në lidhje me *aftësinë për të bashkëpunuar*, rezultojnë se për vitet 2014, 2015 dhe 2016 subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm. Në lidhje me *gatishmërinë për t'u angazhuar*, subjekti i nënshtrohet programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, duke marrë pjesë dhe certifikuar në mjaft trajnime të organizuara nga kjo shkollë, për periudhën e viteve 2013 – 2016, si më lartpërkshuar.

<sup>86</sup> Shihni dosjen e dokumenteve, që shoqëron formularin e vetëdeklarimit.

<sup>87</sup> Me urdhrin nr. \*\*\*, datë 8.10.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm.

**10.** Për periudhën 2013 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i janë caktuar për të ndjekur 526 procedime penale dhe 292 materiale kallëzuese, si dhe ka përfunduar 442 procedime penale dhe 257 materiale kallëzuese.

**11.** Sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 26.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të deklarimit, rezulton se për periudhën 2013 – 2016 subjekti ka ndjekur gjithsej 23 trajnime pranë kësaj shkolle dhe jashtë saj. Bashkëlidhur formularit të deklarimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar të gjitha certifikatat e këtyre trajnimeve.

## **C/2. Tri dokumentet ligjore të përzgjedhura për vlerësim nga subjekti i rivlerësimit**

**12. Dokumenti nr. 1** – Vendim datë 17.5.2013 për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2012, pas konstatimit se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në datën 20.1.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\* në ngarkim të shtetasve E. Xh. dhe A. M..

Rezulton se në datën 20.1.2012, rreth orës 01:15, në Lagjen Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, të qytetit të Durrësit, punonjësit e policisë kanë kontrolluar automjetin e shtetasit E. Xh., ku udhëtonin si pasagjerë edhe shtetasit A. M. dhe P. M. Në xhupin e shtetasit A. M. është gjetur 2.069 gramë lëndë narkotike e llojit *cannabis sativa* dhe 0.4 gramë në makinë. Gjatë pyetjeve, shtetasit E. Xh. dhe A. M. kanë deklaruar se janë përdorues të lëndëve narkotike dhe se E. nuk e ka marrë lëndën narkotike nga A., por e ka blerë në rrugë tek disa persona të panjohur.

Fakti që janë përdorues të lëndëve narkotike dhe që sasia e gjetur ka qenë për përdorim vetjak, është provuar me vërtetimet nga Spitali Ushtarak Tiranë dhe nga reparti i toksikologjisë e adiktologjisë klinike, këqyrjen e regjistrit të terapisë ditore të repartit të adiktologjisë dhe toksikologjisë pranë QSUNT-së, si dhe me aktet e ekspertimit toksikologjik<sup>88</sup>.

Referuar nenit 283/1 të Kodit Penal, që përcakton se “...përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope”, si dhe referuar vendimit unifikues nr. 1, datë 27.3.2008, të Gjykatës së Lartë, për përcaktimin e termit “doza të vogla”, që ka arritur në konkluzionin përgjithësues dhe njëkohësisht detyrues se “Doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope, që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël”, ky fakt nuk përbën vepër penale.

Vendimi i pushimit është strukturuar dhe ndarë në 3 pjesë: hyrëse, përshkruese-arsyetuese dhe konkluduese, ku secila pjesë përmban elementet e saj të nevojshme për të dhënë pasqyrën e plotë të rrethanave të çështjes, veprimeve hetimore, arsyetimin dhe konkluzionin e subjektit të rivlerësimit, si dhe bazën ligjore të tyre. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit.

**13. Dokumenti nr. 2** – Diskutim përfundimtar datë 2.5.2014, mbi çështjen penale nr. \*\*\*, viti 2013, në ngarkim të të pandehurit S. V.. Në përfundim të gjyqimit, subjekti i rivlerësimit i ka

---

<sup>88</sup> Nga akti i ekspertimit toksikologjik për shtetasin E. Xh. ka rezultuar se sasia prej 2.08 gramësh *cannabis sativa* është për përdorim vetjak dhe njëpërdorimëshe për këtë shtetas. Nga akti i ekspertimit toksikologjik për shtetasin A. M. ka rezultuar se sasia prej 0.469 gramësh *cannabis sativa* është për përdorim vetjak dhe njëpërdorimëshe për këtë shtetas.



kërkuar gjykatës deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale që akuzohet, duke kërkuar njëkohësisht masën e dënimit që duhet të caktohet ndaj tij.

Në datën 29.4.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal për veprat penale “vjedhje me dhunë” (neni 139 i Kodit Penal)<sup>89</sup>.

Në përfundim të gjykimit, në kërkesën për llojin dhe masën e dënimit për të pandehurin, duke mbajtur parasysh rrethanat e parashikuara nga Kodi Penal<sup>90</sup>, si dhe faktin që i pandehuri ka qenë i dënuar më parë dhe nuk e ka pranuar akuzën, rrethana rënduese këto të parashikuara nga neni 50/ç i Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar:

*1. Deklarimin fajtor të të pandehurit S. V. për veprën penale “vjedhje me dhunë” (neni 139 i Kodit Penal), dënimin me 7 vjet burgim.*

*2. Deklarimin fajtor të të pandehurit S. V. për veprën penale “prodhim e mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve” (neni 278/4 i Kodit Penal), dënimin e tij me 8 vjet burgim.*

*3. Deklarimin fajtor të të pandehurit S. V. për veprën penale “prodhim e mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim.*

*4. Në bashkim të dënimeve sipas nenit 55/2, dhënien e një dënimi të vetëm prej 15 vjetësh burgim.*

Komisioni, pasi administroi dhe shqyrtoi vendimin nr. \*\*\*, datë 14.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>91</sup>, vëren se gjykata ka vendosur sipas kërkesës të subjektit, por në bashkim të dënimeve, në zbatim të neneve 55/2 dhe 50/ç të Kodit Penal, Gjykata nuk e ka dënuar të pandehurin me 15 vjet burgim, siç ka kërkuar subjekti, por me 13 vjet burgim. Ky vendim gjyqësor është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.4.2015, vetëm për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municioneve”, neni 278/3 i Kodit Penal, duke pushuar çështjen për këtë veprë për shkak të amnistisë.

**14. Dokumenti nr. 3** – Diskutim përfundimtar datë 7.5.2014, mbi çështjen penale nr. \*\*\*, datë 10.6.2011, në ngarkim të të pandehurit L. K.. Me këtë dokument, bazuar në provat e administruara gjatë gjykimit, subjekti i ka kërkuar gjykatës deklarinim fajtor të të pandehurit për veprën penale që akuzohet dhe masën e dënimit që duhet të caktohet ndaj tij. Rezulton se ky diskutim është

<sup>89</sup> Rezulton se në datën 26.4.2013, rreth orës 15:00, shtetasi I. Xh. (taksist) është gjetur nga punonjësit e policisë i dhunuar dhe i mbyllur në banesën e të pandehurit S. V. në Lagjen Nr. \*\*\*, Durrës, i cili rreth orës 12:30, pasi e ka tërhequr viktimit në banesën e vet me justifikimin se do të merrnin gjyshen e sëmurë dhe ta çonin në spital, e ka kërcënuar me pistoletë, e ka goditur, e ka lidhur dhe i ka vjedhur unazën e floririt dhe automjetin taksist. Sipas veprimeve hetimore dhe aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. \*\*\*, datë 30.4.2013, tek I. Xh. konstatohen dëmtime që kanë shkaktuar paafësi të përkohshme për punë mbi 9 ditë. Në datën 29.7.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 29.7.2013, për veprën penale “prodhim e mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit” (neni 278/3 i Kodit Penal). Në datën 29.4.2013 është vendosur bashkimi i këtyre dy procedimeve “vjedhje me dhunë” dhe “prodhim e mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”.

<sup>90</sup> Rrezikshmërinë e lartë shoqërore të veprave penale; faktin që vepra penale është e përhapur aktualisht në vendin tonë; rrezikshmërinë e lartë të autorit; rrethanat, mënyrën dhe motivin e kryerjes së veprave penale; agresivitetin e veprimeve të kryera nga i pandehuri; llojin dhe vlerën e objektit material të veprës penale.

<sup>91</sup> Vendim i bashkëlidhur raportit të KLP-së dërguar Komisionit.

paraqitur nga subjekti në rigjykimin e kësaj çështjeje<sup>92</sup> sipas vendimit nr. \*\*\*, viti 2013, të Gjykatës së Apelit Durrës<sup>93</sup>.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 10.6.2011, mbi kallëzimin penal datë 7.6.2011 të shtetases H. Xh., e cila ka kallëzuar largimin dhe zhdukjen e shoqes së saj R. K. Në datën 16.6.2011, subjekti ka regjistruar emrat e personave që i atribuohet vepra penale (L. K. dhe E. M.) për veprën penale “vrasje me dashje”, kryer në bashkëpunim (nenet 76 dhe 25 të Kodit Penal)<sup>94</sup>.

Subjekti i rivlerësimit në përfundim të diskutimit ka kërkuar:

1. *Deklarimin fajtor të të pandehurit L. K. për veprën penale “vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim (nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal), dënimin me 23 vjet burgim.*
2. *Deklarimin fajtor të të pandehurit L. K. për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake” (neni 278/2 i Kodit Penal) dhe dënimin me 3 vjet burgim.*
3. *Në bazë të nenit 55/2 të Kodit Penal, duke bashkuar dënimet e mësipërme, dënimin e tij përfundimisht me 25 vjet burgim.*
4. *Mbështetur në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, meqenëse ndaj tij u pranua gjykimi i shkurtuar, dënimin përfundimisht me 16 vjet e 8 muaj burgim.*

Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.6.2014, ka vendosur:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit L. K. për veprën penale “vrasje me paramendim”, neni 78/1 i Kodit Penal dhe dënimin me 22 vjet burgim.*
- *Deklarimin fajtor të të pandehurit L. K. për veprën penale “prodhim dhe mbajtje pa leje i armëve luftarake”, neni 278/2 i Kodit Penal, dënimin me 2 vjet burgim.*

---

<sup>92</sup> Çështja penale është gjykuar për herë të parë me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.1.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Prokuroria ka bërë ankim ndaj këtij vendimi.

<sup>93</sup> Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur kthimin prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 14.1.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kthimin e akteve për rigjykim me tjetër trup gjykues.

<sup>94</sup> Nga hetimet ka rezultuar se i pandehuri L. K. ka planifikuar vrasjen e shtetases R. K. dhe i ndihmuar nga i pandehuri E. M. e ka vrarë atë në datën 5.6.2011. Fillimisht L. K. i ka dhënë një armë shtetasi E. M. që t’ia dërgonte L. tek Kompleksi i \*\*\* tek Gjiri i Lalzit, ku më pas ky i fundit do ta merrte armën. Më pas kanë dërguar viktimën me makinë në fshatin \*\*\*, ku L. K. e ka qëlluar me armë në prani të E. dhe më pas janë larguar të dy në drejtim të Durrësit. I pandehuri E. M. ka ndihmuar të pandehurin L. K. në vrasjen e shtetases R. K., bashkëpunim ky që ka vazhduar edhe me përpjekjet e tyre për t’iu fshehur policisë dhe shmangur përgjegjësisë penale, pasi E. M. i ka siguruar L. K. edhe një pasaportë për t’u larguar jashtë shtetit. Gjatë arsyetimit të diskutimit përfundimtar, subjekti paraqet në mënyrë të detajuar të gjitha provat dhe faktet e administruara e të verifikuara edhe në seancë gjyqësore, të cilat kanë vërtetuar rolin e të pandehurit E. M. si bashkëpunëtor në rolin e ndihmësit, ka analizuar veprimet dhe rrezikshmërinë e tij, e ka cilësuar “të pandehur”, duke cituar se organi i akuzës ka krijuar bindjen se autor i vrasjes ka qenë L. K. në rolin e shtytësit dhe ekzekutorit, i ndihmuar nga i pandehuri E. M.. Rezulton se gjatë gjykimit i pandehuri L. K., bazuar në nenin 93, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar ndarjen e çështjes ndaj tij nga gjykimi i të pandehurit E. M. që gjykohej në mungesë, pasi ka marrë edhe miratimin e avokatit të E. M., që nuk ka tagër të kërkojë gjykim të shkurtuar. Subjekti ka qenë dakord me këtë kërkesë, meqë L. K. kishte kërkesa të tjera për mënyrën e gjykimit të kësaj çështjeje penale dhe ndarja shpejton gjykimin e tij e nuk dëmton vërtetimin e fakteve. Gjykata ka pranuar kërkesën dhe me vendimin e ndërmjetëm, datë 25.4.2014, ka vendosur ndarjen e gjykimit të çështjeve dhe krijimin e një fashikulli të ri gjyqësor për të pandehurin E. M.

- Në bazë të nenit 55/2 të Kodit Penal, duke bashkuar dënimet e mësipërme, dënimin e tij përfundimisht me 24 vjet burgim.
- Mbështetur në nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale, u pranua gjykimi i shkurtuar dhe përfundimisht dënohet me 16 vjet burgim.

Vendimi nr. \*\*\*, datë 9.6.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.2.2015. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2016, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, nuk ka pranuar as rekursin e Prokurorisë dhe as rekursin e të pandehurit ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit.

Pavarësisht se kërkesa e subjektit në lidhje me dënimin e të pandehurit L. K. për veprën penale “vrasje me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, u rrëzua nga gjykatat, ky veprim i subjektit ka të bëjë me bindjen e saj të brendshme në vlerësimin e rrethanave dhe fakteve të hetimit, mbi bazën e së cilës subjekti ka konkluduar se vepra penale e vrasjes është kryer nga dy persona në bashkëpunim dhe jo nga një person. Këto rrethana kanë të bëjnë me themelin e çështjes.

Për këtë arsye, referuar nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, i cili nuk i jep Komisionit kompetencë të vlerësojë gjykimin e themelit të çështjes nga ana e subjektit, Komisioni nuk ka kompetencë të vlerësojë këtë veprim të subjektit të rivlerësimit.

**Për sa më lart, nga analiza e tri dokumenteve të mësipërme në veprimet e subjektit të rivlerësimit, si nga Grupi i Punës në KLP, ashtu edhe nga ana e Komisionit, nuk u konstatuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional.**

### **C/3. Pesë dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi shortimi rastësor e objektiv**

**15. Dosja nr. 1** – “Vendim datë 21.7.2014 për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2014” mbi kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 18.7.2014, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në datën 18.7.2014, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas materialit hetimor për veprën penale “prishje e rendit dhe qetësisë publike” (neni 274 i Kodit Penal), referuar Komisarariatit të Policisë Durrës, është regjistruar materiali kallëzues me nr. \*\*\*.

Rezulton se në datën 16.7.2014, rreth orës 22:30, punonjësit e policisë kanë shkuar në ambientet e hotelit “\*\*\*\*” në zonën e Shkëmbit të Kavajës pas marrjes së njoftimit nga banorë të zonës se aty luhej muzikë me volum shqetësues dhe kanë shoqëruar dy muzikantët në komisarariat.

Është provuar se pronari i lokalit E. D. është pajisur me leje mjedisore për veprimtaritë që lëshojnë zhurmë sipas ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007. Nuk është provuar që muzika e luajtur në datën 16.7.2014 në lokalit e tij të ketë shkaktuar zhurma në mjedisin përreth e, për pasojë, prishje të qetësisë publike, sepse nga ana e policisë nuk është fiksuar me procesverbal se cili ka qenë niveli i zhurmës së shkaktuar nga muzika e luajtur, pasi punonjësit e policisë nuk kanë qenë të shoqëruar nga inspektorët e organeve, të cilët në bazë të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” janë organet që kontrollojnë zbatimin e këtij ligji e akteve

nënligjore dhe kanë të drejtën për të matur zhurmat me aparaturat përkatëse. Punonjësit e policisë në këto raste janë vetëm organe që ndihmojnë inspektorët në kontrollin dhe zbatimin e këtij ligji.

Sa më sipër, rezulton se fakti i referuar nga policia gjyqësore nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, prandaj subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ndaj këtij vendimi të subjektit të rivlerësimit nuk është ushtruar ankim.

**16. Dosja nr. 2** – “Vendim datë 21.7.2015 për pushimin e çështjes nr. \*\*\* të vitit 2015” dhe procedimi penal nr. \*\*\*, datë 1.4.2015, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 1.4.2015, për veprën penale “plagosje e rëndë me dashje”, e kryer në bashkëpunim (nenet 88/1 dhe 25 të Kodit Penal), në ngarkim të shtetasve Xh. P. dhe B. Z., të cilët në datën 31.3.2015, rreth orës 14:00, në Lagjen Nr. \*\*\* Durrës, gjatë një konflikti për motive të dobëta kanë goditur vëllezërit S. dhe E. L..

Referuar akteve mjekoligjore<sup>95</sup>, tek shtetasi S. L. janë konstatuar dëmtime që hyjnë në kategorinë e dëmtimeve, që sjellin humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi 9 ditë, pra janë konsumuar elementet e veprës penale “plagosje e lehtë me dashje” (neni 89 i Kodit Penal), për të cilën në bazë të neneve 284 dhe 285 të Kodit të Procedurës Penale i dëmtuari ka të drejtë të heqë dorë nga ankimi dhe ndjekja penale për këto vepra penale fillon nëse ka ankim nga i dëmtuari.

Me vendimin datë 1.7.2015, subjekti ka zgjatur afatin e hetimeve me 1 muaj për kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore. Nga dosja ka rezultuar se në datën 24.6.2014, Instituti i Mjekësisë Ligjore ka kërkuar nga Prokuroria disa dokumente të tjera mjekësore të shtetasit S. L., me qëllim për të kryer aktin e ekspertimit mjekoligjor.

Me vendimin datë 21.7.2015, subjekti, pasi ka analizuar provat dhe faktin, konstaton se procedimi penal duhet të pushohet bazuar në nenin 328/1c të Kodit të Procedurës Penale, pasi i dëmtuari S. L. ka hequr dorë nga e drejta e ankimit për këtë vepër penale dhe ka kërkuar që nga ana e organit të akuzës të mos ushtrohet ndjekja penale.

**17. Dosja nr. 3** – “Vendim datë 2.3.2016 për pushimin e çështjes nr. \*\*\* të vitit 2015” dhe procedimi penal nr. \*\*\*, datë 4.11.2015, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (trajtuar më poshtë tek kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 29.6.2016).

**18. Dosja nr. 4** – “Kërkesë datë 18.10.2013 për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2013” dhe procedimi penal nr. \*\*\*, datë 20.7.2013, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 20.7.2013, është regjistruar në ngarkim të shtetasit A. H. për veprat penale “shkatërrim i pronës me zjarr” e mbetur në tentativë dhe “dhunë në familje” (nenet 151, 22 dhe 130-a/3 të Kodit Penal).

---

<sup>95</sup> Aktet e ekspertimit mjekoligjor nr. \*\*\*, datë 8.4.2015 dhe nr. \*\*\*, datë 7.4.2015, si dhe akti i riekspertimit nr. \*\*\*, datë 16.7.2015.

Nga hetimet e plota ka rezultuar se pas kallëzimit të bashkëshortes së tij në polici, policia e ka kapur shtetasin A. H. në flagrancë gjatë tentativës për të djegur shtëpinë pas grindjeve të vazhdueshme që ka pasur me bashkëshorten, të cilën ditën e ngjarjes e ka goditur, për shkak se ajo përpqej ta ndalonte që të digjte shtëpinë.

Me kërkesën për gjykim datë 18.10.2013, pasi ka analizuar provat dhe faktin, pasi ka konstatuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe provat janë të plota në ngarkim të tij, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar që çështja penale në ngarkim të tij të gjykohet nga gjykata.

Komisioni, pasi shqyrtoi fashikullin e këtij procedimi penal, vëren se në përfundim të gjykimit subjekti ka kërkuar: (i) deklarinin fajtor të të pandehurit A. H. për veprën penale “dhunë në familje” (neni 130/a/1 i Kodit Penal) dhe dënimin e tij me 1 vit burgim; (ii) deklarinin fajtor të të pandehurit A. H. për veprën penale “shkatërrim i pronës me zjarr”, e mbetur në tentativë (nenet 151 dhe 22 të Kodit Penal) dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim; (iii) në bashkim të dënimeve (neni 55 i Kodit Penal) dënimin me 1 vit e 3 muaj burgim; (iv) në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal, dënimin me 10 muaj burgim.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2014, vendosi: (i) deklarinin fajtor të të pandehurit A. H. për veprën penale “dhunë në familje” (neni 130/a/1 i Kodit Penal) dhe dënimin me 1 vit burgim; (ii) deklarinin fajtor për veprën penale “shkatërrim i pronës me zjarr”, e mbetur në tentativë (nenet 151 dhe 22 të Kodit Penal) dhe dënimin me 3 muaj burgim; (iii) në bashkim të dënimeve (neni 55 i Kodit Penal), dënimin me 1 vit burgim; (iv) në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal, dënimin me 8 muaj burgim.

Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

**19. Dosja nr. 5** – “Kërkesë datë 29.6.2016 (ora 8:30) për vlerësimin e arrestit në flagrancë, caktimin e masës së sigurimit dhe gjykimin e drejtpërdrejtë të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016” dhe procedimi penal nr. \*\*\*, datë 28.6.2016, i regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Procedimi penal nr. \*\*\* është regjistruar për veprën penale “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt” (neni 291 i Kodit Penal) në ngarkim të të pandehurit A. D., i cili në datën 27.6.2016, rreth orës 21:15 është ndaluar nga patrulla e policisë rrugore duke drejtuar automjetin tip “Renault” pasi kishte konsumuar alkool në masën mbi 0.5% dhe është arrestuar në flagrancë.

Subjekti, pasi ka analizuar provat dhe faktin, konstaton se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, provat janë të plota në ngarkim të tij, prandaj ka kërkuar nga gjykata: (i) vlerësimin e ligjshëm të arrestimit të shtetasit A. D.; (ii) caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” (neni 238 i Kodit të Procedurës Penale), meqenëse plotësohen kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të parashikuara nga nenet 228, 229/1 dhe 229/2 të Kodit të Procedurës Penale; (iii) gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, datë 28.6.2016, në ngarkim të tij për veprën penale “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt”.

Komisioni, pasi shqyrtoi fashikullin e këtij procedimi penal, vëren se gjykata ka pranuar kërkesën e subjektit për vlerësimin e ligjshëm të arrestimit etj., duke i konsideruar të ligjshëm të gjithë hapat proceduralë të kryer nga ana e subjektit.

Në përfundim të gjykimit, në diskutimin përfundimtar datë 30.6.2016, subjekti ka kërkuar: (i) deklarin fajtor të shtetasit A. D. për veprën penale “drejtim i mjetit në mënyrë të parregullt” dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim; (ii) në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin me 2 muaj burgim; (iii) në zbatim të nenit 37 të Kodit Penal, ndalimin e tij për të drejtuar automjete për 1 vit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin datë 30.6.2016, vendosi në lidhje me deklarin fajtor të të pandehurit dhe masën e dënimit, sipas kërkesave të subjektit të rivlerësimit, por në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal gjykata vendosi pezullimin e ekzekutimit të dënimit dhe zëvendësimin me 80 orë punë në interes publik brenda 60 muajve, si dhe paraqitjen pranë shërbimit të provës.

**Për sa më lart, nga analiza e pesë dokumenteve të mësipërme, në veprimet e subjektit të rivlerësimit, si nga Grupi i Punës në KLP, ashtu edhe nga ana e Komisionit, nuk u konstatuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional.**

#### **C/4. Të dhëna nga burime arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime**

**20.** Nga të dhënat e arkivit të Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj prokurores Alma Felaj nuk janë dhënë masa disiplinore<sup>96</sup>.

**21.** Subjekti i rivlerësimit Alma Felaj është vlerësuar “shumë mirë” nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

**22.** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë ka informuar<sup>97</sup> KLP-në se ndaj shtetas Alma Felaj janë regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda Tiranë kallëzimi penal nr. \*\*\* i vitit 2018 dhe kallëzimi penal nr. \*\*\* i vitit 2019, të depozituara nga shtetasi F. Ç.. Pas verifikimeve është vendosur mosfillimi i procedimeve penale për secilin kallëzim penal.

**23.** Në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\*\*, ky kallëzim është regjistruar në datën 11.12.2018 pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, pasi i është dërguar për kompetencë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2018. Ky kallëzim është bërë kundër disa subjekteve të rivlerësimit, përfshirë edhe prokuroren Alma Felaj, për veprat penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, “shpërdorim detyre”, “grup i strukturuar kriminal” dhe “forma të veçanta të bashkëpunimit”, të parashikuara nga nenet 319/ç, 248, 333/a dhe 28/4 të Kodit Penal.

**24.** Bazuar në nenet 290 dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendimin datë 20.12.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se faktet e pretenduara në kallëzim nuk përmbajnë elementet e veprës penale të parashikuara në nenet 248, 319/ç dhe 33/a të Kodit Penal. Në këtë vendim, prokurori citon se gjatë pyetjes për rrethanat e çështjes F. Ç. ka deklaruar se nuk ka dijeni për veprime

<sup>96</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2020, e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar Drejtorisë së Koordinimit Institucional.

<sup>97</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2020, e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar, drejtuar KLP-së.

konkrete korruptive të shtetasve që ka kallëzuar, por ka dyshime të arsyeshme që veprimet e tyre janë ndikuar nga interesa korruptivë. Gjithashtu, prokurori arsyeton se veprimet që kallëzuesi i pretendon si shkelje të ligjit kanë të bëjnë me veprime procedurale të gjykatës dhe prokurorisë, vlerësimi i ligjshmërisë së të cilave bëhet nga prokurori i çështjes konkrete ose nga gjykata në veprimet paraprake dhe jo nëpërmjet kallëzimit në prokurori (trajtuar më poshtë në ankimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2019).

**25.** Në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\*\* të vitit 2019, i regjistruar në datën 17.2.2019 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, pasi i është dërguar kësaj për kompetencë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>98</sup> (ky kallëzim është i njëjtë me kallëzimin nr. \*\*\* më lart), me vendimin datë 31.1.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim, pasi është ankimuar, është lënë në fuqi nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.4.2019 (trajtuar më poshtë në ankimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2019).

**26.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme<sup>99</sup> dhe KLP-në<sup>100</sup> se pranë kësaj Prokurorie është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 29.6.2016, i kallëzuesit Xh. M., në ngarkim të subjektit të rivlerësimit Alma Felaj për veprat penale “shpërdorim i detyrës” dhe “mosekzekutim pa shkaqe të përligjura i vendimit të gjykatës” (nenet 248 dhe 320/a të Kodit Penal). Në kallëzim, ky shtetas pretendon se subjekti nuk zbatonte vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës për rifillimin e procedimit penal; nuk ka bërë hetime për ekspertin K. Xh., ndërsa për administratorin e shoqërisë “\*\*\*” argumenton se ka kaluar afati i parashkrimit.

**27.** Mbi bazën e këtij kallëzimi të ngritur ndaj subjektit të rivlerësimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (për kompetencë tokësore) ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 29.6.2016. Në përfundim të verifikimeve, kjo Prokurori me vendimin datë 2.9.2016 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për këtë kallëzim penal, me argumentin se fakti nuk përbën vepër penale (bashkëlidhur kopja e fashikullit përkatës).

**28.** Nga aktet ka rezultuar se në datën 8.7.2014 Xh. M. ka kallëzuar se në bashkëpunim njëri-tjetrin eksperti K. Xh. ka bërë “ekspertim të rremë” dhe G. H., administratori i shoqërisë “\*\*\*”. ka bërë vetëdeklarim të rremë dhe falsifikim të dokumenteve pranë ALUIZNI-t në lidhje me deklaratimet e garazheve dhe katit të parë gjatë procesit të legalizimit. Ky kallëzim i regjistruar me nr. \*\*\*, viti 2014, është mosfilluar nga prokurorja E. Xh..

**29.** Në zbatim të vendimit nr. \*\*\*, datë 24.2.2015<sup>101</sup>, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka vendosur: (i) prishjen e vendimit të prokurores E. Xh.; (ii) regjistrimin e procedimit penal dhe rifillimin e hetimit në lidhje me veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, ky prokuror ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 4.11.2015, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”

<sup>98</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

<sup>99</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar KLP-së.

<sup>100</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëlidhur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar Komisionit.

<sup>101</sup> Vendim që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.2015.

pa emër të autorit të veprës penale. Ky procedim që nga data 3.12.2015<sup>102</sup> është ndjekur nga prokurorja Alma Felaj, e cila ka zbatuar detyrat e lëna nga gjykata dhe ka kryer të gjitha veprimet hetimore.

**30.** Nga analiza në harmoni me njëra-tjetrën e provave të administruara rezultojnë e provuar se shtetasi G. H. ka plotësuar pranë Zyrës së ALUZNI-t Durrës formularin e vetëdeklarimit me nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2006, lidhur me legalizimin e disa shtesave pa leje, në pallatin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*”. Në përmbajtjen e këtij formulari, në pjesën e përshkrimit të shtesave, ka shkruar se ndryshimet e bëra janë “Shtesa e papafingove në pjesën e nëntëkatëshit dhe pesëkatëshit dhe mbyllja e garazhit të makinave me ambiente shërbimi në lartësinë 2 kate”. Nisur edhe nga deklaratimet e tij, shtetasi G. H. ka bërë një lapsus, duke thënë vetëm “mbyllja e garazhit të makinave”, në vend që të shkruante “mbyllja e rrugës për në garazhin e makinave”.

**31.** Subjekti i rivlerësimit ka konstatuar se nga data e hartimit dhe përdorimit të formularit të vetëdeklarimit, 30.8.2006, deri në datën 8.7.2014 të kallëzimit penal, kanë kaluar rreth 8 vjet, duke tejkaluar afatin 5-vjeçar të parashkrimit të ndjekjes penale (neni 66/c i Kodit Penal) për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

**32.** Në datën 2.3.2016, në bazë të neneve 328/d dhe 329, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, me argumentin se nuk ka elemente të veprës penale “falsifikim i dokumenteve”, por edhe nëse do të kishte kjo vepër është parashikuar sipas nenit 66/c të Kodit Penal dhe shkak i parashkrimit e shuan veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Rezultojnë se ky vendim është marrë brenda afateve procedurale.

**33.** Ky vendim i subjektit, pasi është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.5.2016, të kësaj gjykate, vendim që më pas është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin<sup>103</sup> nr. \*\*\*, datë 20.6.2017.

### **Për sa më lart, Komisioni nuk konstatoi mangësi në veprimet e subjektit të rivlerësimit.**

**34.** Nga hetimi i Komisionit, referuar përgjigjes<sup>104</sup> së Prokurorisë së Përgjithshme, rezultojnë që prokuroritë e rretheve gjyqësore<sup>105</sup> konfirmojnë se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është regjistruar kallëzim penal, procedim penal i filluar, pushuar apo i mosfilluar; nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo të dhëna që cenojnë figurën e subjektit.

---

<sup>102</sup> Me vendimin datë 30.12.2015, të drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, prokurorja e çështjes E. Xh. është zëvendësuar nga prokurorja Alma Felaj.

<sup>103</sup> Referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, drejtuar Komisionit.

<sup>104</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2021, e Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar Komisionit.

<sup>105</sup> Sipas shkresave të prokurorive të rretheve gjyqësore: Pogradec, nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Sarandë, nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Shkodër, nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Lushnjë, nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Mat, nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Elbasan, nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2021; Fier, nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Krujë, nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021; Gjirokastrë, nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Korçë, nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2021; Pukë, nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Dibër, nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021; Tropojë, nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Kavajë, nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2021; Lezhë, nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2021; Vlorë, nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2021; Përmet, nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Durrës, nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021; Kukës, nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Berat, nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021; Kurbin nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021.



## DENONCIME

### **35. Ankim nr. \*\*\*, datë 16.1.2019 dhe kallëzim penal nr. \*\*\*, datë 11.12.2018, të shtetasit F. Ç.**

Në objektin e ankimit nr. \*\*\*, datë 16.1.2019, denoncuesi, midis të tjerash, kërkon të kontrollohen disa akte, që rezultoi se nuk kanë të bëjnë me subjektin e rivlerësimit<sup>106</sup>. Denoncuesi pretendon se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë duhej të merrte vendim dhe të përcaktonte moskompetencën e saj tokësore përpara se t'i dërgonte për kompetencë kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 5.7.2018, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Bashkëlidhur denoncimit janë depozituar dy kërkesa të denoncuesit, ku nuk përmendet subjekti i rivlerësimit Alma Felaj<sup>107</sup>, si dhe kallëzimi penal datë 3.12.2018 i denoncuesit ndaj disa subjekteve të rivlerësimit, përfshirë edhe znj. Alma Felaj, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm.

Në kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 11.12.2018 (i njëjtë me kallëzimin nr. \*\*\*, viti 2019, i trajtuar më lart në pikën 25), drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme dhe për dijeni Komisionit, denoncuesi pretendon se disa subjekteve rivlerësimi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, përfshirë edhe subjektin Alma Felaj, me qëllim për të dënuar kallëzuesin, bashkëpunojnë me njëri-tjetrin si grup kriminal, duke konsumuar veprat penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, i prokurorëve etj.”, “shpërdorim detyre”, “grup i strukturuar kriminal”. Bashkëlidhur kallëzimit janë disa akte ku nuk përmendet subjekti Alma Felaj<sup>108</sup>.

Nga shqyrtimi i ankimit nr. \*\*\*, datë 16.1.2019 dhe i kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë 11.12.2018, si dhe akteve bashkëlidhur këtyre, Komisioni vëren se subjektin e rivlerësimit denoncuesi e përmend vetëm kur pretendon se subjekti, si zëvendës drejtuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk duhej të pranonte për kompetencë tokësore kallëzimin e gjyqtarës së Gjykatës së Apelit Tiranë, V. H., ndaj shtetasit Ç. për veprën penale “fyerje e gjyqtarit” të dërguar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak se: (i) kjo Prokurori nuk ka kryer më parë hetime për konflikt interesi; (ii) gjykata ku punon kjo gjyqtare përfshin në juridiksionin e vet edhe Gjykatën e Rrethit Durrës; (iii) kompetencën tokësore midis këtyre dy prokurorive duhej ta caktonte Prokuroria e Përgjithshme.

Komisioni, pasi shqyrtoi aktet e depozituara nga denoncuesi, raportin e KLP-së dhe aktet bashkëlidhur që ka administruar, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk është marrë me procedurën e shortimit të kallëzimit penal, që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka dërguar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

---

<sup>106</sup> (i) Fashikulli i hetimit penal në ngarkim të tij, që është hetuar nga prokurorja E. Xh.; (ii) çështja penale nr. \*\*\*, viti 2018, që kjo prokurore ka dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës; (iii) dosja gjyqësore e vendimit nr. \*\*\*, datë 20.3.2013, e Gjykatës së Apelit Tiranë, ku gjyqtarja V. H. ka qenë kryesuese e trupës gjyqësore.

<sup>107</sup> (i) Kërkesa datë 26.11.2018 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për gjykimin e çështjes penale nr. \*\*\*, viti 2018, për veprën penale “fyerje e gjyqtarit” në ngarkim të shtetasit F. Ç.; (ii) kërkesë datë 14.1.2019 e denoncuesit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për përjashtimin e gjyqtarës E. K. nga gjykimi i kërkesës, datë 26.11.2018, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2018, në ngarkim të shtetasit F. Ç.

<sup>108</sup> (i) Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 5.7.2018, i gjyqtarës V. H. ndaj shtetasit F. Ç.; (ii) kopje e fashikullit hetimor të procedimit penal nr. \*\*\*, në ngarkim të shtetasit F. Ç.; (iii) disa procesverbale të zhvillimit të seancave gjyqësore nga kjo gjyqtare gjatë një gjyqi civil të gjykuar prej saj.

Gjithashtu, Komisioni konstatoi se pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda është regjistruar kallëzimi nr. \*\*\* i vitit 2019, i shtetasit F. Ç., i njëjtë me kallëzimin e tij nr. \*\*\*, datë 11.12.2018, për të cilin kjo Prokurori me vendimin datë 31.1.2019 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Në këtë vendim, Prokuroria e Krimeve të Rënda argumenton se kallëzuesi nuk disponon asnjë provë apo fakt, përveç perceptimeve të tij për disa veprime, që sipas tij janë shkelje procedurale (në lidhje me regjistrimin e kallëzimit të gjyqtarës V. H. në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë; shpalljen e moskompetencës nga kjo Prokurori dhe dërgimin e kallëzimit për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës; mënyrën e hedhjes së shortit; caktimin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe marrjen si i pandehur nga kjo Prokurori).

Kundër vendimit datë 31.1.2019 “Për mosfillimin e procedimit penal”, kallëzuesi F. Ç. ka bërë ankim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.4.2019, ka lënë në fuqi vendimin e datës 31.1.2019.

Referuar vendimit datë 31.1.2019 të Prokurorisë së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda dhe akteve të shqyrtuara nga Komisioni, rezultoi që denoncuesi nuk provon asnjë nga akuzat që ka ngritur në kallëzimin e tij, si “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, i prokurorëve etj.”, “shpërdorim detyre”, “grup i strukturuar kriminal” apo veprime të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit.

**Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk u konstatuan mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.**

**36. Denoncim nr. \*\*\*, datë 28.5.2019, i shtetasit P. K.,** i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit lëshon vërtetim që shtetasja A. Xh. nuk ndiqet penalisht, kur realisht kjo shtetase është në ndjekje penale. Bashkëlidhur denoncimit janë disa akte<sup>109</sup>.

Nga përmbajtja e këtyre akteve rezulton se me kërkesën datë 3.7.2018, shtetasi P. K. i ka kërkuar prokurores së çështjes O. Gj. një vërtetim se shtetasja A. Xh. është në ndjekje penale për veprën penale “falsifikim i dokumenteve shëndetësore”. Në përgjigje të kërkesës janë:

- a) Vërtetimi nr. \*\*\*, datë 17.7.2018, i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e zv. drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, që konfirmon se kjo Prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2018, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve shëndetësore” mbi bazën e kallëzimit penal \*\*\*, datë 27.3.2018 dhe mbi bazën e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili ka shfuqizuar vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\* /2018.
- b) Vërtetimi datë 17.12.2018, i nënshkruar nga subjekti në cilësinë e zv. drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, që konfirmon se: “A. Xh. nuk ndiqet penalisht nga kjo Prokurori”.

---

<sup>109</sup> Kopje të akteve nga dosja e procedimit penal datë 21.3.2018, e regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë 7.3.2018; vendimi nr. \*\*\*, datë 30.5.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; disa vërtetime lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe korrespondenca që kjo Prokurori ka mbajtur me denoncuesin në lidhje me ecurinë e hetimeve për procedimin penal, datë 21.3.2018.

Komisioni administroi<sup>110</sup> dhe shqyrtoi fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*/2018, nga ku rezultoi se prej datës 7.3.2018, kur Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\* të shtetasit P. K. kundër shtetasës A. Xh., deri në datën 17.12.2018, kur subjekti ka nënshkruar vërtetimin e fundit, emri i shtetasës A. Xh. nuk ka qenë i regjistruar si personi që i atribuohet vepra penale për të cilën është bërë kallëzimi. Në këto kushte, vërtetimet e nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e zëvendësdrejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasqyrojnë të dhëna të sakta.

**Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk u konstatuan mangësi, që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore në lidhje me kriterin profesional.**

**Disa denoncime nga shtetasja L. A.**

**37. Denoncim nr. \*\*\*, datë 21.5.2020** – në formularin e denoncimit citohen emrat e Drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, A. J., prokurores R. H. dhe prokurores Alma Felaj, ku pretendohet për shkelje të etikës, zvarritje procesi dhe citon se subjekti i rivlerësimit ka manipuluar procesverbalin dhe formularin e materialit kallëzues nr. \*\*\*, datë 22.2.2019, material kallëzues që sipas dokumenteve i përkiste prokurores S. B., e cila është zëvendësuar nga prokurorja R. H., ndërkohë që Drejtuesja e Prokurorisë A. J. nuk ka marrë vendim për këtë zëvendësim, sipas nenit 49 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Bashkëlidhur formularit të denoncimit janë disa akte procedurale dhe kërkesa të denoncueses<sup>111</sup>.

Nga përmbajtja e denoncimit dhe akteve bashkëlidhur rezulton se sipas procesverbalit datë 12.2.2019, fillimisht materiali kallëzues nr. \*\*\*, datë 12.2.2019, i është caktuar prokurores S. B., e cila me informacionin datë 21.2.2019 njofton drejtuesin e prokurorisë se nuk mund ta trajtojë këtë kallëzim penal, për arsye se bën pjesë në kategorinë e seksionit të veprave penale të përgjithshme dhe jo në seksionin e veprave që ajo heton. Meqenëse nuk kishte filluar hetimi, kallëzimi u hodh sërish në short dhe sipas procesverbalit e formularit datë 22.2.2019, të nënshkruar nga Alma Felaj, materiali kallëzues i caktohet për ndjekje prokurores R. H.

Sa më lart, Komisioni vëren se veprimet për shpërndarjen e materialit kallëzues janë bërë në përputhje me kreun IV të udhëzimit nr. \*\*\*, datë 29.12.2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, që përcakton se kur janë rastet ligjore të zëvendësimit të prokurorit, në përzgjedhjen me short të prokurorit që do t’i caktohet çështja, drejtuesi i prokurorisë mban parasysh një trajtim të njëjtë mes prokurorëve..., si dhe në përputhje me nenin 49, pika 3 e ligjit nr. 97/2016, pasi zëvendësimi i prokurores Suela Beluli është bërë me vendim të drejtuesit të prokurorisë.

<sup>110</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, drejtuar Komisionit.

<sup>111</sup> (i) Kërkesë-ankesa datë 4.5.2020 e denoncueses dërguar KLP-së, ONM-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm; (ii) kërkesë-memo datë 5.3.2020 e denoncueses drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, Kolegjit dhe ONM-së; (iii) procesverbali datë 22.2.2019 “Mbi dokumentimin e shortit manual” dhe formulari datë 22.2.2019 “Mbi dokumentimin e shortit manual dhe shpërndarjen e materialeve hetimore të referuara në Prokurori”, të nënshkruara nga subjekti i rivlerësimit, ku citohet se materiali kallëzues nr. \*\*\* i është caktuar për ndjekje prokurores R. H..

Pavarësisht dyshimeve dhe pretendimeve të denoncueses, rezulton që në tërësinë e veprimeve subjekti i rivlerësimit ka kryer vetëm hedhjen dhe dokumentimin e shortit për materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 22.2.2019, pas tërheqjes së prokurores S. B. nga hetimi i këtij materiali. Gjithashtu, nuk rezultoi që denoncuesja të provonte asnjë nga akuzat e përmendura prej saj për zvarritje procesi, shkelje të etikës etj. në adresë të subjektit të rivlerësimit.

**Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se në veprimet e subjektit të rivlerësimit nuk konstatohen mangësi që e ngarkojnë atë me përgjegjësi.**

**38. Denoncim nr. \*\*\*, datë 21.5.2020**, ku denoncuesja në objektin e ankesës përmend disa prokurorë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, midis të cilëve edhe prokuroren Alma Felaj, por në përmbajtjen e ankesës denoncuesja nuk e përmend subjektin e rivlerësimit dhe as ndonjë *indicie* apo fakt rreth veprimeve të saj.

**39. Denoncimet nr. \*\*\*, datë 11.10.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 21.11.2019**, ku denoncuesja pretendon midis të tjerash për parregullsi në veprimet e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, z. A. Gj., për zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit Alma Felaj me prokuroren R. H. në hetimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2017, ndërsa në denoncimin nr. \*\*\*, datë 18.10.2019, denoncuesja bashkëlidh fragment nga pjesa dispozitive e një vendimi të subjektit të rivlerësimit Alma Felaj për caktimin e grupit të ekspertëve, që do të kryejnë akteksptimin mjekoligjor të viktimës, por në aktet bashkëlidhur këtyre denoncimeve<sup>112</sup> nuk rezultojnë fakte apo *indicie* për veprime të parregullta të subjektit të rivlerësimit, që e ngarkojnë atë me përgjegjësi.

**40. Denoncimet nr. \*\*\*, datë 20.9.2021 dhe nr. \*\*\*, datë 22.9.2021** (përsëritje e denoncimit nr. \*\*\*, datë 20.9.2021), të cilëve denoncuesja u ka bashkëlidhur disa akte ku subjekti e rivlerësimit Alma Felaj e përmend bashkë me Drejtuesen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, A. J., prokuroren R. H. dhe oficerët e policisë gjyqësore K. Gj. e I. N., si mbrojtës të personave që kanë kryer “mjekim të pakujdesshëm” në spitalin e Durrësit dhe se hetimet për këtë procedim penal me nr. \*\*\*/2019 janë të cekëta dhe nuk është arritur të vihen para përgjegjësish këta persona. Denoncuesja nuk paraqet asnjë fakt apo *indicie* për këto veprime në adresë të subjektit të rivlerësimit.

Nga ana tjetër, Komisioni, duke iu referuar edhe denoncimeve të tjera të kësaj denoncueseje dhe akteve bashkëlidhur, vëren se hetimet për këtë procedim penal nuk janë kryer nga subjekti i rivlerësimit Alma Felaj, por nga prokurorja R. H. dhe më pas nga prokurori G. V..

---

<sup>112</sup> Kërkesë datë 8.10.2019 drejtuar prokurores R. H.; vendim datë 9.5.2019, i Drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, A. J., për mospranimin e kërkesës së denoncueses për zëvendësimin e prokurores R. H. me prokuror tjetër; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2019, e znj. A. J. drejtuar znj. L. A.; informacion datë 11.2.2019 për referim të veprës penale nga OPGJ-ja H. A.; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2018, e znj. A. J. drejtuar znj. L. A.; informacion datë 21.2.2019 i prokurores S. B. drejtuar drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Durrës; urdhër datë 28.2.2019 “Për regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 12.2.2019” i prokurores R. H.; udhëzim nr. \*\*\*, datë 29.12.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm; vendim datë 1.7.2019 “Për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor”, nënshkruar nga prokurorja R. H.; ankesë datë 31.7.2019 e shtetases L. A. për kundërshtimin e vendimit datë 1.7.2019 të prokurores R. H. “Për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor”; akt ekspertimi mjekoligjor nr. \*\*\*, kërkesë nr. \*\*\*, datë 30.9.2019, e kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për heqjen dorë nga gjykimi i kërkesës së shtetases L. A. për kundërshtimin e vendimit datë 1.7.2019 “Për kryerjen e ekspertimit mjekoligjor”; vendim nr. \*\*\*, datë 1.10.2019, i kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës për refuzimin e dorëheqjes së kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**Për sa më lart, Komisioni nuk i merr në konsideratë këto denoncime.**

### **Konkluzion për kriterin e vlerësimit profesional**

**41.** Në përmbledhje të konkluzioneve, referuar raportit të hartuar nga Grupi i Punës në KLP dhe dokumentacionit bashkëlidhur, si dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni, trupi gjykues vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit, që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale dhe sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

### **VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES**

**42.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar neneve Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, krerëve V, VI dhe VII të ligjit nr. 84/2016 lidhur me kriterin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Alma Felaj:

- a. Lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasurinë, duke vlerësuar se balanca financiare negative e konstatuar, në bazë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, zë një peshë minimale në rezultatin e vlerësimit pasuror; ka bërë deklaram të saktë e të mjaftueshëm; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka zhvilluar procese në konflikt interesi, duke arritur kështu një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.
- b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin dhe vlerësimin e këtij kriteri.
- c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “e aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të pikës 1/a të nenit 58, pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alma Felaj, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.7.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Etleđa ÇIFTJA**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*